


	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 1 nga 82</i>

KODI I RRJETIT - KODI I KYÇJES


	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 2 nga 82</i>

PËRMBAJTJA


1	Parathënie.....	6
2	Objektivi.....	6
3	Fushëveprimi i aplikimit.....	6
4	Aplikimi për shfrytëzuesit ekzistues të sistemit të transmetimit.....	7
5	Procedura e kyçjes.....	9
	5.1 Marrëveshjet e kyçjes.....	9
	5.1.1 Kushtet e përgjithshme të MK.....	9
	5.1.2 Kushtet specifike të MK.....	9
	5.1.3 Aranzhimet e kyçjes.....	10
	5.2 Aplikimi i kyçjes dhe procedura e miratimit.....	11
	5.2.1 Afatet kohore.....	11
	5.2.2 Aplikimi i kyçjes.....	11
	5.2.3 Oferta për Kyçje.....	12
	5.2.4 Finalizimi i Marrëveshjeve të kyçjes.....	12
6	Pronësia – kufijtë komercial.....	13
	6.1 Ndarja e pronësisë.....	13
	6.2 Kufiri teknik OST- Centrali i Gjenerimit.....	13
	6.3 Kufiri teknik OST - OSSh.....	13
	6.4 Kufiri teknik OST – Stabilimentet e kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit (Konsumatorët industrial).....	14
	6.5 Kushtet e veçanta.....	14
	6.6 Pronësia dhe funksionimi.....	14
7	Kushtet e kyçjes.....	14
	7.2 Kërkesat për OST.....	14
	7.2.2 Frekuenca e sistemit.....	15
	7.2.3 Tensioni i sistemit.....	15
	7.2.4 Cilësia e formës së valës së tensionit.....	15
	7.3 Kërkesat e përgjithshme për të gjithë shfrytëzuesit.....	15
	7.3.2 Kërkesa për fuqi aktive.....	16
	7.3.3 Kërkesa për energji reaktive.....	16
	7.3.4 Mbrojtja dhe kontrolli.....	16
	7.3.5 Rikyçja automatike.....	17
	7.3.6 Aranzhimet e mbrojtjeve.....	18
	7.3.7 Komunikimet e mbrojtjes.....	19
	7.3.8 Pajisja sinkronizuese.....	19
	7.3.9 Varshmëria e mbrojtjeve.....	20
	7.3.10 Pajisjet e regjistrimit të prishjeve.....	20
	7.3.11 Tokëzimi.....	20

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 3 nga 82</i>

7.3.12	Konsiderimet e nivelit të prishjeve	20
7.3.13	Monitorimi i sistemit	20
7.3.14	Komunikimet	20
7.3.15	Kushtet në vendin e kyçjes	21
7.3.16	Identifikimi i stabilimentit dhe aparaturave	21
7.3.17	Mbajtja e të dhënave.....	21
7.3.18	Qasja	21
8	Kërkesat për modulet gjeneruese.....	22
8.1	Kërkesa të përgjithshme	22
8.1.1	Brezi i frekuencës.....	22
8.1.2	Aftesia e qendrueshmerise ndaj shkalles se ndryshimit të frekuencës	22
8.1.3	Reagimi i fuqisë aktive në frekuencë	23
8.1.4	Rregullimi i fuqisë aktive	26
8.1.5	Modelet e simulimit të moduleve gjeneruese.....	29
8.1.6	Kërkesat për stabilitetin e tensionit	30
8.1.7	Humbja e mbrojtjes së sinkronizimit	32
8.1.8	Impianti që është subjekt i dispeçimit qendror	33
8.1.9	Startimi nga errësira, operimi në ishull dhe ri-sinkronizimi	33
8.2	Kërkesat për modulet gjeneruese sinkrone	34
8.2.1	Rregullimi i Fuqisë Reaktive	34
8.2.2	Sistemet e ekscitimit.....	35
8.3	Kërkesat për modulet e parkut gjenerues	36
8.4	Procedura e njoftimit për operimin e kyçjes së centraleve të gjenerimit në rrjetin e transmetimit	41
8.4.1	Dispozitat e përgjithshme	41
8.4.2	Procedura për modulet e gjenerimit të kyçura në rrjetin e transmetimit	41
8.4.3	Njoftimi për operim gjatë energjizimit	41
8.4.4	Njoftimi për operim të përkohshëm.....	41
8.4.5	Njoftimi për operim final	42
8.4.6	Njoftimi për operim të kufizuar	42
8.5	Monitorimi i Pajtueshmërisë dhe Testimi i moduleve të gjenerimit të kyçura në rrjetin e transmetimit.....	43
8.5.1	Përgjegjësia e pronarit të centralit të gjenerimit	43
8.5.2	Detyra e OST-së	44
8.5.3	Dispozita të zakonshme për testimin e pajtueshmërisë.....	45
8.5.4	Dispozita të përgjithshme për simulimin e pajtueshmërisë	46
8.5.5	Testimi i pajtueshmërisë për modulet sinkrone të gjenerimit	46
8.5.6	Testimi i pajtueshmërisë për modulet e parkut gjenerues të kyçura në rrjetin e transmetimit	48
8.5.7	Simulimi i pajtueshmërisë për modulet gjeneruese sinkrone	52

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 4 nga 82</i>

8.5.8	Simulimi i pajtueshmërisë për modulet e parkut gjenerues të kyçura në rrjetin e transmetimit ..	54
8.6	Shkyçja dhe ri-kyçja e moduleve gjeneruese	56
8.6.1	Shkyçja vullnetare.....	56
8.6.2	Shkyçja e pavullnetshme	56
8.6.3	Rikyçja e moduleve gjeneruese	57
9	Kërkesat për shfrytëzuesit e kërkesës (ngarkesës).....	57
9.1	Kërkesat për frekuencë	57
9.2	Kërkesat për tension	57
9.3	Kërkesat për lidhje të shkurtë	58
9.4	Kërkesat për fuqi reaktive	59
9.5	Shkyçja e dhe rikyçja e kërkesës	60
9.6	Modelet e simulimit të stabilimenteve të ngarkesës.....	62
9.7	Procedura e njoftimit për operim për kyçjen e shfrytëzuesve të kërkesës	63
9.7.1	Dispozitat e përgjithshme.....	63
9.7.2	Njoftimi për operim gjatë energjizimit për shfrytëzuesit e kërkesës	63
9.7.3	Njoftimi për operim të përkohshëm për shfrytëzuesit e kërkesës.....	63
9.7.4	Njoftimi për operim final për shfrytëzuesit e kërkesës	64
9.7.5	Njoftim për operim të kufizuar për shfrytëzuesit e rinjë të kërkesës.....	65
9.8	Kyçja e njësive të kërkesës të përdorura nga stabilimenti i kërkesës për të siguruar shërbime të reagimit të kërkesës për OST.....	66
9.8.1	Dispozitat e përgjithshme.....	66
9.8.2	Dispozita të veçanta për njësitë e kërkesës për rregullimin e fuqisë aktive, fuqisë reaktive dhe menaxhimin e kufizimit në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës	67
9.8.3	Dispozita të veçanta për njësitë e kërkesës për rregullimin e frekuencës së sistemit përmes reagimit të kërkesës.....	68
9.8.4	Dispozita të veçanta për njësitë e kërkesës për reagim shumë të shpejtë në rregullimin e fuqisë aktive përmes reagimit të kërkesës.....	69
9.8.5	Procedura e njoftimit për operim për njësitë e kërkesës me reagim të kërkesës.....	69
9.9	Pajtueshmëria e stabilimenteve të kërkesës	70
9.9.1	Përgjegjësia e pronarit të stabilimentit të kërkesës dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes...	70
9.9.2	Detyrat e OST.....	71
9.10	Testimi i pajtueshmërisë së stabilimenteve të kërkesës.....	72
9.10.1	Dispozitat e zakonshme për testet e pajtueshmërisë	72
9.10.2	Testimi i pajtueshmërisë për shkyçjen dhe ri-kyçjen e stabilimenteve të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit	73
9.10.3	Testimi i pajtueshmërisë për shkëmbimin e informacioneve të stabilimenteve të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit.....	74
9.10.4	Testimi i pajtueshmërisë për shkyçjen dhe ri-kyçjen e stabilimenteve të kërkesave të kyçura në rrjetin e transmetimit	74

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 5 nga 82</i>

9.10.5 Testimi i pajtueshmërisë për shkëmbimin e informatave të stabilimenteve të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit	74
9.10.6 Testimi i pajtueshmërisë për njësitë e kërkesës për rregullimin e fuqisë aktive, fuqisë reaktive dhe menaxhimin e kufizimit në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës	75
9.11 Simulimi i pajtueshmërisë i stabilimenteve kërkesës	75
9.11.1 Dispozitat e zakonshme për simulimet e pajtueshmërisë	75
9.11.2 Simulimet e pajtueshmërisë për stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit	76
9.11.3 Simulimet e pajtueshmërisë për stabilimentet kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit	77
9.11.4 Simulimi i pajtueshmërisë për njësitë e kërkesës me rregullim të shpejtë të fuqisë aktive për reagim ndaj kërkesës	77
9.12 Monitorimi i pajtueshmërisë	77
9.12.1 Monitorimi i pajtueshmërisë për stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit	78
9.12.2 Monitorimi i pajtueshmërisë për stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit ...	78
10 Derogimet.....	78
10.1 Dispozita të përgjithshme	78
10.2 Kërkesa për derogim nga pronari i centralit të gjenerimit, pronari i stabilimentit të kërkesës ose operatori i sistemit të shpërndarjes.....	79
10.3 Kërkesa për derogim nga OST ose OSSh	80
10.4 Monitorimi i derogimeve	81

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 6 nga 82</i>

1 Parathënie

1.1 Afatet dhe kushtet në të cilat lejohet **kyçja** në **Sistemin e Transmetimit** do të vendosen në një marrëveshje komerciale, mes **shfrytëzuesit** dhe **Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST)**. Kjo gjithashtu quhet edhe **Marrëveshja e Kyçjes (MK)** dhe është një marrëveshje kontraktuale mes **OST** dhe **shfrytëzuesit** për secilën pikë individuale të kyçjes të **Sistemit të Transmetimit**. Aty ku një **shfrytëzues** ka kyçje të shumta në një vend të vetëm atëherë kërkohet vetëm një **MK**.

1.2 **OST** duke hyrë në një **MK** me një **shfrytëzues** të veçantë duhet të sigurojë që sasia dhe cilësia e shërbimit të jetë në përputhje me kriteret e vendosura brenda këtij Kodi, përveç rasteve të ndryshme specifike nga **MK** relevante.

1.3 **Shfrytëzuesit** duke hyrë në një **MK** me **OST** duhet të sigurojnë që ata i përmbahen rregullave, procedurave, specifikimeve teknike dhe kërkesave për pajisje siç specifikohet në këtë kod.

2 Objektivi

Kodi i kyçjes është modeluar për të siguruar që:

- a) Ekzistojnë procedurat e përshtatshme për kyçjen e stabilimentit dhe aparaturave të reja ose të rinovuara të **shfrytëzuesit** dhe që rregullat bazë për kyçje i trajtojnë të gjithë **shfrytëzuesit** në mënyrë jo-diskriminuese dhe në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore dhe të licencës;
- b) Kriteret minimale teknike, dizajnin dhe operimin të specifikuar në këtë kod janë modeluar në mënyrë të tillë që kyçjet e reja apo të modifikuara të **Sistemit të Transmetimit**:
 - i) Të mos përkeqësojnë konditat operuese të sistemit në krahasim me konditat të definuara në këtë kod.
 - ii) Të mos shkaktoj po të njëjtat kushte në **Sistemin e Transmetimit** ose në sistemin e ndonjë **shfrytëzuesi** tjetër.

3 Fushëveprimi i aplikimit

3.1 **Kodi i kyçjes** do të aplikohet për të gjitha **palët** që aplikojnë dhe ato të kyçura në **Sistemin e Transmetimit**. Mbulon të gjitha ato aktivitete aktuale apo ato në perspektivë të cilat përfshijnë kategoritë e mëposhtme:

- a) Centralet e gjenerimit me module gjeneruese të kyçur në **Sistemin e Transmetimit**;
- b) Moduli i parkut gjenerues (Stacionet gjeneruese të energjisë diellore dhe të erës me kapacitet të instaluar ≥ 5 MW);
- c) Modulet gjeneruese të kyçura në **Sistemin e Shpërndarjes** me kapacitet më të madh se 5 MW.
- d) Stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit
- e) **Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST)**;
- f) **Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSh)**
- g) Stabilimentet e kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 7 nga 82</i>

3.2 Ky Kod ndihmon në sigurimin e kushteve të drejta të konkurrencës në tregun e brendshëm të energjisë, për të garantuar sigurinë e sistemit, integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë si dhe për të lehtësuar tregtinë me energji elektrike në tregun e përbashkët të energjisë.

3.3 Ky Kod gjithashtu përcakton detyrimet për të siguruar që **OST** të shfrytëzohet si duhet kapacitetet e stabilimenteve të kërkesës dhe të shpërndarjes në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese për të ofruar kushte të barabarta për të gjithë.

3.4 **OST** do të refuzoj kyçjen e një shfrytëzuesi të ri të rrjetit të transmetimit, i cili nuk përputhet me kërkesat e përcaktuara në këtë Kod dhe i cili nuk mbulohet nga derogimi i lejuar nga autoriteti rregullator. **OST** ia komunikon refuzimin e tillë, me anë të një deklarate të arsyetuar me shkrim, shfrytëzuesve të rrjetit të transmetimit dhe autoritetit rregullator, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga ana e autoritetit rregullativ.

3.5 Në rastin e stabilimenteve të kërkesës me më shumë se një njësi, këto njësi të kërkesës së bashku do të konsiderohen si një njësi e vetme nëse të njëjtat nuk mund të operohen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra apo nëse në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohen si të kombinuara.

3.6 Ky Kod nuk aplikohet për:

- a) modulet gjeneruese të cilat janë instaluar për të siguruar furnizim rezervë dhe operojnë paralelisht me sistemin për më pak se pesë minuta në muaj kalendarik gjersa sistemi është në gjendje normale. Funkzionimi paralel gjatë testeve të mirëmbajtjes ose komisionimit të atij moduli gjenerues nuk do të vlejë limiti prej pesë minutave;
- b) modulet gjeneruese që nuk kanë një pikë kyçjeje të përhershme dhe përdoren nga operatorët e sistemit për të siguruar përkohësisht energji elektrike kur kapaciteti normal i sistemit është pjesërisht ose tërësisht i padisponueshëm;
- c) pajisjet akumuluese, përveç të moduleve gjeneruese të hidrocentraleve reverzibile (të cilat duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat relevante si për mënyrën e operimit të gjenerimit ashtu edhe të pompimit);

4 Aplikimi për shfrytëzuesit ekzistues të sistemit të transmetimit

Dihet se disa nga stabilimentet dhe/ose aparaturat ekzistuese, pjesërisht apo tërësisht, do të jenë të paaftë për të përmbushur disa nga standardet minimale të specifikuara në këtë kod, ose për shkak se stabilimenti është modeluar me standarde tjera, ose për shkak të dëmtimit kundrejt specifikimeve të modelit. Në mënyrë që të vazhdohet funksionimi, duhet të kërkohet dhe lejohet derogimi. Për çdo pajisje që i ka plotësuar standardet në kohën e instalimit dhe ende i përmbush ato standarde do të marrë automatikisht një derogim. Të gjitha rastet e tjera do të konsiderohen rast pas rasti.

4.1 Nëse **pronarët e centraleve gjeneruese** ekzistuese kanë modifikuar centralin e tyre të gjenerimit deri në atë masë që marrëveshja e tyre për kyçje do të duhet të rishikohet në mënyrë të konsiderueshme në përputhje me procedurën e mëposhtme:

- a) **pronarët e centraleve të gjenerimit** që synojnë të modernizojnë një impiant apo të zëvendësojnë pajisjet që ndikojnë në kapacitetet teknike të modulit të gjenerimit, do e njoftojnë paraprakisht **OST** për planet e tyre;

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 8 nga 82</i>

- b) nëse **OST** konsideron që shkalla e modernizimit ose zëvendësimit të pajisjeve është e tillë që nevojitet një marrëveshje e re për kyçje, **operatori i sistemit** duhet të njoftojë autoritetin rregullativ; dhe
- c) autoriteti rregullator vendosë nëse marrëveshja ekzistuese e kyçjes duhet të rishikohet ose të kërkohet një marrëveshje e re e kyçjes dhe cilat kërkesa të këtij Kodi do të aplikohen;

4.2 Nëse një stabiliment ekzistues i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit, një sistem ekzistues i shpërndarjes ose një njësi ekzistuese e kërkesës e kyçur në rrjetin e transmetimit brenda një stabilimenti të kërkesës në nivel të tensionit mbi **1 kV**, është modifikuar deri në atë masë sa që marrëveshja për kyçje duhet të rishikohet në mënyrë thelbësore sipas procedurës në vijim:

- a) pronarët e stabilimenteve të kërkesës, **OSSH**, që synojnë të ndërmarrin veprime për modernizimin e një impianti ose zëvendësimin e pajisjeve që ndikojnë në kapacitetet teknike të **stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit**, të **sistemit të shpërndarjes** ose **njesisë së kërkesës**, duhet të njoftojnë paraprakisht **OST** për planet e tyre;
- b) nëse **OST** konsideron që shkalla e modernizimit apo zëvendësimit të pajisjeve është e tillë që të kërkohet një marrëveshje e re për kyçje, **operatori i sistemit** do të njoftojë autoritetin rregullator; dhe
- c) autoriteti rregullator do vendosë nëse marrëveshja ekzistuese për kyçje duhet të rishikohet ose të kërkohet një marrëveshje e re e kyçjes, si dhe cilat kërkesa të këtij Kodi do të aplikohen.

4.3 Autoriteti rregullator vendos që një stabiliment ekzistues i kyçur në rrjetin e transmetimit, një stabiliment ekzistues i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit, një sistem ekzistues i shpërndarjes apo një njësi e kërkesës ekzistuese do të nënshtrihen disa apo të gjitha kërkesave të këtij Kodi, pas propozimit nga **OST** në përputhje me paragrafët 4.5, 4.6 dhe 4.7.

4.4 Për qëllimet e këtij Kodi, një **stabiliment i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit**, një **stabiliment i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit**, një **sistem i shpërndarjes** ose një **njësi e kërkesës** që është ose mund të përdoret nga një stabiliment i kërkesës për të ofruar shërbime në reagim ndaj kërkesës për **OSSH** ose **OST**, do të konsiderohet si ekzistues nëse:

- a) është i kyçur tashmë në rrjet deri më datën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi të Kyçjes të amendamentuar më 2018; ose
- b) pronari i stabilimentit të kërkesës, **OSSH** ka lidhur një kontratë përfundimtare dhe detyruese për blerjen e pajisjeve kryesore të kërkesës ose të njesisë së kërkesës për dy vite pas skadimit të afatit të transpozimit. Pronari i stabilimentit të kërkesës, **OSSH** duhet të njoftojë **OST** për lidhjen e kontratës brenda 30 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi të Kyçjes të amendamentuar më 2018;
- c) Njoftimi i dorëzuar në **OST** nga pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH**-ja duhet së paku të tregojë titullin e kontratës, datën e nënshkrimit dhe datën e hyrjes në fuqi dhe specifikimet e pajisjeve kryesore të kërkesës ose të njesisë së kërkesës që do të ndërtohet, montohet ose blihet.
- d) Autoriteti rregullativ mund të përcaktojë nëse stabilimenti i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit, stabilimenti i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit, **OSSH** ose njësia e kërkesës duhet të konsiderohet si ekzistuese ose e re.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 9 nga 82</i>

4.5 Pas një konsultimi publik dhe me qëllim të adresimit të ndryshimeve të rëndësishme faktike të rrethanave, siç është evoluimi i kërkesave teknike të sistemit, duke përfshirë integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, rrjetet e mençura, gjenerimin e shpërndarë ose reagimi ndaj kërkesës, **OST** mund t'i propozojë autoritetit rregullator që të zgjerojë aplikimin e këtij Kodi në stabilimentet ekzistuese të kyçura në rrjetin e transmetimit, stabilimentet shpërndarëse ekzistuese të rrjetit të transmetimit, sistemi ekzistues të shpërndarjes ose njërive ekzistuese të kërkesës të shfrytëzuara nga një stabiliment i kërkesës për të ofruar shërbime të reagimit ndaj kërkesës për **OSSH** ose **OST**.

4.6 Autoriteti rregullator do të vendosë lidhur me shtrirjen e zbatueshmërisë së këtij Kodi në stabilimentet ekzistuese të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit, stabilimentet ekzistuese të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit, në sistemin ekzistues të shpërndarjes ose njësitë ekzistuese të kërkesës brenda gjashtë muajve nga marrja e raportit dhe rekomandimit nga **OST**. Vendimi i autoritetit rregullator do të publikohet;

4.7 **OST** do të merr parasysh propozimet e arsyeshme të pronarëve të stabilimenteve të kërkesës ose **OSSH** si pjesë e vlerësimit të zbatimit të këtij Kodi për stabilimentet ekzistuese të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit, stabilimentet ekzistuese të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit, sistemin ekzistues të shpërndarjes ose njësitë ekzistuese të kërkesës;

4.8 **OST** mund të vlerësojë zbatimin e disa ose të të gjitha dispozitave të këtij Kodi në stabilimentet ekzistuese të kyçura në rrjetin e transmetimit, stabilimentet ekzistuese të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit, sistemin ekzistues të shpërndarjes ose njësitë ekzistuese të kërkesës, çdo tre vjet në përputhje me kërkesat dhe procesin e përcaktuar në paragrafët 4.5 deri 4.6.

5 Procedura e kyçjes

OST duhet të ofrojë lidhjen e një marrëveshjeje të kyçjes me kategori të ndryshme të shfrytëzuesve duke iu referuar:

- a) pikave të reja të kyçjes;
- b) pikave ekzistuese të kyçjes;
- c) ndryshimeve të pikave të kyçjes

5.1 Marrëveshjet e kyçjes

5.1.1 Kushtet e përgjithshme të MK

5.1.1.1 Të gjithë **shfrytëzuesit** janë subjekt i të njëjtave kërkesa për kyçje dhe duke hyrë në një **MK** me **OST**, ata duhet të sigurojnë që do t'i përmbahen rregullave, procedurave, specifikimeve teknike dhe kërkesave për pajisje siç parashtrohet në këtë kod, përveç rasteve kur ka ndryshime specifike nga **MK** relevante.

5.1.2 Kushtet specifike të MK

5.1.2.1 **MK** duhet të përmbaj kushtet specifike që janë dakorduar për kyçjen dhe qasjen në **Sistemin e Transmetimit**. Të dhënat dhe shënimet e shkëmbyera duhet të jenë pjesë e **MK** dhe nëse ajo aplikohet, duhet të përfshijë, por nuk kufizohet me disa ose të gjitha pikat e mëposhtme:

- a) Detajet e **pikës së kyçjes** (pronësia, konfigurimi, lista e aseteve shoqëruese, identifikimi dhe nomenklatura e stabilimentit të lidhur me të, nivelet e gabimit, burimit të lidhjes së shkurtë, impedancat, vlerat nominale të pajisjeve shkyçëse, ndërprerësit, tensionet nominale, llojin e

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 10 nga 82</i>

pajisjeve mbrojtëse/kohën e eliminimit të gabimit/akordimet e releve, skemat e shkyçjeve interne, veçoritë specifike automatike etj);

- b) Skemat e mbrojtjes së zbarave dhe akordimet;
- c) Skemat e ndarjes ose ishujve të sistemit të cilat ndikojnë në centralin e gjenerimit;
- d) Akordimet e mbrojtjes së modulit gjenerues të ndjeshme ndaj frekuencës dhe tensionit;
- e) Kapacitetin e regjistruar dhe aftësinë e transferimit të fuqisë të moduleve gjeneruese relevante;
- f) Ngarkesën e dakorduar të autorizuar që mund t'i dërgohet shfrytëzuesit;
- g) Detajet e grupeve matëse, aranzhimet për matje dhe rregullimin e pajisjes për matjen e humbjeve e cila nuk është vendos në pikën e kyçjes;
- h) Detajet mbi kërkesat për TMRr dhe TMT, kontaktet për mbrojtjen, matjen, bllokadat etj.
- i) Periudhat e shqyrtimit për sistemet e mbrojtjes rele;
- j) Protokollet e dakorduara për koordinimin e mirëmbajtjes;
- k) Diagramet operative;
- l) Skemat e vendit të kyçjes;
- m) Ndonjë kusht specifik të veçantë, derogim, etj;
- n) Ndonjë prioritet i veçantë, kusht operativ dhe/ose aranzhim të veçantë të kyçjes apo shkyçjes, të kërkuar për arsye sigurie;
- o) Ndonjë e dhënë tjetër në tekst apo në skema që konsiderohet e nevojshme nga të dyja **palët**.

5.1.2.2 Standardi i shërbimit që do të sigurohet në secilën **pikë të kyçjes** duhet të specifikohet në **MK gjegjëse** dhe do të përfshijë kapacitetin e kyçjes të tillë që në gjendjen normale të operimit, **sistemi i transmetimit** të jetë i aftë të sigurojë këtë kapacitet. Nëse përdoruesi dëshiron të përdor kapacitet më të lartë se sa kapaciteti i kyçjes atëherë ai duhet të bëjë amendamentimin e MK. Kapaciteti i kyçjes do të përfshijë ndryshimin e kërkesave individuale të pikut dhe pashmangshmërisë së përballimit të **ndodhive** të besueshme të paparashikuara.

5.1.2.3 Në **MK** mund të specifikohet kapaciteti i rishikuar i kyçjes në mënyrë që të jetë i disponueshëm gjatë ndërprerjes (ndaljes) të një elementi të vetëm. Ky kapacitet i kyçjes mund të jetë:

- a) zero;
- b) një pjesë e përcaktuar e kapacitetit normal të transmetimit të energjisë;
- c) kapaciteti normal i transmetimit të energjisë.

5.1.2.4 Në **MK** mund të deklarohet pjesa e pritur e kohës në të cilën nuk do të arrihet aftësi normal duke marrë në konsideratë planin specifik, ndikimin sezonal dhe vendndodhjen që mund të ndikoj në performancën dhe në natyrën e ndërprerjes së rastësishme të elementeve.

5.1.3 Aranzhimet e kyçjes

5.1.3.1 Dizajni i kyçjeve mes **Sistemit të Transmetimit** dhe **shfrytëzuesve** do të jetë në përputhje me parimet e vendosura në **kodin e kyçjes**, objekt i ndonjë modifikimi të dakorduar nga **OST**.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 11 nga 82</i>

5.1.3.2 Gjatë procesit të aplikimit të kyçjes, **OST** do të specifikoj nivelin e tensionit, me të cilin do të kyçet **shfrytëzuesi** në përputhje me praktikën e tij për llojin e ngarkesës që do të furnizohet. **OST** mund të specifikoj një tension tjetër të kyçjes nga ai normal për të shmangur ç'rregullimet potenciale të shkaktuara nga aparaturat e **shfrytëzuesit** tek **shfrytëzuesit** e tjerë të **Sistemit të Transmetimit** apo për arsye të tjera teknike ose do të dakordohen mënyra alternative për minimizimin e efekteve të ngarkesave ç'rregulluese.

5.1.3.3 Nëse **OST** e shih të arsyeshme se kyçja do të ishte më e përshtatshme në **sistemin e shpërndarjes**, atëherë **OST** do t'ia referojë aplikimin së bashku me arsyet për vendimin e tij **OSSH**.

5.2 Aplikimi i kyçjes dhe procedura e miratimit

5.2.1 Afatet kohore

Afatet e parashtruara kohore për shqyrtimin e Aplikacionit për Kyçje, implementohen ashtu siç definohen në Metodologjinë e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmetimit.

5.2.2 Aplikimi i kyçjes

5.2.2.1 Për një **pikë të kyçjes** së re ose një modifikim të një **pikë të kyçjes** ekzistuese, secili **shfrytëzues** duhet të paraqesë një aplikim formal të kyçjes tek **OST** duke e informuar për llojin, magnitudën, kohën dhe gjithë informacionin tjetër gjegjë. Ky informacion kërkohet për t'i bërë të mundur **OST** që të vlerësojë aplikimin duke përfshirë mundësinë e transmetimit të energjisë që duhet të ofrojnë pajisjet e sistemit të interkoneksionit. Aplikohet për të dy llojet e aplikantëve, aplikantët për kyçje që kanë nevojë të furnizohen me energji elektrike (**pronarët e stabilimenteve të kërkesës**) ose për aplikantët të cilët dëshirojnë të eksportojnë energjinë elektrike të prodhuar për shitje (pronarët e centraleve gjeneruese). Një **OSSH** që kërkon të kyçet në **Sistemin e Transmetimit** është një **shfrytëzues**.

5.2.2.2 Gjatë fazës fillestare **shfrytëzuesi** do të paraqesë të dhënat e planifikimit standard dhe të dhënat preliminare të planifikimit të projektit siç specifikohet në kodin e planifikimit. Megjithatë këto të dhëna do të trajtohen si të dhëna konfidenciale nga ana e **OST**, ato mund të ndahen me operator tjerë të sistemit nëse kjo është e nevojshme për mbarëvajtjen e aplikimit.

5.2.2.3 Aty ku dizajni ose detajet teknike të paraqitura në aplikimin për kyçje nuk përmbushin kërkesat e specifikuar nga **OST** dhe nuk janë në përputhje me dispozitat e këtij kodi, atëherë **OST** duhet të informojë shfrytëzuesin për mos-përmbushjen e kërkesave të kërkuara.

5.2.2.4 Para dorëzimit të aplikimit formal, shfrytëzuesi mund të ketë kryer një studim të fizibilitetit me **OST** ashtu siç theksohet në kodin e planifikimit. Kjo është një detyrë opsionale dhe në takimin fillestar do të jepet si shërbim gratis nga **OST**. Megjithatë nëse shfrytëzuesi i kërkon **OST** që të kryejë punë më të detajuara shtesë atëherë **OST** mund të kërkojë një pagesë të arsyeshme për të mbuluar kostot e punëve.

5.2.2.5 Të dhënat dhe informacionet e përfshira në aplikacionin për kyçje, **OST** do t'i trajtojë si të dhëna dhe informacione konfidenciale, të cilat duhet të mos zbulohen dhe të mos i jepen ndonjë pale të tretë, përveç nëse **OST** mund t'i jap detaje ndonjë OST-je tjetër, nëse sipas mendimit të arsyeshëm të **OST**-së se kjo është e nevojshme jepen me qëllim që **OST** të mund të kryejë studime dhe planifikime të sistemit. Gjithashtu do të përdoren për t'i mundësuar **OST** që të vlerësojë efektet e pajisjes së propozuar në performancën e **sistemit të transmetimit** dhe për të përcaktuar nivelin e ndonjë prej **shërbimeve ndihmëse** që duhet të sigurohen në atë **pikë të kyçjes**.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 12 nga 82</i>

5.2.3 Oferta për Kyçje

5.2.3.1 **OST** si përgjigje ndaj aplikacionit për kyçje, duhet t'i japë aplikantit një ofertë të plotësuar brenda afatit kohor të përcaktuar në Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit.

5.2.3.2 Kur **OST** siguron ofertën për kyçje, **OST** duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta këshilluar **shfrytëzuesin** rreth rreziqeve dhe obligimeve në lidhje me kyçjen e propozuar të shoqëruar me ndonjë planifikim dhe legjislacion mjedisor.

5.2.3.3 **Shfrytëzuesit** duhet të japin informacion shtesë në lidhje me aplikacionin për kyçje i cili kërkohet në mënyrë të arsyeshme për të vlerësuar performancën teknike dhe kostot e përfshira në ofertë.

5.2.3.4 Nëse aplikacioni për kyçje tregon, ose **OST** ka baza të arsyeshme për të besuar se pajisjet e propozuara për kyçje do të shkaktojnë ç'rregullim të formës së valës, luhatje të tensionit ose mosbalancim mes tri fazave të tensionit në këtë **pikë të kyçjes** apo në ndonjë tjetër, atëherë **OST** duhet ta njoftojë **shfrytëzuesin** rreth niveleve të reduktuara të këtyre efekteve ç'rregulluese që duhet të arrihen para se të kryhet **kyçja**. **OST** gjithashtu duhet t'i japë **shfrytëzuesit** gjithë informacionin e arsyeshëm të kërkuar për t'i bërë të mundur këtij të fundit lehtësime për dizajnin për t'i arritur këto nivele.

5.2.3.5 Në përgatitjen e ofertës për kyçje, **OST** duhet të përfshijë parashikimin për kontrollin dhe monitorimin në distancë të pajisjeve të kërkuar për operimin e sistemit sipas specifikimeve në paragrafin 7.4.2.17.3.4 të këtij kodi.

5.2.3.6 Oferta e kyçjes duhet të përmbajë afatet dhe kushtet e propozuara për kyçjen në **Sistemin e Transmetimit** në lidhje vetëm me asetet e kyçjes dhe stabilimentet dhe aparaturat shoqëruese të cilat janë në përgjegjësinë e **shfrytëzuesit**. **OST** ka përgjegjësi në lidhje me ndryshimet dhe/ose punimet zgjeruese të kërkuara në pjesën tjetër të **Sistemit të Transmetimit**.

5.2.3.7 Oferta e kyçjes duhet të jetë reale dhe e arsyeshme dhe duhet të jetë në përputhje me Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të **Sistemit të Transmetimit**.

5.2.3.8 Oferta e kyçjes mund të përmbajë më tepër se një mundësi për kyçje në **Sistemin e Transmetimit** dhe/ose në nivele të ndryshme të shërbimit dhe me afate dhe kushte të ndryshme.

5.2.3.9 Si **OST** ashtu edhe **shfrytëzuesi** kanë të drejtë të negociojnë në lidhje me parashikimin e kyçjes dhe ndonjë çështje tjetër gjegjëse me parashikimin e kyçjes dhe nëse bëhen negociata të tilla ato duhet të kryhen në mirëbesim.

5.2.3.10 Për kyçje komplekse për shkak të madhësisë, natyrës, vendndodhjes apo afatit kohor të propozimit, **OST** mund të vendosë se kërkohen studime shtesë gjithëpërfshirëse me qëllim të vlerësimit më të plotë të ndikimit të propozimit të **shfrytëzuesit** në **Sistemin e Transmetimit**. Aty ku **OST** gjykon se këto studime janë të nevojshme, oferta e kyçjes mund të dëshmojë zonat që kërkojnë analiza më të detajuara. Para se të kryhen studime të tilla shtesë, **shfrytëzuesi** duhet të tregojë nëse ai dëshiron që **OST** të ndërmarrë punimet e nevojshme në mënyrë që të vazhdojë me ofertën e rishikuar të kyçjes. Në rast të tillë **OST** do t'i mbulohen nga **shfrytëzuesi** kostot e arsyeshme të këtyre studimeve.

5.2.4 Finalizimi i Marrëveshjeve të kyçjes

5.2.4.1 Nëse një **shfrytëzues** dëshiron ta pranojë ofertën e kyçjes, atëherë **shfrytëzuesi** duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 13 nga 82</i>

a) Të informojë **OST** në formë të shkruar, se e pranon ofertën brenda periudhës kohore të përcaktuar në ofertë, e cila në çdo rast duhet të jetë jo më pak se 30 ditë, pas të cilës ajo skadon automatikisht;

b) Brenda 30 ditësh të nënshkruajë **MK** me **OST**;

5.2.4.2 Parashikimi i kyçjes nga ana e **OST** siç detajohet më sipër, mund të bëhet objekt i marrjes së pëlqimit mjedisor dhe planifikues për ndonjë ndryshim të nevojshëm apo punim zgjerues të **Sistemit të Transmetimit. Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit** do t'i caktojë përgjegjësitë e marrjes së pëlqimeve mjedisore dhe planifikuese të nevojshme për punimet që janë objekt i dispozitave të **Ligjit për Energjinë** dhe Udhëzimeve nga Ministria përgjegjëse për energji.

6 Pronësia – kufijtë komercial

6.1 Ndarja e pronësisë

6.1.1 Ndarja e pronësisë mes stabilimenteve dhe aparaturave të **OST-së** dhe **shfrytëzuesit** do të jetë sipas kufirit teknik ashtu siç specifikohet në nenin 6.2, 6.3 dhe 6.4 të këtij kodi. Kufiri komercial në të gjitha rastet do të jetë pika matëse. Kufiri komercial në mes të **Operatorit të Sistemit të Transmetimit** dhe **Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes** është caktuar në bazë të vendimit nr. V_403_2012 të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

6.1.2 **Shfrytëzuesi** do të përgatis një program që tregon kush është përgjegjës për operim dhe mirëmbajtje të ndërprerësit dhe stabilimentit dhe aparaturës tjetër në pikën e kyçjes. **OST** do të përgatisë diagramin operativ që tregon kufijtë e dakorduar të pronësisë. Të dy dokumentet duhet të dakordohen nga secila palë. **OST** dhe **shfrytëzuesi** do të mbajnë kopje të këtij dokumenti. Ndryshimet në aranzhimet e kufijve të propozuar nga secila **palë** duhet të dakordohen paraprakisht dhe do të regjistrohen në diagramet e dhura operative pas dakordimit me **Rregullatorin**.

6.1.3 Furnizimi me energji elektrike mes **palëve** në parim do të jetë një tension tre-fazorë i një vlere të detajuar në **Marrëveshjen e Kyçjes** të pikës së kyçjes në frekuencën nominale 50 Hz.

6.2 Kufiri teknik OST- Centrali i Gjenerimit

Kufiri teknik në mes **OST** dhe **Centralit të Gjenerimit** është pika kyçëse:

- Në mes të sistemit të zbarave të tensionit të lartë dhe fushës transformatorike të transformatorit ngritës;
- Në rast se pronari i centralit të gjenerimit shfrytëzon linjën e transmetimit për shpenzime vetanake, kufiri teknik në mes të **OST** dhe **centralit të gjenerimit** do të trajtohet sikurse një stabiliment i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit (konsumator industrial) ashtu siç është paraqitur në Metodologjinë e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmetimit.

6.3 Kufiri teknik OST - OSSh

Kufiri teknik në mes **OST** dhe **OSSH** është pika e kyçjes:

- fushës transformatorike të transformatorëve energjetikë 220/35/10 (20) kV dhe 110/35/10(20) kV në zbarat 35 kV, 10(20) kV,
- fushës për shpenzime vetanake (35 kV, 10(20) kV) në zbarat e tensionit të mesëm 35 kV, 10(20) kV

Ndërsa zbarat, daljet e tensionit të mesëm duke përfshirë dhe fushat matëse i përkasin **OSSH-së**.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 14 nga 82</i>

6.4 Kufiri teknik OST – Stabilimentet e kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit (Konsumatorët industrial)

Kufiri teknik **OST** – Stabilimentet e kërkesës (Konsumatorë industrial) është skaji fundor i izolatorëve zingjirë të lidhur për portalin fundor të linjave të transmetimit.

Në rastet kur konsumatori industrial dëshiron që përveç aseteve të definuara me kufirin ndarës të bartë në pronësi të **OST** edhe asete tjera atëherë kjo do të përcaktohet në **Marrëveshjen për Kyçje** përmes një kapitulli të veçantë brenda saj.

6.5 Kushtet e veçanta

Rregullat e përgjithshme të mësipërme do të përcillen por secili rast do të varet nga kushtet e veçanta të vendit, shpërndarjes hapësinore të stabilimenteve, llojit të instalimit të **shfrytëzuesit** etj. Megjithatë në secilin rast **pika e kyçjes** dhe kufiri komercial do të përshkruhen në **MK** dhe kjo do të mbështetet plotësisht, aty ku është e nevojshme me diagramet gjegjëse.

6.6 Pronësia dhe funksionimi

6.6.1 **Shfrytëzuesi** është pronar i të gjitha pajisjeve elektrike, stabilimentit dhe aparaturave në anën e **pikës së kyçjes** që i përket **shfrytëzuesit** dhe është përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e sigurtë të atyre aseteve sipas Ligjeve të Kosovës, **Kodit të Rrjetit** dhe **MK**.

6.6.2 Asetet e **shfrytëzuesit** në pikën e kyçjes, pajisjet e ndërlidhjes së **sistemit**, pajisjet matëse dhe komunikuese dhe të gjitha stabilimentet dhe aparaturat shoqëruese me të cilat kanë të bëjnë këto rregulla do të përcaktohen në një listë të detajuar në **MK**.

6.6.3 **OST** është pronar i të gjitha pajisjeve elektrike – stabilimenteve dhe aparaturave – në anën e **Sistemit të Transmetimit** të **pikës së kyçjes**. **OST** do të jetë pronar, do të vë në operim dhe do të mirëmbajë pjesën e tensionit të lartë të nënstacionit në **pikën e kyçjes** dhe të gjitha asetet tjera të kyçjes të cilat mund të kërkohen për kyçjen në **Sistemin e Transmetimit** sipas “Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji”, **Kodit të Rrjetit** dhe dispozitave të **MK**.

7 Kushtet e kyçjes

7.1.1 Kushtet e kyçjes specifikojnë kriteret minimale teknike, dizajnuese dhe operative të cilat duhet të plotësohen nga të gjithë **shfrytëzuesit** e kyçur në **Sistemin e Transmetimit** dhe gjithashtu kriteret të cilat duhet t’i përmbushë **OST** në lidhje me pjesën e **Sistemit të Transmetimit** në secilën **pikë të kyçjes**.

7.1.2 Të gjitha pajisjet në kufirin e pronësisë do të plotësojnë parimet e dizajnit brenda **Kodit të Rrjetit**. **Kyçjet** për hyrje dhe dalje nga **Sistemi i Transmetimit** do të inkorporojnë pajisjen për kyçjen e instalimit të **shfrytëzuesit** në **Sistemin e Transmetimit** nga ana e **OST**.

7.1.3 **Rregullatori** mund të lëshojë urdhëresa që i lirojnë **OST** dhe **shfrytëzuesin** nga plotësimi i dispozitave të mësipërme. Këto do të specifikohen detajisht në **MK** gjegjëse nën shtojcën “përjashtimet specifike të pikës së kyçjes”. Çdo afat apo kusht tjetër i veçantë që aplikohet për një pikë të veçantë të kyçjes gjithashtu do të përfshihet në këtë shtojcë.

7.2 Kërkesat për OST

7.2.1.1 **OST** do të ketë pronësinë dhe do të mirëmbajë **Sistemin e Transmetimit** dhe do ta operojë në përputhje me Standardet e Sigurisë së Operimit, procedurat tjera të operimit dhe me kërkesat e **ENTSO-E**. Kjo do të kryhet në pajtueshmëri me **Kodin e Standardeve Elektrike** për **Sistemin Energjetik** të Kosovës dhe çdo dokument tjetër gjegjës që është në përdorim për planifikimin, funksionimin dhe

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 15 nga 82</i>

sigurinë e **Sistemit të Transmetimit, Kodin e Rrjetit**, të gjitha procedurat e brendshme të **OST** dhe kushtet e aplikueshme të Ligjeve të Kosovës.

7.2.1.2 **OST** do të sigurojë se funksionimi i operimit të sistemit kryhet dhe se **Sistemi i Transmetimit** është në pajtueshmëri me kriteret teknike dizajnuese dhe operative në të gjitha **pikat e kyçjes**.

7.2.2 Frekuenca e sistemit

7.2.2.1 Frekuenca e **Sistemit të Transmetimit** do të jetë kryesisht 50 Hz dhe do mbahet brenda kufijve siç është detajuar në standardet e rregullimit të frekuencës në **Kodin e Balancit**.

7.2.2.2 Stabilimenti i **shfrytëzuesit** duhet të plotësojë kërkesat e standardeve të rregullimit të frekuencës, nëse nuk detajohet në mënyrë të veçantë ndryshe në **MK**.

7.2.3 Tensioni i sistemit

7.2.3.1 Tensioni në **Sistemin e Transmetimit** do të mbetet normalisht brenda kufijve të detajuar në Kodin e Balancit.

7.2.3.2 Duhet të vihet re se në kushte të prishjeve, tensioni mund të bjerë përkohësisht në zero në pikën e prishjes derisa prishja të eliminohet.

7.2.4 Cilësia e formës së valës së tensionit

7.2.4.1 Të gjitha stabilimentet dhe aparaturat e kyçura në **Sistemin e Transmetimit** dhe të gjitha pajisjet e **shfrytëzuesve** duhet të jenë të afta të përballojnë ç'rregullimet e mëposhtme të formave të valës së tensionit në lidhje me harmonikët, mosbalancimin e fazës dhe luhatjen e tensionit.

- a) Ç'rregullimi total harmonik prej 2%;
- b) Në kushtet normale të operimit dhe planifikimit të ndërprerjes, komponenta maksimale negative e sekuencës së fazës të tensionit fazor në **Sistemin Transmetues** nuk duhet të kalojë 1% për 99.5 % të kohës së operimit. Piqet jo të shpeshta me kohëzgjatje të shkurtër lejohen deri në një vlerë maksimale prej 2% për mosbalancimin e fazës.
- c) Luhatjet e tensionit në **pikën e kyçjes** nuk duhet të kalojnë nivelet e caktuara në **kodin e rregullimit të tensionit (Kodi i Balancit)**;
- d) Luhatjet e tensionit në secilën **pikë të kyçjes** me një ngarkesë luhatëse të kyçur drejtpërdrejtë në **Sistemin e Transmetimit** nuk duhet të kalojnë:
 - i) Në nivelet 400 kV dhe 220 kV, intensiteti i luhatjeve (Pst) me kohë të shkurtër me vlerë 0.8 Njësi dhe intensiteti i luhatjeve (Pst) me kohë të gjatë me vlerë 0.6 Njësi.
 - ii) Në 110 kV dhe më poshtë, intensiteti i luhatjeve (Pst) me kohë të shkurtër me vlerë 1.0 Njësi dhe intensiteti i luhatjeve (Pst) me kohë të gjatë me vlerë 0.8 Njësi.

7.2.4.2 Në rast se ndonjë nga vlerat e mësipërme shkelen, atëherë **OST** do të hetojë shkakun e devijimeve të cilësisë dhe t'i identifikojë masat e përshtatshme për t'i eliminuar ato devijime.

7.3 Kërkesat e përgjithshme për të gjithë shfrytëzuesit

7.3.1.1 Secili **shfrytëzues** do ta vë në funksionim dhe do ta mirëmbajë stabilimentin dhe aparaturat në vendin e tij dhe do të dizajnoj pajisjet e reja të kyçura ose modifikimet e propozuara në përputhje me detyrimet e tij statusore sipas licencës, parametrave teknik të **pikës së kyçjes** të përcaktuara në **MK**, standardeve dhe procedurave mbizotëruese të Kosovës të referuara në dokumentet standarde,

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 16 nga 82</i>

praktikave të mira të industriale energjetike dhe dispozitave të të gjitha Ligjeve të aplikueshme të Kosovës.

7.3.1.2 **Shfrytëzuesi** do të pajtohet me të gjitha dispozitat e **Kodi të Rrjetit**, standardet, procedurat dhe specifikimet mbizotëruese për sigurinë, planifikimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e vendit të tij dhe pajisjeve të interkoneksionit të sistemit. **Pronarët e centraleve të gjenerimit** duhet të operojnë dhe të mirëmbajnë centralet e tyre të gjenerimit për të siguruar funksionimin e tyre teknik në mënyrë që aq sa të jetë e mundur, të garantojnë sigurinë e personelit dhe të përmbushin ligjet dhe kuotat mjedisore.

7.3.1.3 Çdo pajisje e centralit të gjenerimit duhet të ketë kërkesat e performansës siç detajohen në Nenin 8 të këtij kodi.

7.3.2 Kërkesa për fuqi aktive

7.3.2.1 **Kërkesa për fuqi aktive** nuk duhet ta kalojë sasinë e specifikuar në **MK**.

7.3.2.2 **Shfrytëzuesit** janë të detyruar të pranojnë dhe ekzekutojnë udhëzimet dhe të vënë në zbatim programin e reduktimit të ngarkesës në rastet e rënies serioze apo potenciale të frekuencës së sistemit të energjisë elektrike. Secili reduktim i ngarkesës do të udhëzohet nga **OST** në bazë të rotacionit të aranzhuar më herët ose do të kryhet automatikisht nga reduktimi i ngarkesës nga nën frekuenca. Kërkesat do të specifikohen në **MK**.

7.3.3 Kërkesa për energji reaktive

7.3.3.1 **Shfrytëzuesit** do të konsumojnë energji elektrike me faktor të fuqisë më të madh se 0.9 siç është matur në **pikën e kyçjes** përveç nëse nuk është dakorduar ndryshe në **MK**. Leximet nga instalimet matëse komerciale në **pikën e kyçjes** do të përdoren për të përcaktuar faktorin aktual të energjisë.

7.3.4 Mbrojtja dhe kontrolli

7.3.4.1 Çdo kyçje mes një **shfrytëzuesi** dhe **Sistemit të Transmetimit** duhet të verifikohet nga një ndërprerës i qarkut që mund të ndërpresë rrymën maksimale të lidhjes së shkurtër në **pikën e kyçjes**. Kjo do të specifikohet në **MK**. Dokumenti: Analiza Vjetore e Rrymave të Lidhjeve të Shkurta në Sistemin e Transmetimit jep vlerat e rrymës të lidhjes së shkurtër, të dhënat nominale për ndërprerësit ekzistues të transmetimit dhe parashikimin e **pikave të kyçjes** për vitet e ardhshme.

7.3.4.2 Mbrojtja e **moduleve gjeneruese**, transformatorëve ngritës, zbarave dhe linjave energjetike që janë në pronësi të **pronarit të centralit të gjenerimit** duhet të jenë në përputhje me standardet gjegjëse në Kosovë siç referohen në dokumentet standarde.

7.3.4.3 Aranzhimet e mbrojtjeve rele kundër prishjeve në **Sistemin e Transmetimit** në pronësi të **pronarit të centralit të gjenerimit**, por jashtë **modulit gjenerues** dhe transformatorëve ngritës, për sa i përket impedancës, rrymës dhe kohës do të koordinohen me **OST**.

7.3.4.4 Kërkesat për reletë e frekuencës së ulët, që mbulojnë aranzhimet e frekuencës, aranzhimet e periudhës së matjes, kohën e operimit, fazat e lehtësimit, kontaktet dalëse dhe kërkesat e furnizimit të tensionit do të specifikohen në **MK**.

7.3.4.5 Parimi i aplikimit është që të gjitha linjat energjetike duhet të kenë të paktën një mbrojtje të dizajnuar për të gjitha llojet e prishjeve. Aranzhimet normale në nivele të ndryshme të tensionit janë si më poshtë:

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 17 nga 82</i>

- a) Për linjat energjetike 400 kV do të sigurohen dy mbrojtje kryesore me shpejtësi të lartë dhe një mbrojtje rezervë;
- b) Për linjat energjetike 110 kV dhe 220 kV do të sigurohen një mbrojtje kryesore dhe një rezervë. Mbrojtja rezervë mund të sigurohet për veprim nga distanca;

7.3.4.6 Kombinimi, lloji dhe funksionet e mbrojtjeve rele do të dakordohen mes **shfrytëzuesit** dhe **OST**.

7.3.4.7 Koha e eliminimit të prishjes për prishjet në një pajisje të **shfrytëzuesit** të kyçur në **Sistemin e Transmetimit**, që nga fillimi i prishjes deri në shuarjen-eliminimin e harkut të qarkut nuk duhet të jenë më të mëdha se:

- a) 90 ms në 400 kV;
- b) 100 ms në 220 kV;
- c) 140 ms në 110 kV;

7.3.4.8 Në rastin kur koha e mësipërme e eliminimit të prishjes nuk përmbushet si rezultat i rënies nga veprimi i sistemeve mbrojtëse kryesore, **shfrytëzuesi** do të siguroj mbrojtje rezervë. **OST** gjithashtu do të sigurojë mbrojtje rezervë dhe këto mbrojtje rezervë do të koordinohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë diskriminim-selektivitet. Mbrojtja rezervë do të funksionojë për të dhënë një kohë të eliminimit të prishjes jo më të madhe se 500 ms në tensionet 110 kV dhe më lartë. Mbrojtja rezervë mund të përfshijë mbrojtjen kundër rënies së ndërprerësit.

7.3.4.9 Në rast të ndonjë prishje në pajisjen lidhëse që lidh sistemet e **OST** dhe të **shfrytëzuesit**, **OST** dhe **shfrytëzuesi** duhet t'i sigurojnë njeri tjetrit sinjalet elektrike të cilat mund të shfrytëzohen për të iniciuar shkyçjen e ndërprerësit adekuat për të izoluar defektin.

7.3.4.10 **Shfrytëzuesit** gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshëm se aranzhimet e mbrojtjes në disa sisteme për disa lloje prishjesh mund të shkaktojnë shkyçjen e një faze ose dy fazave nga furnizimi tre-fazorë.

7.3.4.11 Asnjë mbrojtje rele e zbarës, mbrojtje rele nga prishja e ndërprerësve të qarkut, furnizimet AC ose DC (përveç furnizimit me tension DC ose rënies së ndonjë mikro ndërprerësi i tensionit DC që furnizon stabilimentin dhe aparaturën e **shfrytëzuesit**) nuk do të kryhet apo ndryshohet nga **shfrytëzuesi** ose në emër të tij në mungesë të një përfaqësuesi ose të një autorizimi me shkrim nga **OST**.

7.3.5 Rikycja automatike

7.3.5.1 Aty ku kërkohet ri-kyçja automatike e ndërprerësve të **OST** pas prishjeve në sistemin e **shfrytëzuesit**, pajisjet për kyçje dhe shkyçje automatike do të sigurohen në përputhje me kërkesat e specifikuar në **MK**.

7.3.5.2 Lloji i ri-kyçjes automatike – një-fazore, tre-fazore, kontrolli i sinkronizimit ose mungesa e tensionit – për linjat energjetike që kyçin vendin e **shfrytëzuesit** me **Sistemin e Transmetimit** do të specifikohet në **MK**.

7.3.5.3 **OST** nëse i kërkohet, do të japë detajet e ri-kyçjes automatike ose karakteristikave të sekuencës së kyçjeve-shkyçjeve në **sistemin e transmetimit** në mënyrë që **shfrytëzuesi** të mund ta marrë këtë në konsideratë në dizajnimin e sistemit të tij, duke përfshirë aranzhimet e mbrojtjeve.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 18 nga 82</i>

7.3.6 Aranzhimet e mbrojtjeve

7.3.6.1 Aranzhimet e mbrojtjeve rele do të koordinohen për kyçjet ekzistuese, të reja dhe/ose të modifikuara dhe do të azhurnohen përmes **pikës së kyçjes** ashtu siç parashtrahet në secilën **MK** për të siguruar shkyçjen efikase të pajisjeve në prishje. Të gjitha të dhënat që kërkohen në mënyrë të arsyeshme duhet të regjistrohen në **MK** dhe freskohen nga të dy **palët** në rastet kur ka ndryshime në të dhëna. Ky informacion së paku duhet të përfshijë:

- a) Lidhjet e shkurta të brendshme dhe të jashtme (nivelet e prishjeve dhe burimet furnizuese të prishjes të supozuara në kohën kur janë specifikuar aranzhimet (akordimet) e mbrojtjes;
- b) Llojin e pajisjeve mbrojtëse, kohën e eliminimit të prishjes, aranzhimet e releve;
- c) Aranzhimin e mbrojtjes diferenciale për modulën gjenerues/njësinë e transformatorit ngritës/linjat në distancë të shkurtër;
- d) Aranzhimin e mbrojtjes të **modulit gjenerues**;
 - Ngarkesa asimetrike (sekuenca negative e fazës)
 - Mbi/nën tensioni në terminalet e statorit;
 - Oscilimet e fuqisë,
 - Rryma e startimit,
 - Mbrojtja ndaj torzionit (momentit) të palejshëm të boshtit,
 - Tej-fluksi (U/f),
 - Fuqia kthyese,
 - Shkalla e ndryshimit të frekuencës, dhe
 - Zhvendosja e tensionit
- e) Akordimi i releve të moduleve gjeneruese në senzitivitet ndaj frekuencës dhe tensionit;
- f) Mbrojtja e bllok - transformatorit;
- g) Mbrojtjen e zbarës;
- h) Mbrojtja e stabilimenteve të kërkesës;
- i) Mbrojtja rezervë dhe mbrojtja nga dështimi i pajisjeve shkyçëse;
- j) Çdo pajisje e veçantë automatike e vendosur në lokacionin specifik;
- k) Diagramet e operimit dhe sigurisë;
- l) Vizatimet (skicat) e vendit.

7.3.6.2 Pronari i centralit të gjenerimit duhet të organizoj pajisjet e tij të mbrojtjes dhe të kontrollit në përputhje me renditjen e prioriteteve (nga më i lartë deri në më i ulët):

- a) Mbrojtja e rrjetit dhe modulit të gjenerimit;
- b) Rregullimi i frekuencës (përshtatja e fuqisë aktive);
- c) Reduktimet e fuqisë; dhe
- d) Kufizimi i gradientit të fuqisë;

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 19 nga 82</i>

7.3.6.3 Sa i përket renditjes së prioriteteve të mbrojtjes dhe kontrollit, pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit duhet të vendosë pajisjet e mbrojtjes dhe kontrollit të stabilimentit të tij të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose në stabilimentin e tij të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit përkatësisht, në përputhje me rangimin e prioriteteve të mëposhtme, të organizuar me një renditje sipas rëndësisë:

- a) Mbrojtja e rrjetit të transmetimit;
- b) Mbrojtja e stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose e sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit;
- c) Rregullimi i frekuencës (përshtatja e fuqisë aktive);
- d) Reduktimi i ngarkesës.

7.3.7 Komunikimet e mbrojtjes

7.3.7.1 Komunikimet për përshpejtimin e sinjaleve të mbrojtjes rele dhe shkyçjen e komanduar nga distanca të ndërprerësve të qarqeve do të jenë objekt i dizajnit dhe dakordimit mes **shfrytëzuesit** dhe **OST**.

7.3.7.2 Për të gjitha linjat që kyçin një **central të gjenerimit** me **Sistemin e Transmetimit** duhet të sigurohen dy kanale komunikuese të pavarura nga njëra tjetra dhe të paktën njëra e pavarur nga linja që do të mbrohet - duhet të sigurohen për mbrojtjet rele të instaluara në të dy skajet e linjës energjetike kyçëse dhe koha për transmetimin e sinjaleve nuk duhet të jetë më shumë se 20 ms. Këto kanale komunikuese mund të përdoren, nëse kërkohet, për shkyçje nga distanca e ndërprerësit fqinjë nën veprimin e mbrojtjes nga prishja e rënies së ndërprerësit.

7.3.7.3 **OPGW - Optical Ground Wire, PLC¹- Power Line Carrier** ose ndonjë formë tjetër komunikimi mund të përdoret për t'i siguruar këto pajisje. Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të komunikimit do të jetë përgjegjësi e pronarit të ndërprerësit në të cilën ato duhet të montohen. Në rastin kur pajisjet e komunikimit merren me qera (shfrytëzohen pajisjet e komunikimit të **OST**), përgjegjësia për kostot do të detajohet në **MK**.

7.3.8 Pajisja sinkronizuese

7.3.8.1 Ndërprerësit e nivelit 110 kV e më lart duhet të pajisen me sisteme për kontrollimin e sinkronizimit.

7.3.8.2 Të gjitha **modulet gjeneruese** të sinkronizuara duhet të pajisen me sisteme precize automatike sinkronizuese.

7.3.8.3 Sinkronizimi i moduleve gjeneruese duhet të jetë i mundur në frekuencat brenda intervaleve të paraqitura në Tabelën 1, paragrafi 8.2.1;

7.3.8.4 **OST** dhe pronari i centralit të gjenerimit dakordohen për parametrat e pajisjeve të sinkronizimit, që duhet të arrihet para se të futet në funksion moduli i gjenerimit. Kjo marrëveshje duhet të mbulojë:

- a) tensionin;
- b) frekuencën;

¹ PLC – Power Line Currier – Bartës (i informatave) përmes linjave të tensionit të lartë

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 20 nga 82</i>

- c) brezin e këndit fazor;
- d) sekuencën e fazës;
- e) devijimin e tensionit dhe frekuencës.

7.3.8.5 Sa i përket sinkronizimit, kur futet në funksion një modul i gjenerimit të kyçur në rrjetin e transmetimit, sinkronizimi duhet të bëhet nga pronari i centralit të gjenerimit vetëm pas autorizimit nga **OST**.

7.3.9 Varshmëria e mbrojtjeve

Performanca e synuar për indeksin e varshmërisë për rëniet nga sistemi duhet të jetë më pak se 99%. Kjo është një matje e aftësisë së mbrojtjeve për të operuar në mënyrë që të iniciojnë shkyçjen e suksesshme të ndërprerësve të qarkut të cilët janë të lidhur me pajisjet në prishje.

7.3.10 Pajisjet e regjistrimit të prishjeve

Kur pajisjet e regjistrimit të prishjeve kërkohen nga **OST**, kërkesat e tyre teknike duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet e analizës së prishjeve të pajisjeve të përgatitura dhe të rishikuara nga **OST**.

7.3.11 Tokëzimi

Të gjithë transformatorët me lidhje ylli në **pikën e kyçjes** (ana e TM) duhet të tokëzohen përmes rezistencës në pajtueshmëri me standardet specifike të IEC përndryshe e specifikuar në MK.

7.3.12 Konsiderimet e nivelit të prishjeve

Rryma e lidhjes së shkurtër të pajisjeve të **shfrytëzuesit** në **pikën e kyçjes** duhet të jetë në pajtueshmëri me nivelin e prishjeve të dizajnuara të **pikës së kyçjes**.

7.3.13 Monitorimi i sistemit


Shfrytëzuesi do të sigurojë matjen e standardeve të kualitetit si tensionin, rrymën, frekuencën, **fuqinë aktive** dhe **fuqinë reaktive**, të dhënat e pozitës së rregullatorit të transformatorit dhe pikat e statusit nga sistemi i tij siç specifikohet në **MK**. Në një situatë të tillë nga **OST** do të sigurohet, instalohet dhe mirëmbahet telemetria për qasje nga distanca RTU² (ose ekuivalente). Pronarët e centraleve të gjenerimit duhet të furnizojnë **OST** me sinjale të nevojshme për monitorimin nga distanca në kohë reale të moduleve të tyre gjeneruese duke përfshirë **modulet gjeneruese** me një gjenerim prej 5 MW e më shumë të kyçura në **sistemin e shpërndarjes**. **OST** do të vë në dispozicion të publikut listën e saktë të të dhënave të kërkuara.

7.3.14 Komunikimet

7.3.14.1 Aty ku kërkohet nga **OST**, komunikimi mes **shfrytëzuesve** dhe **OST** do të vendoset siç është specifikuar në **MK**. Këto komunikime do të përfshijnë disa ose të gjitha mjetet e mëposhtme:

- a) Pajisjen primare për bartjen e komunikimit (zërit);

² Remote Terminal Unit

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 21 nga 82</i>

- b) Pajisjen rezervë ose emergjente që vë në përdorim linja komunikimi dhe furnizim me energji komplet të pavarur nga pajisja primare;
- c) Faksin;
- d) Telemetrinë RTU për monitorimin e sistemit sipas paragrafit 7.3.13;
- e) Bartjen e të dhënave në formë elektronike;
- f) Emailin;
- g) Bartjen e të dhënave nga njehsori, kryesor dhe kontrollues sipas kërkesave të **kodit të matjes**.

7.3.14.2 Kërkesat aktuale në secilin rast të veçantë do të detajohen në **MK**.

7.3.15 Kushtet në vendin e kyçjes

OST dhe **shfrytëzuesi** për çdo **pikë të kyçjes** do të dakordohen rreth programeve të përgjegjësisë së vendit të kyçjes, që përfshijnë:

- a) Detajet e pronësisë, kontrollit, veprimit dhe mirëmbajtjes në secilën **pikë të kyçjes**;
- b) Vizatimet e përbashkëta të vendit – sipas një formati të përcaktuar;
- c) Diagramin operativ – sipas një formati të përcaktuar;
- d) Programin e stabilimentit dhe aparaturave të TL;
- e) Programin e telekomunikacionit dhe pajisjen e telemetrisë;
- f) Detajet e instalimit të njehsorëve;
- g) Aranzhimet e qasjes në vend (vizitat në teren);
- h) Informacioni i mbrojtjes;
- i) Skemat e bllokadave;
- j) Informacioni mbi kryerjen e punimeve të mbrojtjes;
- k) Planet e mirëmbajtjes;
- l) Përgjegjësit e menaxhimit të sigurisë.

7.3.16 Identifikimi i stabilimentit dhe aparaturave


OST dhe shfrytëzuesi relevant do të ndjekin kërkesat e kodit të identifikimit të stabilimentit dhe aparaturave (kodit operativ).

7.3.17 Mbajtja e të dhënave

Secili shfrytëzues duhet të mbajë të dhënat për 5 vite, për secilën prej pikave të kyçjes për të gjitha njesitë e stabilimentit kryesor, duke treguar detajet e rezultateve të të gjitha performancave teknike dhe të monitorimit të kryera sipas dispozitave të kapitullit 8 të këtij kodi.

7.3.18 Qasja

Shfrytëzuesi i jep **OST**-së të gjitha të drejtat e përhershme të nevojshme të qasjes brenda zonës së tij, të cilat kërkojnë për ndërtimin, pajisjen, zëvendësimin, dekomisionimin, operimin, testimin, inspektimin dhe mirëmbajtjen e sistemit, pajisjeve nderlidhese, në përputhje me standardet dhe procedurat mbizotëruese aktuale të Kosovës për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të TL-së (Tensionit të Lartë).

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 22 nga 82</i>

8 Kërkesat për modulet gjeneruese

8.1 Kërkesa të përgjithshme

Pronarët e centraleve të gjenerimit do të operojnë dhe mirëmbajnë pajisjet e rregullimit të tensionit të **moduleve gjeneruese** të tyre, pajisjet e rregullimit të frekuencës të **moduleve gjeneruese** të tyre dhe rregullimit të fuqisë reaktive të pajisjeve ndërlidhëse të sistemit në pajtueshmëri të plotë me këtë kod dhe me udhëzimet e marra nga **OST** për funksionimin dhe sigurinë e **Sistemit të Transmetimit**.

8.1.1 Brezi i frekuencës

8.1.1.1 Në lidhje me brezin e frekuencës:

- a) një **modul i gjenerimit** duhet të jetë në gjendje të qëndrojë i kyçur në rrjet dhe të operojë brenda brezit të frekuencës dhe periudhave kohore të specifikuar në Tabelën 1;
- b) **OST** dhe **pronari i centralit të gjenerimit** mund të dakordohen për brez më të gjërë të frekuencës, për period kohore më të gjatë të operimit ose për kërkesa specifike për frekuencë të kombinuar dhe devijim të tensionit për të siguruar përdorimin më të mirë të aftësive teknike të një **moduli gjenerues**, nëse kërkohet për të ruajtur ose për të rivendosur sigurinë e sistemit;
- c) **pronari i centralit të gjenerimit** nuk refuzon pa arsye pëlqimin për të aplikuar brez më të gjerë të frekuencës ose period kohore më të gjatë për operim, duke marrë parasysh fizibilitetin teknik dhe ekonomik.

Tabela 1: Kjo tabelë tregon periudhat minimale kohore që një modul i gjenerimit duhet të jetë në gjendje të operojë për frekuenca të ndryshme që devijojnë nga vlera nominale pa u shkycur nga rrjeti.

Brezi i frekuencës	Periudhat kohore për operim
47.5 Hz – 48.5 Hz	30 minuta
48.5 Hz – 49.0 Hz	60 minuta
49.0 Hz – 51.0 Hz	kontinual
51.0 Hz – 51.5 Hz	30 minuta

8.1.2 Aftësia e qëndrueshmërisë ndaj shkallës së ndryshimit të frekuencës

8.1.2.1 Sa i përket aftësisë së qëndrueshmërisë ndaj ndryshimit të frekuencës, një **modul i gjenerimit** duhet të jetë në gjendje të qëndrojë i kyçur në rrjet dhe të operojë për shkallë të ndryshimit të frekuencës deri në vlerën prej -1.0 Hz/sek. dhe +1.0 Hz/sek., përveç nëse nxitet nga lloji: humbja e mbrojtjes kryesore nga shkalla e ndryshimit të frekuencës.

8.1.2.2 **Modulet e gjenerimit** duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme në lidhje me stabilitetin e frekuencës:

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 23 nga 82</i>

- a) në lidhje me rregullimin e fuqisë aktive dhe brezin e rregullimit, sistemi i rregullimit të **moduleve gjeneruese** duhet të jetë në gjendje të kontrolloj pikën e punës (fuqisë aktive) në përputhje me udhëzimet e dhëna **pronarit të centralit të gjenerimit nga OST**.
- b) **OST** do të përcaktojë periudhën brenda së cilës duhet të arrihet pika e punës së fuqisë aktive të rregulluar. **OST** përcakton një tolerancë (në varësi të disponueshmërisë së burimit primar të energjisë) që aplikohet në pikën e re të punës dhe kohën brenda së cilës duhet të arrihet;
- c) masat manuale lokale do të lejohen në rastet kur pajisjet automatike të rregullimit nga distanca janë jashtë shërbimit.
- d) **OST** njofton autoritetin rregullator për kohën e nevojshme për arritjen e pikës së punës së bashku me tolerancën për fuqinë aktive;

8.1.3 Reagimi i fuqisë aktive në frekuencë

8.1.3.1 Në lidhje me **modusin senzitiv në frekuencë i kufizuar - mbi-frekuenca (MSFK-M)**, zbatohen si në vijim siç përcaktohet nga **OST** për zonën e saj rregulluese në koordinim me OST-të e zonës së njejtë sinkrone për të siguruar ndikime minimale në zonat fqinje:

- a) **moduli gjenerues** duhet të jetë në gjendje të aktivizoj shërbimin e ndjeshmërisë së fuqisë aktive ndaj frekuencës, sipas Figurës 1, në pragun e frekuencës dhe vlerat e rënjes të përcaktuara nga **OST**;
- b) pragu i frekuencës duhet të jetë mes dhe duke përfshirë 50,2 Hz dhe 50,5 Hz
- c) vlerat e karakteristikës duhet të jenë mes 2 % dhe 12 %;
- d) **Moduli gjenerues** duhet të jetë në gjendje të aktivizojë ndjeshmërinë e fuqisë aktive në frekuencë me një vonesë fillestare e cila duhet të jetë sa më e shkurtë që të jetë e mundur. Nëse vonesa është më e gjatë se dy sekonda, pronari i centralit të gjenerimit duhet të justifikojë vonesën, duke i ofruar **OST**-së dëshmi teknike;
- e) **OST** mund të kërkojë që pas arritjes së nivelit minimal të rregullimit, moduli gjenerues të jetë në gjendje të:
 - vazhdojë operimin në këtë nivel; ose
 - vazhdojë të ulë prodhimin e fuqisë aktive;
- f) Moduli gjenerues duhet të jetë në gjendje të operojë në mënyrë stabile gjatë operimit në **MSFK-M**. Kur **MSFK-M** është aktive, pika e punës së **MSFK-M** do të mbizotërojë mbi çdo pikë pune tjetër të fuqisë aktive.

8.1.3.2 **Moduli gjenerues** duhet të jetë në gjendje të mbajë prodhimin konstant në vlerën e synuar të fuqisë aktive, pavarësisht ndryshimeve në frekuencë, përveç kur fuqia dalëse ndjek ndryshimet e specifikuar në kontekstin e paragrafëve 8.1.3.1 dhe 8.1.3.3 ose paragrafit 8.1.3.8 dhe 8.1.4.8 siç është e zbatueshme.

8.1.3.3 Reduktimi i pranueshëm i fuqisë aktive nga fuqia dalëse maksimale gjatë rënjes së frekuencës lejohet dhe nuk duhet të kalojë shkallën e reduktimit prej 2% të kapacitetit maksimal në frekuencën 50 Hz për rënjen për 1 Hz të frekuencës, siç ilustron me vija të plota në Figurën 2.

8.1.3.4 Reduktimi i pranueshëm i fuqisë aktive nga fuqia dalëse maksimale duhet të:

- a) specifikon qartazi kushtet e aplikueshme të ambientit;

b) merr parasysh kapacitetet teknike të moduleve gjeneruese.




Figura 1. Aftësia e ndjeshmërisë së fuqisë aktive ndaj frekuencës të **moduleve gjeneruese** sinkrone në **MSFK-M**. ΔP është ndryshimi i fuqisë aktive dalëse nga **moduli gjenerues**. Në mbi-frekuencat ku Δf është mbi Δf_1 , **moduli gjenerues** duhet të sigurojë një ndryshim negativ të fuqisë aktive dalëse sipas karakteristikës të rënies S_2 .




Figura 2: Reduktimi i pranueshëm i fuqisë aktive

8.1.3.5 Në lidhje me rregullimin e fuqisë aktive dhe brezin e rregullimit, sistemi rregullues i **modulit gjenerues** duhet të jetë në gjendje që të përshtatë pikën e punës së fuqisë aktive në përputhje me udhëzimet e dhëna nga **OST** për **pronarin e centralit të gjenerimit**.

8.1.3.6 **OST** do të përcaktoj periudhën brenda së cilës duhet të arrihet pika e punës e rregullshme e fuqisë aktive. **OST** do të përcaktoj një tolerancë (në varësi të disponueshmërisë së burimit primar) që aplikohet në pikën e re të punës dhe kohën brenda së cilës duhet të arrihet;

8.1.3.7 Masat manuale lokale do të lejohen në rastet kur pajisjet automatike të rregullimit nga distanca janë jashtë shërbimit. **OST** do të njofton autoritetin rregullator për kohën e nevojshme që të arrihet pika e punës së bashku me tolerancën për fuqinë aktive;

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 25 nga 82</i>

8.1.3.8 Në lidhje me modusin sensitiv në frekuencë i kufizuar - nën-frekuenca (**MSFK-N**), kërkesat e mëposhtme zbatohen për **modulet e gjenerimit**:

a) **Moduli i gjenerimit** duhet të jetë në gjendje të aktivizojë shërbimin e ndjeshmërisë së fuqisë aktive ndaj frekuencës në pragun e frekuencës dhe me rënie të përcaktuar nga **OST** në koordinim me **OST** e të njëjtës zonë sinkrone si në vijim:

- pragu i frekuencës i përcaktuar nga **OST** duhet të jetë në mes dhe duke përfshirë 49,8 Hz dhe 49,5 Hz,
- vlerat e karakteristikës rënëse të përcaktuara nga **OST** duhet të jenë në intervalin prej 2-12 %.

Kjo është paraqitur në Figurën 3;

b) realizimi aktual i ndjeshmërisë së fuqisë aktive ndaj frekuencës në modusin **MSFK-N** do të merr parasysh:

- kushtet e ambientit kur duhet të aktivizohet ndjeshmëria,
- kushtet e operimit të modulit të gjenerimit, në veçanti kufizimet gjatë operimit afër kapacitetit maksimal në frekuenca të ulëta;
- disponueshmëria e burimeve primare të energjisë.

c) aktivizimi i ndjeshmërisë së fuqisë aktive ndaj frekuencës nga moduli i gjenerimit nuk duhet të vonohet pa arsye. Në rast të ndonjë vonese më të gjatë se dy sekonda, **pronari i centralit gjenerues** duhet t'ia justifikojë këtë **OST**-së;

d) në modusin **MSFK-N**, moduli i gjenerimit duhet të jetë në gjendje të sigurojë një rritje të fuqisë deri në kapacitetin maksimal të tij;

e) duhet të sigurohet operim stabil i modulit të gjenerimit gjatë operimit në **MSFK-N**;




Figura 3. Aftësia në ndjeshmëri të fuqisë aktive ndaj frekuencës të moduleve sinkrone të gjenerimit në MSFK-N. ΔP është ndryshimi i fuqisë aktive dalëse nga moduli gjenerues. Në nën-frekuencat ku Δf është nën Δf_1 ,

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 26 nga 82</i>

moduli i gjenerimit duhet të sigurojë një ndryshim pozitiv të fuqisë dalëse aktive sipas karakteristikës rënëse S2.

8.1.4 Rregullimi i fuqisë aktive

8.1.4.1 Të gjitha turbinat sinkrone me gaz dhe **modulet gjeneruese** hidro me kapacitet mbi **1 MW** dhe modulet gjeneruese termo mbi **5 MW** duhet të pajisen me sisteme automatike të rregullimit të shpejtësisë së turbinës dhe të fuqisë aktive.

8.1.4.2 Rregullatori i shpejtësisë të secilit **modul gjenerues** duhet të jetë i aftë të operoj brenda kufijve teknik të **moduleve gjeneruese** dhe kufijve të frekuencës të përcaktuar si në paragrafin 8.1.1.

8.1.4.3 Rregullatori i shpejtësisë në koordinim me pajisjet e tjera të rregullimit duhet të rregullojnë fuqinë aktive të **modulit gjenerues** me stabilitet përgjatë gjithë kohës operuese të **modulit gjenerues** dhe duhet të jetë i aftë të ruajë fuqinë aktive të vendosur të modulit gjenerues me një saktësi si në vijim:

- a) për njësitë deri në 20 MW - jo më pak se $\pm 2\%$ të fuqisë nominale;
- b) Për njësitë mbi 20 MW - jo më pak se $\pm 1\%$ të fuqisë nominale.

8.1.4.4 Të gjitha **modulet gjeneruese** me kapacitet të regjistruar prej së paku **10 MW** duhet të kenë aftësinë për të siguruar rregullim sekondar, me kohën e reagimit dhe kohëzgjatjen e përcaktuar në kodin e rregullimit të frekuencës (brenda kodit të balancit).

8.1.4.5 Çdo **modul gjenerues** me kapacitet të regjistruar prej së paku **10 MW** duhet të ketë të instaluar pajisje të përshtatshme për të pranuar sinjale LFC nga **OST**. **OST** do të përcaktojë përzgjedhjen dhe përdorimin e këtij funksioni për të siguruar që sistemi elektroenergjetik i Kosovës të përmbushë kërkesat e rregullave dhe standardeve të **ENTSO-E**, siç përcaktohet në kodin e rregullimit të frekuencës (brenda kodit të balancit).

8.1.4.6 Kriteret e sinjalizimit të sistemit LFC janë si në vijim:

- a) Saktësia prej 0.5 deri në 1.5% për matjen e fuqisë aktive;
- b) Saktësia prej 1.5 mHz për matjen e frekuencës;
- c) Koha e azhurnimit të rregullimit për jo më gjatë se dy sekonda;
- d) Në lidhje me ato si më sipër, sistemi i **SCADA/EMS** së **OST** vazhdimisht do të tregoj fuqinë aktive dalëse, kufijtë e sipërm dhe të ulët të operimit, si dhe shkallën e rritjes/zvogelimit.

8.1.4.7 Të gjitha **modulet gjeneruese** me kapacitet të regjistruar prej **20 MW** ose më shumë duhet të kenë aftësinë të sigurojnë rregullimin primar ngarkesë - frekuencë, respektivisht duhet të operojnë në **Modusin sensitiv në frekuencë (MSF)** gjatë gjithë operimit, përveç nëse **OST** e liron nga ky obligim sipas kushteve të ndonjë derogimi.

8.1.4.8 **Moduli gjenerues** duhet të jetë në gjendje të ofrojë ndjeshmëri të fuqisë aktive ndaj frekuencës në përputhje me parametrat e përcaktuar nga **OST** brenda intervaleve të paraqitura në Tabelën 2 dhe Figurën 4. Në përcaktimin e këtyre parametrave, **OST** duhet të marrë parasysh faktet në vijim:

- a) në rast të mbi-frekuencës, reagimi i fuqisë aktive ndaj frekuencës kufizohet nga niveli minimal i rregullimit,
- b) Në rast të nën-frekuencës, reagimi i fuqisë aktive ndaj frekuencës kufizohet nga kapaciteti maksimal,
- c) realizimi aktual i reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës varet nga kushtet operuese dhe mjedisore të **modulit gjenerues** në momentin e nxitjes së reagimit, sidomos kufizimet në

operim afër kapacitetit maksimal në frekuenca të ulëta dhe burimet primare të energjisë në dispozicion;

Tabela 2: Parametrat për reagimin e fuqisë aktive ndaj frekuencës

Parametrat		Brezi
Brezi i fuqisë aktive në relacion me kapacitetin maksimal $\frac{ \Delta P_1 }{P_{max}}$		1.5 - 10 %
Mos ndjeshmëria e reagimit në frekuencë	$ \Delta f_i $	10 - 30 mHz
	$\frac{ \Delta f_i }{f_n}$	0.02 - 0.06 %
Brezi i vdekur i reagimit në frekuencë		0 - 500 mHz
Karakteristika e rënies s1		2-12 %




Figura 4. Aftësia e reagimit e fuqisë aktive ndaj frekuencës - e moduleve gjeneruese në MSF që ilustron rastin e zonës së vdekur dhe të mos-ndjeshmërisë. P_{max} është fuqia referuese aktive me të cilën ndërlihet ΔP . ΔP është ndryshimi në fuqinë dalëse aktive nga moduli gjenerues. f_n është frekuenca nominale (50 Hz) në rrjet dhe Δf është devijimi i frekuencës në rrjet.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 28 nga 82</i>

- d) Rregulatori i shpejtësisë duhet të jetë i aftë të përshtatet sipas udhëzimeve nga **OST**;
- e) Zona e vdekur e reagimit të devijimit në frekuencë dhe karakteristika rënëse duhet të jetë i mundshëm që të rivendoset në mënyrë të përsëritur;
- f) Në rast të ndryshimit shkallë të frekuencës, **moduli i gjenerimit** duhet të jetë i aftë të aktivizojë reagimin e plotë të fuqisë aktive ndaj frekuencës, në ose mbi vijën e plotë të paraqitur në Figurën 5, në përputhje me parametrat e përcaktuar nga **OST** (i cili synon shmangien e oscilimeve të fuqisë aktive për **modulin gjenerues**) brenda brezit të dhënë në Tabelën 3. Kombinimi i zgjedhjes së parametrave të përcaktuar nga **OST** merr parasysh kufizimet e mundshme të varura nga teknologjia;
- g) Aktivizimi fillestar i reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës - nuk vonohet tepër.
- h) Nëse vonesa në aktivizimin fillestar të reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës është më e madhe se dy sekonda, pronari i centralit gjenerues duhet të ofroj dëshmi teknike duke demonstruar se pse nevojitet kohë më e gjatë.
- i) **Moduli gjenerues** është në gjendje të ofroj një reagim të plotë të fuqisë aktive ndaj frekuencës - për një periudhë prej 15 dhe 30 minuta, siç përcaktohet nga **OST**. Në specifikimin e periudhës, **OST** do të ketë parasysh brezin e fuqisë aktive dhe burimin primar të energjisë të modulit gjenerues;




Figura 5. Aftësia e reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës / aktivizim i plotë

Tabela 3. Parametrat për aktivizim të plotë të reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës - që rezulton nga ndryshimi shkallë i frekuencës (shpjegimi për figurën 4)

Parametrat	Vlerat
Brezi i fuqisë aktive në relacion me kapacitetin maksimal (brezi i reagimit ndaj frekuencës $\frac{ \Delta P_1 }{P_{max}}$)	2-10%
Vonesa fillestare t_1	≤ 2 sekonda

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 29 nga 82</i>

Parametrat	Vlerat
Koha e aktivizimit të plotë t_2	≤ 30

- j) sa i përket rivendosjes së rregullimit të frekuencës, **moduli gjenerues** do të ofrojë funksionet që janë në përputhje me specifikimet e **OST**, të cilat kanë për qëllim rivendosjen e frekuencës në vlerën e saj nominale apo ruajtjen e rrjedhave të shkëmbimit të energjisë elektrike ndërmjet zonave rregulluese në vlerat e tyre të programuara;
- k) sa i përket shkyçjes për shkak të nën-frekuencës, centralet gjeneruese që janë në gjendje të veprojnë si ngarkesë, duke përfshirë centralet gjeneruese të hidrocentraleve reverzibile, duhet të jenë në gjendje të shkyçin ngarkesën e tyre në rast të nën-frekuencës. Kërkesa e referuar në këtë pikë nuk përfshinë konsumin vetanak të centralit;
- l) sa i përket monitorimit në kohë reale të **Modusit Sensitiv në Frekuencë (MSF)**:
- për monitorimin e reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës, ndërfaqja e komunikimit do të jetë e pajisur për të transmetuar në kohë reale dhe në mënyrë të sigurt nga centrali gjenerues në qendrën e dispecerike të **OST**, me kërkesë të **OST**, së paku sinjalet në vijim: sinjalin e statusit të **MSF** (on/off), fuqia aktive dalëse e programuar, vlera aktuale e fuqisë aktive, parametrat aktual të vendosura të reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës, karakteristika rënëse dhe zona e vdekur;
 - **OST** do të specifikojë sinjale shtesë që duhet të ofrohen nga centrali gjenerues përmes pajisjeve monitoruese dhe regjistruese në mënyrë që të verifikohet performanca e ofrimit të reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës - të moduleve pjesëmarrëse gjeneruese.

8.1.5 Modelet e simulimit të moduleve gjeneruese


8.1.5.1 Me kërkesën e **OST**, **pronari i centralit të gjenerimit** ofron modele të simulimit të cilat pasqyrojnë sjelljen e duhur të **modulit gjenerues** për të dy gjendjet të qëndrueshme dhe dinamike (komponenti 50 Hz) apo simulimet elektromagnetike kalimtare.

8.1.5.2 **Pronari i centralit të gjenerimit** siguron që të gjitha modelet e ofruara janë verifikuar kundrejt rezultateve të testeve të përputhshmërisë të referuara në paragrafët 8.5.7 dhe 8.5.8 dhe njofton **OST** për rezultatet e verifikimit;

8.1.5.3 Modelet e ofruara nga **pronari i centralit të gjenerimit** përmbajnë nën-modele, varësisht nga ekzistenca e komponentëve individuale:

- a) Statori dhe turbina,
- b) rregullatori i shpejtësisë dhe fuqisë,
- c) rregullatori i tensionit, duke përfshirë, nëse është i aplikueshëm, funksionin e **stabilizuesit të oscilimeve të fuqisë (SOF)** dhe sistemin për rregullimin e eksitimit,
- d) modelet e mbrojtjes së modulit gjenerues, siç është dakorduar ndërmjet **OST** dhe **pronarit të centralit të gjenerimit**, dhe
- e) modelet e konvertorit për modulet e parkut gjenerues;

8.1.5.4 Kërkesa nga **OST** e referuar në pikën a) përfshinë:

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 30 nga 82</i>

- a) formati i **PSS/E** apo formateve të ngjajshme sipas të cilit do të ofrohen modelet.
- b) ofrimi i dokumentacionit mbi strukturën e modelit dhe bllok diagramet.
- c) një vlerësim të kapacitetit minimal dhe maksimal të lidhjes së shkurtër në pikën e kyçjes, i shprehur në MVA, si ekuivalent i rrjetit;

8.1.5.5 Nëse kërkohet, pronari i centralite gjeneruese ofron regjistrime të performancës së **moduleve gjeneruese** tek **OST**. **OST** mund të bëjë një kërkesë të tillë në mënyrë që të krahasojë reagimin e modeleve me regjistrimet;

8.1.6 Kërkesat për stabilitetin e tensionit

8.1.6.1 Të gjitha **modulet gjeneruese** të kyçura në nivelin 400 kV, 220 kV apo 110 kV (nëpërmjet transformatorit ngritës) në lidhje me kufijtë e tensionit do ti përmbushin kërkesat në vijim:

- a) **moduli gjenerues** është i aftë të qëndrojë i kyçur në rrjet dhe të operojë brenda kufijve të tensionit të rrjetit në pikën e kyçjes, e shprehur me tensionin e pikës së kyçjes në relacion me tensionin referent 1 pu dhe për periudhat kohore të specifikuar në tabelat 4 dhe 5;
- b) **OST** mund të specifikojë periudha më të shkurtra kohore gjatë të cilave **modulet gjeneruese** janë të afta të qëndrojnë të kyçura në rrjet në rast të mbi-tensionit dhe nën-frekuencës së njëkohshme apo nën-tensionit dhe mbi-frekuencës së njëkohshme;

Tabela 4. Periudhat kohore minimale brenda të cilave çdo modul gjenerues duhet të operojë për tensionin që devijon nga vlera nominale në pikën e kyçjes pa shkyçje nga rrjeti për nivel të tensionit 220 kV dhe 110 kV

Kufiri i tensionit	Periudha kohore për operim
0.85 pu – 0.90 pu	60 minuta
0.90 pu – 1.118 pu	Pakufizuar
1.118 pu – 1.15 pu	20 minuta

Tabela 5. Periudhat minimale kohore brenda të cilave çdo modul gjenerues duhet të operojë për tensionet që devijojnë nga vlera nominale në pikën e kyçjes pa u shkyçur nga rrjeti për nivelin e tensionit prej 400 kV

Kufiri i tensionit	Periudha kohore për operim
0.85 pu – 0.90 pu	60 minuta
0.90 pu – 1.05 pu	Pakufizuar
1.05 pu – 1.10 pu	20 minuta

8.1.6.2 Fuqia e gjeneruar duhet të ketë tensione fazore të balancuara me ç'rregullim harmonik jo më të lartë se 2%.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 31 nga 82</i>

8.1.6.3 Secili **modul gjenerues** dhe central gjenerues në të cilin gjendet ai duhet të jetë i aftë për operim të vazhdueshëm të pandërprerë gjatë kohës kur ndodhin këta faktorë:

- a) Ngarkesa e pa balancuar deri në 10%;
- b) Rryma e sekuencës negative të fazës deri në 5%.

8.1.6.4 Të gjitha **modulet gjeneruese** sinkrone të kyçura në nivelet 400 kV, 220 KV apo 110 kV (nëpërmjet transformatorit ngritës) në lidhje me aftësinë e kalimit nëpër prishje do ti përmbushin kërkesat në vijim:

- a) **Moduli gjenerues** është i aftë të qëndrojë i kyçur në rrjet dhe të vazhdojë operimin në mënyrë stabile pasi sistemi elektrik është ç'rregulluar nga prishjet e izoluara. Kjo aftësi duhet të jetë në përputhje me profilin tension – kohë në pikën e kyçjes për kushtet e prishjes të specifikuara nga **OST**.
- b) Ky profil tension-kohë shprehet me kufi të poshtëm të orientimit (kursit) të njërit nga tre tensionet fazë - fazë në nivelin e tensionit të rrjetit në pikën e kyçjes i cili përmban tensionin e mbetur më të ulët gjatë një prishje simetrike apo asimetrike, pavarësisht nga rënia e tensionit të dy tensioneve tjera fazë-fazë, në funksion të kohës para, gjatë dhe pas prishjes. Ky kufi i poshtëm i ilustruar me vijë të kuqe është treguar në figurën 6 për modulet asinkrone gjeneruese dhe me vijë të gjelbër në figurën 7 për modulet e parkut gjenerues.
- c) **OST** specifikon dhe publikon kushtet para prishjes dhe pas prishjes për aftësinë e kalimit nëpër prishje në aspekt të:
 - llogaritjes së kapacitetit minimal të lidhjes së shkurtër para-prishjes në pikën kyçëse;
 - pika e punës e fuqisë aktive dhe reaktive të modulit gjenerues në pikën e kyçjes dhe tensionit në pikën kyçëse; dhe
 - llogaritjes së kapacitetit minimal të lidhjes së shkurtër pas prishjes në pikën kyçëse.
- d) Me kërkesën e centralit gjenerues, **OST** apo **OSSH** (sipas rastit) ofron konditat para prishjes dhe pas prishjes që duhet të merren parasysh për aftësinë e kalimit nëpër prishje si rezultat i llogaritjeve në pikën kyçëse siç specifikohet në pikën h) lidhur me:
 - kapacitetin minimal të lidhjes së shkurtër para prishjes në çdo pikë kyçëse të shprehur në MVA;
 - pika e punës para prishjes të modulit gjenerues të shprehur në fuqinë dalëse aktive dhe fuqinë dalëse reaktive në pikën kyçëse dhe tensionin në pikën kyçëse; dhe
 - kapaciteti minimal i lidhjes së shkurtër pas prishjes në çdo pikë kyçëse të shprehur në MVA




Figura 6: Profili i kalimit nëpër prishje i modulit gjenerues sinkron në rrjetin e transmetimit.

Diagrami paraqet limitin e profilit tension-kohë të tensionit në pikën kyçëse, e shprehur si raport i vlerës së tij aktuale dhe vlerës referente 1 pu para, gjatë dhe pas prishjes. U_{mbet} është tensioni i mbetur në pikën kyçëse gjatë prishjes, t_{elim} është momenti kur prishja eliminohet. U_{riv1} , U_{riv2} , t_{riv1} , t_{riv2} dhe t_{riv3} janë pikat e caktuara të kufijve më të ulët të tensionit dhe kohët përkatëse pas eliminimit të prishjes.




Figura 7: Profili i kalimit nëpër prishje i modulit të parkut gjenerues i kyçur në rrjetin e transmetimit

8.1.7 Humbja e mbrojtjes së sinkronizimit

Centralet e gjenerimit janë përgjegjëse për mbrojtjen e moduleve të tyre gjeneruese nga operimi jo-sinkron nëse **modulet gjeneruese** shkyçen nga **sistemi i transmetimit**.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 33 nga 82</i>

8.1.8 Impianti që është subjekt i dispeçimit qëndror

Të gjitha **modulet gjeneruese** për dispeçim qëndror duhet të pajisen me LFC (pajisje për rregullim sekondar). Specifikimi për këto do të jetë i njëjtë siç është përcaktuar nga **OST**.

8.1.9 Startimi nga errësira, operimi në ishull dhe ri-sinkronizimi

8.1.9.1 Nëse kërkohet, në MK për çdo **modul gjenerues** do të ceket aftësia e startimit nga errësira. Të gjitha **modulet gjeneruese** me aftësi të startimit nga errësira do të vihen në dispozicion sipas kushteve të një marrëveshjeje të shërbimeve ndihmëse dhe do të plotësojnë kërkesat operative të përcaktuara në kodin e planifikimit të rasteve të paparashikuara.

8.1.9.2 **Moduli gjenerues** do ti përmbushë kërkesat në vijim në lidhje me aftësinë e startimit nga errësira:

- a) **pronarët e centralit gjenerues**, me kërkesën e **OST**, do të sigurojnë përcaktimin e kuotës për aftësinë e startimit nga errësira. **OST** mund të bëjë një kërkesë të tillë nëse konsideron se siguria e sistemit është në rrezik për shkak të mungesës së aftësisë së startimit nga errësira në zonën e tij rregulluese;
- b) **moduli gjenerues** me aftësi të startimit nga errësira është i aftë të startojë pa furnizim të jashtëm të energjisë elektrike brenda afatit kohor të specifikuar nga **OST** sipas kushteve të marrëveshjes për shërbime ndihmëse;
- c) **moduli gjenerues** me aftësi të startimit nga errësira është në gjendje të sinkronizohet brenda kufijve të frekuencës të përcaktuar në tabelën 1 (paragrafi 8.1.1) dhe aty ku është e aplikueshme, kufijtë e tensionit të specifikuar nga **OST** apo në tabelat 4 dhe 5 të paragrafit 8.1.6.1;
- d) **moduli gjenerues** me aftësi të startimit nga errësira është në gjendje të rregullojë në mënyrë automatike rëniet e tensionit të shkaktuara nga kyçja e ngarkesës;
- e) **moduli gjenerues** me aftësi të startimit nga errësira:
 - është në gjendje të rregullojë kyçjet e ngarkesës në bllok ,
 - është në gjendje të operojë në **MSFK-M** dhe **MSFK-N**, siç specifikohet në paragrafët 8.1.3.1 dhe 8.1.3.8,
 - rregullimi i frekuencës në rast të mbi-frekuencës dhe nën-frekuencës brenda gjithë brezit të fuqisë aktive dalëse ndërmjet nivelit minimal rregullues dhe kapacitetit maksimal, si dhe në nivel të ngarkesës vetanake,
 - është në gjendje të bëjë operim paralel të disa moduleve gjeneruese brenda një ishulli, dhe
 - rregullon tensionin në mënyrë automatike gjatë fazës së restaurimit të sistemit;

8.1.9.3 **Moduli gjenerues** do të përmbushë kërkesat në vijim lidhur me aftësinë për operim në ishull;

- a) **moduli gjenerues** është i aftë të marrë pjesë në operimin në ishull nëse kërkohet nga **OST** dhe:
 - kufijtë e frekuencës për operimin në ishull janë ata të përcaktuar në përputhje me paragrafin 8.1.1 (tabela 1),

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 34 nga 82</i>

- kufijtë e tensionit për operim në ishull janë ata të përcaktuar në përputhje me paragrafin 8.1.6.1 (tabela 4 dhe 5), ku është e aplikueshme;
- b) moduli gjenerues është i aftë të operoj në **MSF** gjatë operimit në ishull, siç specifikohet në paragrafin 8.1.4.8. Në rast të tepricave të fuqisë, modulet gjeneruese janë në gjendje të reduktojnë fuqinë dalëse aktive nga pika paraprake operuese në ndonjë pikë të re operuese brenda diagramit të aftësisë P-Q. Në këtë drejtim, moduli gjenerues është në gjendje të reduktojë fuqinë aktive për aq sa është teknikisht e mundur, por së paku 55% të kapacitetit të tij maksimal;
- c) metoda për identifikimin e ndryshimit nga operimi i sistemit të ndërlidhur në operimin në ishull do të dakordohet ndërmjet pronarit të centralit gjenerues dhe **OST**. Metoda e dakorduar e identifikimit nuk duhet të mbështetet vetëm në sinjalet e pozicionit të stabilimenteve shkycesetë sistemit;
- d) moduli gjenerues është në gjendje të operojë në **MSFK-M** dhe **MSFK-N** gjatë operimit në ishull, siç specifikohet në paragrafët 8.1.3.1 dhe 8.1.3.8

8.1.9.4 **Moduli gjenerues** do të përmbushë kërkesat në vijim lidhur me aftësinë për ri-sinkronizim të shpejtë:

- a) në rast të shkyçjes së modulit gjenerues nga rrjeti, moduli gjenerues është në gjendje të bëjë ri-sinkronizim të shpejtë në harmoni me strategjinë e mbrojtjes të dakorduar ndërmjet **OST** dhe **centralit gjenerues**;
- b) moduli gjenerues me kohë minimale të ri-sinkronizimit më të madhe se 15 minuta pas shkyçjes nga furnizimi i jashtëm me energji elektrike duhet të dizajnohet në atë mënyrë që të kalojë në ngarkesën vetanake nga çfarëdo pike operuese në diagramin e tij të aftësisë P-Q. Në këtë rast, identifikimi i operimit me ngarkesë vetanake nuk duhet të bazohet vetëm në sinjalet e pozicionit të ndërprerësit të operatorit;
- c) moduli gjenerues duhet të jetë i aftë të vazhdojë operimin edhe pas kalimit në ngarkesës vetanake, pavarësisht nga kyçja ndihmëse në rrjetin e jashtëm. Koha minimale e operimit specifikohet nga **OST**, duke marrë parasysh karakteristikat specifike të teknologjisë së turbinës.

8.2 Kërkesat për modulet gjeneruese sinkrone

8.2.1 Rregullimi i fuqisë reaktive

8.2.1.1 Sa i përket aftësisë për fuqi reaktive, **OST** mund të specifikojë fuqinë reaktive shtese që duhet të jepet nëse pika kyçëse e modulit gjenerues sinkron edhe nëse nuk gjendet në bornat e tensionit të lartë të transformatorit ngritës në nivelin e tensionit të pikës kyçëse, e as në bornat e statorit, nëse nuk ekziston asnjë transformator ngritës. Kjo fuqi reaktive shtese duhet ta kompenson kërkesën për fuqi reaktive të linjës apo kabllos së tensionit të lartë ndërmjet bornave të tensionit të lartë të transformatorit ngritës të modulit gjenerues sinkron apo bornat të statorit të tij, nëse nuk ekziston asnjë transformator ngritës dhe pikës së kyçjes do të ofrohet nga pronari përgjegjës i asaj linje apo kabllloje.

8.2.1.2 Profili $U-Q/P_{max}$ brenda kufirit të cilit moduli gjenerues sinkron është i aftë të ofrojë fuqi reaktive në kapacitetin e tij maksimal siç është paraqitur në figurën 8.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 35 nga 82</i>

8.2.1.3 Moduli gjenerues sinkron është i aftë të lëvizë në cilëndo pikë operuese brenda profilit të tij $U-Q/P_{max}$ në afate kohore të duhura për të arritur vlerat e kërkuara nga **OST** në kufirin ndërmjet 10 sekondave dhe 1 minute.

8.2.1.4 Sa i përket aftësisë për fuqinë reaktive nën kapacitetin maksimal, kur operojnë me fuqi dalëse aktive nën kapacitetin maksimal ($P < P_{maks}$), modulet sinkrone gjeneruese do të jenë të afta të operojnë në çdo pikë të mundshme të operimit në diagramin e punës P-Q të statorit të atij moduli gjenerues sinkron, së paku deri te niveli minimal i operimit të qëndrueshëm. Edhe me fuqi të reduktuar dalëse aktive furnizimi me fuqi reaktive në pikën kyçëse do të korrespondon plotësisht me diagramin e punës P-Q të statorit të atij moduli gjenerues sinkron, duke pasur parasysh furnizimin me shërbime ndihmëse dhe humbjet e fuqisë aktive dhe reaktive të transformatorit ngritës, nëse është e aplikueshme.





Figura 8: Profili $U-Q/P_{maks}$ i modulit gjenerues sinkron . Diagrami paraqet kufijtë e profilit $U-Q/P_{max}$ sipas tensionit në pikën kyçëse, shprehur me raportin e vlerës së tij aktuale dhe vlerës së tij referente 1 pu kundrejt raportit të fuqisë reaktive (Q) dhe kapacitetit maksimal (P_{maks}).

8.2.2 Sistemet e eksцитimit

8.2.2.1 Çdo **modul gjenerues** duhet të jetë i aftë të kontribuojë në rregullimin e tensionit nëpërmjet modulimit të vazhdueshëm të **fuqisë reaktive** të furnizuar në **sistemin e transmetimit**.

8.2.2.2 Të gjitha **modulet gjeneruese** të kyçura në rrjetin e transmetimit duhet të pajisen me **rregullator automatik të tensionit (RAT)** që operon vazhdimisht që mund të përfshijë stabilizuesit, për të ofruar tension konstant në bornat e **modulit gjenerues**, pa krijuar jo stabilitet gjatë gjithë brezit operues të modulit gjenerues. Nëse kërkohet sipas MK, do të inkorporohet **SOF (stabilizuesi i oscilimeve të fuqisë)** për të zvogëluar oscilimet e fuqisë. **Rregullatori automatik i tensionit (RAT)** duhet të kompensojë për ndonjë rënie të tensionit në transformatorin ngritës të modulit gjenerues dhe gjithashtu të ofrojë shpërndarje stabile të fuqisë reaktive ndërmjet modulit gjenerues sinkron dhe rrjetit.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 36 nga 82</i>

8.2.2.3 **Rregullatori Automatik i Tensionit** duhet të jetë i aftë të mirëmbajë tensionin në bornat e modulit gjenerues me një saktësi si në vijim:

- a) për **modulet gjeneruese** deri në 25 MVA – jo më pak se $\pm 1\%$ të tensionit nominal;
- b) për **modulet gjeneruese** mbi 25 MVA – jo më pak se $\pm 0.5\%$ të tensionit nominal;

8.2.2.4 Sistemi i ekscitimit duhet të sigurojë rritje të rrymës ekscituese dhe tensionit të **modulit gjenerues** sinkron në ngarkesën nominale sipas faktorit/hersit të paraqitur si më poshtë;

- a) hidro modulet gjeneruese deri në 25 MVA – faktori (raporti) minimal 1.5 – koha minimale 10 s;
- b) hidro modulet gjeneruese mbi 25 MVA – faktori minimal 1.8 – koha minimale 10 s;
- c) termo njësitë gjeneruese deri 25 MVA – faktori minimal 1.8 – koha minimale 10 s;
- d) termo modulet gjeneruese mbi 25 MVA – faktori minimal 2.0 – koha minimale 10 s.

8.2.2.5 Parametrat detyrues (rregullues) duhet të arrihen në tensionin e bornave të modulit gjenerues brenda kufijve prej 90% deri në 110% të tensionit nominal dhe në kufijtë e frekuencës prej 47.5 Hz deri në 51.5 Hz.

8.2.2.6 Shpejtësia e ndryshimit të tensionit të modulit gjenerues sinkron nuk do të jetë më e ulët se 2 njësi relative/sek duke përdorur si referencë tensionin ekscitues në ngarkesën nominale të modulit gjenerues sinkron.

8.2.2.7 **RAT** duhet të sigurojnë kufizimin si në vijim:

- a) kufizimi i brezit të sinjalit dalës për të siguruar që frekuenca më e lartë e reagimit nuk mund të ekscitojë oscilimet torsionale në modulet tjera gjeneruese të kyçura në rrjet;
- b) limituesi i nën eksitimit për të parandaluar **RAT** në reduktimin e ekscitimit të statorit në një nivel që do të mund të rrezikonte stabilitetin sinkron;
- c) limituesi i mbi eksitimit për të siguruar që ekscitimi i statorit nuk është i kufizuar në më pak se vlera maksimale që mund të arrihet përderisa sigurohet që moduli gjenerues sinkron është duke operuar brenda kufijve të tij të dizajnit;
- d) limituesi i rrymës së statorit; dhe
- e) funksioni i PSS për të zvogëluar oscilimet e fuqisë, nëse madhësia e modulit gjenerues sinkron është mbi vlerën e kapacitetit maksimal të specifikuar nga **OST**.

8.2.2.8 Sistemet e ekscitimit të **moduleve gjeneruese** të përfshirë në restaurimin e rrjetit të transmetimit pas incidenteve të rënda në system, do të jenë në gjendje të rregullojnë ekscitimin e **modulit gjenerues** në mungesë të një furnizimi të jashtëm alternativ (AC).

8.2.2.9 **OST** dhe **pronari i centralit gjenerues** do të bëjnë një marrëveshje lidhur me aftësitë teknike të modulit gjenerues për të ndihmuar stabilitetin tranzient gjatë prishjeve.

8.3 Kërkesat për modulet e parkut gjenerues

8.3.1 **Modulet e parkut gjenerues** me kapacitet prej ≥ 5 MW duhet të përmbushin kërkesat e radhitura në paragrafin 8.1.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 37 nga 82</i>

8.3.1.1 Për **modulet e parkut gjenerues** me kapacitet ≥ 5 MW, **OST** apo **OSSH** (sipas rastit) në koordinim me **OST** kanë të drejtë të specifikojnë që një modul i parkut gjenerues është në gjendje të ofrojë rryma të shpejta në rast të prishjeve simetrike (3-fazore) në pikën e kyçjes, sipas kushteve në vijim:

- a) Moduli i parkut është në gjendje të aktivizojë injektimin me rrymë të shpejtë të prishjes qoftë duke:
 - siguruar furnizim në pikën e kyçjes me rrymë të shpejtë të prishjes, apo
 - matur devijimet e tensionit në bornat e njësive individuale të **modulit të parkut gjenerues** dhe duke ofruar një rrymë të shpejtë të prishjes në bornat e këtyre njësive;
- b) **OST**, apo **OSSH** (sipas rastit) në koordinim me **OST** specifikojnë:
 - si dhe kur duhet të përcaktohet devijimi i tensionit, gjithashtu edhe përfundimi i devijimit të tensionit.
 - karakteristikat e rrymës së shpejtë të prishjes, duke përfshirë domenin kohor për matjen e devijimit të tensionit dhe rrymës së shpejtë të prishjeve
 - koha dhe saktësia e rrymës së shpejtë të prishjes, e cila mund të përfshijë disa faza gjatë prishjes dhe pas eliminimit të saj;

8.3.1.2 Sa i përket furnizimit me rrymë të shpejtë të prishjes për rastin e prishjeve asimetrike (1-fazore apo 2-fazore), **OST** apo **OSSH** (sipas rastit) në koordinim me **OST** kanë të drejtë të specifikojnë kërkesën për injektim të rrymës asimetrike.

8.3.1.3 **Modulet e parkut gjenerues** me kapacitet ≥ 5 MW do të përmbushin kërkesat shtesë në vijim në relacion me qëndrueshmërinë:

- a) **OST** do të specifikon rimëkëmbjen e fuqisë aktive pas prishjes që **moduli i parkut gjenerues** është në gjendje ta ofrojë dhe do të specifikojë:
 - kur fillon rimëkëmbja e fuqisë aktive pas prishjes, në bazë të kriterit të tensionit;
 - kohën maksimale të lejuar për rimëkëmbjen e fuqisë aktive; dhe
 - madhësinë dhe saktësinë për rimëkëmbjen e fuqisë aktive;
- b) specifikimet do të jenë në përputhje me parimet në vijim:
 - ndërvarësia në mes kërkesave për rrymë të shpejtë të prishjes sipas paragrafit 8.3.1.1 dhe paragrafit 8.3.1.2 dhe rimëkëmbjes së fuqisë aktive;
 - varësia ndërmjet kohës së rimëkëmbjes të fuqisë aktive dhe kohëzgjatjes së devijimeve të tensionit;
 - limiti i specifikuar i kohës maksimale të lejuar për rimëkëmbjen e fuqisë aktive;
 - (mjaftueshmëria mes nivelit të rimëkëmbjes të tensionit dhe madhësisë minimale për rimëkëmbjen e fuqisë aktive; dhe
 - Amortizimi adekuat i oscilimeve të fuqisë aktive.

8.3.1.4 **Modulet e parkut gjenerues** me kapacitet ≥ 5 MW do të përmbushin kërkesat shtesë në vijim në relacion me stabilitetin e frekuencës:

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 38 nga 82</i>

- a) **OST** ka të drejtë të specifikojë që **modulet e parkut gjenerues** të jenë në gjendje të ofrojnë inercion artificial gjatë devijimeve shumë të shpejta të frekuencës;
- b) principet operuese të sistemeve kontrolluese të instaluar që të ofrojnë inercionin artificial dhe performancën e parametrave do të specifikohen nga **OST**.

8.3.1.5 **Modulet e parkut gjenerues** me kapacitet $\geq 5\text{MW}$ do të përmbushin kërkesat shtesë në vijim në relacion me stabilitetin e tensionit:

- a) sa i përket aftësisë për fuqi reaktive, **OST** apo **OSSH** (sipas rastit) mund të specifikojnë fuqinë reaktive shtesë që duhet të ofrohet nëse pika kyçese e një **modulit të parkut gjenerues** nuk gjendet në bornat e tensionit të lartë të transformatorit ngritës deri në nivelin e tensionit të pikës kyçese e as në bornat e konvertorit, nëse nuk ekziston asnjë transformator ngritës. Kjo fuqi reaktive shtesë duhet ta kompenson kërkesën për fuqi reaktive të linjës apo kabllot të tensionit të lartë ndërmjet bornave të tensionit të lartë të transformatorit ngritës të **modulit të parkut gjenerues** apo bornat e konvertorit të tij, nëse nuk ekziston asnjë transformator ngritës dhe pikës së kyçjes do të ofrohet nga pronari përgjegjës i asaj linje apo kabllot.
- b) sa i përket aftësisë për fuqi reaktive në kapacitetin maksimal:
 - **OST** apo **OSSH** (sipas rastit) në koordinim me **OST** do të specifikojë kërkesat për aftësinë e ofrimit të fuqisë reaktive në kontekst të ndryshimit të tensionit. Për këtë qëllim, do të specifikojë profilin e $U-Q/P_{\text{maks}}$ që mund të marrë ndonjë formë brenda kufijve të të cilit moduli i parkut të fuqisë është në gjendje të ofrojë fuqi reaktive në kapacitetin e tij maksimal;
- c) sa i përket aftësisë për fuqi aktive, **OST** apo **OSSH** (sipas rastit) në koordinim me **OST** ka të drejtë të specifikojë aftësinë e modulit të parkut gjenerues me kapacitet $\geq 5\text{MW}$ që të ofrojë fuqinë reaktive. Profili $U-Q/P_{\text{maks}}$ brenda kufirit të të cilit **modulet e parkut gjenerues** janë në gjendje të ofrojnë fuqi reaktive në kapacitetin e tij maksimal siç është paraqitur në figurën 9:




Figura 9: Profili $U-Q/P_{\text{maks}}$ i modulit të parkut gjenerues me kapacitet $\geq 5\text{MW}$. Diagrami paraqet kufijtë e Profilit $U-Q/P_{\text{maks}}$ sipas tensionit në pikën kyçese, shprehur me raportin e vlerës së tij

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 39 nga 82</i>

aktuale ndaj vlerës referente 1 pu, kundrejt raportit të fuqisë reaktive (Q) ndaj kapacitetit maksimal (P_{max}).

- Kërkesa për aftësinë e ofrimit të fuqisë reaktive aplikohet në pikën e kyçjes.

d) Sa i përket aftësisë për fuqi reaktive nën kapacitetin maksimal:

- Sa i përket aftësisë për fuqi reaktive nën kapacitetin maksimal ($P < P_{maks}$), Profili $P-Q/P_{max}$ në pikën kyçëse, brenda kufirit të së cilit modulet e parkut gjenerues duhet të jenë në gjendje të ofrojnë fuqi reaktive në raportin P/P_{max} prej 0.1 pu.
- Nën raportin P/P_{max} prej 0.1 pu nuk kërkohet aftësia për ofrimin e fuqisë reaktive, kur operohet me fuqi dalëse aktive nën kapacitetin maksimal ($P < P_{maks}$), moduli i parkut të fuqisë duhet të jetë në gjendje të ofrojë fuqi reaktive në çfarëdo pike operuese brenda Profilit $P-Q/P_{max}$ të ilustruar në figurën 10, nëse të gjitha njësitë e atij modulit të parkut gjenerues janë teknikisht në dispozicion, që do të thotë se nuk janë jashtë shërbimit për shkak të mirëmbajtjes apo prishjes, përndryshe aftësia për ofrimin e fuqisë reaktive do të jetë më e vogël, duke marrë parasysh disponueshmëritë teknike;
- moduli i parkut gjenerues duhet të jetë në gjendje të lëvizë në çfarëdo pike operuese brenda profilit të tij $P-Q/P_{max}$ në afate të duhura kohore për të synuar vlerat e kërkuara nga OST apo OSSH (sipas rastit) në një brez prej 10 sekondave deri në 1 minutë.




Figura 10: Profili $P-Q/P_{max}$ i modulit të parkut gjenerues me kapacitet $\geq 5MW$. Diagrami paraqet kufijtë e Profilit $P-Q/P_{max}$ në pikën kyçëse nga fuqia aktive, shprehur me raportin e vlerës së tij aktuale dhe kapacitetin maksimal pu, kundrejt raportit të fuqisë reaktive (Q) dhe kapacitetit maksimal (P_{max})

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 40 nga 82</i>

e) sa i përket moduseve të rregullimit të fuqisë reaktive:

- **moduli i parkut gjenerues** duhet të jetë në gjendje të ofrojë fuqi reaktive automatikisht qoftë në modusin në rregullim të fuqisë reaktive apo modusin në rregullim të faktorit të fuqisë;
- për qëllime të modusit të operimit për rregullim të tensionit, **moduli i parkut gjenerues** duhet të jetë në gjendje të kontribuojë në rregullimin e tensionit në pikën kyçëse duke ofruar shkëmbim të fuqisë reaktive me rrjetin me pikë të caktuar të tensionit që mbulon prej 0.95 deri në 1.05 pu në shkallë jo më të madhe se 0.01 pu, me pjerrtësi nga më së paku prej 2 deri në 7% me shkallë jo më të madhe se 0.5%. Fuqia dalëse reaktive është zero kur vlera e tensionit të rrjetit në pikën kyçëse është e barabartë me pikën e vendosur të tensionit;
- pika e vendosur mund të operohet me ose pa selektimin e zonës së vdekur në një brez nga zero deri në +5% e tensionit referent të rrjetit prej 1 pu me shkallë jo më të madhe se 0.5%;
- pas ndryshimit shkallë të tensionit, **moduli i parkut gjenerues** duhet të jetë në gjendje të arrijë ndryshim prej 90% të fuqisë reaktive dalëse brenda kohës t_1 e cila specifikohet nga operatori i sistemit të transmetimit në brezin prej 1 deri në 5 sekonda dhe duhet të qëndrojë në vlerën e specifikuar nga pjerrtësia brenda kohës t_2 që duhet të specifikohet nga **OST** apo **OSSH** (sipas rastit) në kufirin prej 5 deri në 60 sekonda, me tolerancë të fuqisë reaktive gjatë gjendjes së qëndrueshme jo më të madhe se 5% të fuqisë maksimale reaktive. **OST** apo **OSSH** (sipas rastit) përcaktojnë specifikimet kohore;
- për qëllime të modusit të operimit për rregullim të fuqisë reaktive, **moduli i parkut gjenerues** duhet të jetë i aftë për vendosjen e pikës së punës për fuqinë reaktive kudo në brezin e fuqisë reaktive, të specifikuar nga pikat (a) dhe (b) të paragrafit 8.3.1.5 duke caktuar shkallë jo më të madhe se 5MVAR apo 5% (cilado që është më e vogël) të fuqisë së plotë reaktive, duke kontrolluar fuqinë reaktive në pikën e kyçjes në një saktësi brenda plus apo minus 5MVAR apo plus apo minus 5% (cilado që është më e vogël) të fuqisë së plotë reaktive;
- për qëllim të modusit të operimit për rregullim të faktorit të fuqisë, **moduli i parkut gjenerues** është në gjendje të rregullojë faktorin e fuqisë në pikën kyçëse brenda brezit të kërkuar të fuqisë reaktive, të specifikuar nga **OST** apo **OSSH** (sipas rastit) sipas pikave (a) dhe (b) të paragrafit 8.3.1.5, me faktorin e synuar të fuqisë me shkallë jo më të madhe se 0.01. **OST** apo **OSSH** (sipas rastit) specifikojnë vlerën e faktorit të synuar të fuqisë, tolerancën e tij dhe periudhën kohore për arritjen e faktorit të synuar të fuqisë pas një ndryshimi të papritur të fuqisë aktive dalëse. Toleranca e faktorit të fuqisë së synuar shprehet nëpërmjet tolerancës së fuqisë së tij korresponduese reaktive. Kjo tolerancë e fuqisë reaktive shprehet me vlerë absolute apo me përqindje të fuqisë maksimale reaktive të modulit të parkut gjenerues;
- **OST** ose **OSSH** (sipas rastit) në koordinim me **OST** dhe me **pronarin e modulit të parkut gjenerues**, duhet të specifikojë se cili nga opsionet e mësipërme të tri moduseve të operimit për rregullimin e fuqisë reaktive dhe pikat e vendosura përkatëse të punës do të aplikohen dhe çfarë pajisje të tjera nevojiten për të bërë përshtatjen e pikës relevante përkatëse të operueshme nga distanca;

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 41 nga 82</i>

- f) në lidhje me përparësinë e kontributit të fuqisë aktive ose reaktive, **OST** duhet të specifikojë nëse kontributi i fuqisë aktive ose kontributi i fuqisë reaktive ka përparësi gjatë prishjeve për të cilat kërkohet aftësia e kalimit nëpër prishje. Nëse përparësi i jepet kontributit të fuqisë aktive, ky kusht duhet të vendoset jo më vonë se 150 ms nga fillimi i prishjes;
- g) në lidhje me kontrollin e amortizimit e oscilimeve të fuqisë, nëse përcaktohet nga **OST**, **moduli i parkut gjenerues** duhet të jetë në gjendje të kontribuojë në amortizimin e oscilimeve të fuqisë. Karakteristikat e rregullimit të tensionit dhe fuqisë reaktive të **modulit të parkut gjenerues** nuk duhet të ndikojnë negativisht në amortizimin e oscilimeve të fuqisë.

8.4 Procedura e njoftimit për operimin e kyçjes së centraleve të gjenerimit në rrjetin e transmetimit

8.4.1 Dispozitat e përgjithshme

8.4.1.1 **Pronari i centralit të gjenerimit** të kyçur në rrjetin e transmetimit duhet t'i dëshmojë **OST**-së se ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në këtë Kod, duke kryer me sukses procedurën e njoftimit për operim të kyçjes të secilit **modul të gjenerimit** të përshkruar në paragrafët 8.4.2 deri 8.4.6.

8.4.1.2 **OST** do të sqarojë dhe do t'i bëjë publike detajet e procedurës së njoftimit për operim.

8.4.2 Procedura për modulet e gjenerimit të kyçura në rrjetin e transmetimit

8.4.2.1 Procedura e njoftimit për operim të kyçjes të secilit modul të ri të gjenerimit në rrjetin e transmetimit duhet të përbëhet nga:

- a) **njoftimi për operim gjatë energjizimit ('NOE');**
- b) **njoftimi për operim të përkohshëm ('NOP');** dhe
- c) **njoftimi për operim final ('NOF').**

8.4.3 Njoftimi për operim gjatë energjizimit

8.4.3.1 Një **NOE** i jep të drejtë **pronarit të centralit të gjenerimit** që të energjizojë rrjetin e tij të brendshëm dhe rrjetin për shpenzime vetanake për modulet e gjenerimit duke përdorur kyçjen në rrjet që është specifikuar për pikën e kyçjes.

8.4.3.2 Një **NOE** do të lëshohet nga **OST**, në varësi të përfundimit të përgatitjeve, duke përfshirë marrëveshjen për tarimin e mbrojtjeve dhe kontrollit që kanë të bëjnë me pikën e kyçjes ndërmjet **OST**-së dhe **pronarit të centralit të gjenerimit**.

8.4.4 Njoftimi për operim të përkohshëm

8.4.4.1 Një **NOP** i jep të drejtë pronarit të centralit të gjenerimit të operojë modulën e gjenerimit dhe të gjenerojë fuqi duke përdorur kyçjen në rrjet për një periudhë të kufizuar kohore.

8.4.4.2 Një **NOP** lëshohet nga **OST**, pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të të dhënave dhe studimit, siç kërkohet nga paragrafi 8.4.4.3

8.4.4.3 Sa i përket shqyrtimit të të dhënave dhe studimit, **OST** do të ketë të drejtë të kërkojë që **pronari i centralit të gjenerimit** të sigurojë:

- a) deklaraten e detajuar të pajtueshmërisë;

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 42 nga 82</i>

- b) të dhëna të hollësishtme teknike mbi modulën e gjenerimit që është me rëndësi për kyçjen në rrjet siç specifikohet nga **OST**;
- c) certifikatat e pajisjeve të lëshuara nga një certifikues i autorizuar në lidhje me modulet e gjenerimit, ku ato mbështeten si pjesë e provave të pajtueshmërisë;
- d) modelet e simulimit, siç përcaktohet në paragrafin 8.1.5 dhe kërkohet nga **OST**;
- e) studimet që dëshmojnë performancën e pritshme të gjendjes stacionare dhe asaj dinamike siç kërkohet nga paragrafi 8.5.7 dhe 8.5.8;
- f) detajet e testeve të synuara të pajtueshmërisë në përputhje me paragrafin 8.5.5 dhe 8.5.6.

8.4.4.4 Periudha maksimale gjatë së cilës **pronari i centralit të gjenerimit** mund të mbajë statusin e **NOP** do të jetë 24 muaj. **OST** ka të drejtë të specifikojë një periudhë më të shkurtër të vlefshmërisë së **NOP**. Një zgjatje e vlefshmërisë së **NOP** jepet vetëm nëse **pronari i centralit të gjenerimit** ka shënuar progres thelbësor drejt pajtueshmërisë së plotë. Çështjet e pazgjidhura duhet të identifikohen qartë në kohën e kërkesës për zgjatje të periudhës.

8.4.4.5 Një zgjatje e periudhës gjatë së cilës **pronari i centralit të gjenerimit** mund të mbajë statusin e **NOP**, përtej periudhës së përcaktuar në paragrafin 8.4.4.4, mund të jepet vetëm nëse bëhet një kërkesë për derogim tek **OST** para skadimit të asaj periudhe, në përputhje me procedurën e derogimit të përcaktuar në kapitullin 10 të këtij Kodi.

8.4.5 Njoftimi për operim final

8.4.5.1 Një **NOF** i jep të drejtë **pronarit të centralit të gjenerimit** të operojë një modul të gjenerimit duke përdorur kyçjen në rrjet.

8.4.5.2 Një **NOF** lëshohet nga **OST** pas eliminimit paraprak të të gjitha mos pajtueshmërive të identikuara gjatë statusit **NOP** dhe në varësi të përfundimit të procesit të shqyrtimit të të dhënave dhe studimit, siç kërkohet nga paragrafi 8.4.5.3

8.4.5.3 Për qëllime të shqyrtimit të të dhënave dhe studimit, **pronari i centralit të gjenerimit** duhet të dorëzojë tek **OST**:

- a) një deklaratë të detajuar të pajtueshmërisë; dhe
- b) një përditësim të të dhënave teknike të zbatueshme, modeleve të simulimit dhe studimeve të përmendura në pikat (b), (d) dhe (e) të paragrafit 8.4.4.3, duke përfshirë përdorimin e vlerave aktuale të matura gjatë testimit.

8.4.5.4 Nëse identifikohet mospajtueshmëria në lidhje me lëshimin e **NOF**, mund të jepet një derogim me kërkesë të bërë tek **OST**, në përputhje me procedurën e derogimit të përshkruar në kapitullin 10 të këtij Kodi. Një **NOF** lëshohet nga **OST** nëse moduli i gjenerimit përputhet me dispozitat e derogimit.

8.4.5.5 Kur refuzohet një kërkesë për derogim, **OST**-ja ka të drejtë të refuzojë lejin e operimit të modulit të gjenerimit derisa **pronari i centralit të gjenerimit** dhe **OST** të zgjidhin mos pajtueshmërinë dhe **OST** të konsiderojë se moduli i gjenerimit përputhet me dispozitat e këtij Kodi.

8.4.5.6 Nëse **OST**-ja dhe **pronari i centralit të gjenerimit** nuk e zgjidhin mos pajtueshmërinë brenda një periudhe të arsyeshme kohore, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas njoftimit të refuzimit të kërkesës për derogim, secila palë mund ta adresojë çështjen për vendim tek autoriteti rregullativ.

8.4.6 Njoftimi për operim të kufizuar

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 43 nga 82</i>

8.4.6.1 **Pronari i centralit të gjenerimit**, të cilit i është dhënë një **NOF**, duhet menjëherë të informojë **OST** për rrethanat e mëposhtme:

- a) centrali është përkohësisht subjekt i modifikimeve të konsiderueshme ose humbjes së aftësisë që ndikon në performancën e tij; ose
- b) dështimi i pajisjeve që çon në mos pajtueshmëri me disa kërkesa relevante.

8.4.6.2 **Pronari i centralit të gjenerimit** do të aplikoj në **OST** për një **NOK**, nëse **pronari i centralit të gjenerimit** pret në mënyrë të arsyeshme që rrethanat e përshkruara në paragrafin 8.4.6.1 të vazhdojnë për më shumë se tre muaj.

8.4.6.3 Një **NOK** lëshohet nga **OST** dhe do të përmbaj informacionet e mëposhtme, të cilat duhet të jenë qartë të identifikueshme:

- a) çështjet e pazgjidhura që justifikojnë dhënien e **NOK**;
- b) përgjegjësitë dhe afatet kohore për zgjidhjen e pritshme; dhe
- c) një periudhë maksimale të vlefshmërisë e cila nuk duhet të kalojë 12 muaj. Periudha fillestare e dhënë mund të jetë më e shkurtër me mundësinë e zgjatjes nëse paraqitet dëshmi për pajtueshmërinë e **OST**, duke dëshmuar se është bërë progres thelbësor drejt arritjes së pajtueshmërisë së plotë.

8.4.6.4 **NOF** duhet të pezullohet gjatë periudhës së vlefshmërisë së **NOK** në lidhje me çështjet për të cilat është lëshuar **NOK**.

8.4.6.5 Një zgjatje e mëtejshme e periudhës së vlefshmërisë së **NOK** mund të jepet me një kërkesë për derogim të bërë në **OST** para skadimit të asaj periudhe, në përputhje me procedurën e derogimit të përshkruar në kapitullin 10 të këtij Kodi.

8.4.6.6 **OST** ka të drejtë të refuzojë lejimin e operimit të modulit të gjenerimit, pasi **NOK** nuk është i vlefshëm. Në raste të tilla, **NOF** bëhet automatikisht i pavlefshëm.

8.4.6.7 Nëse **OST** nuk lejon zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së **NOK** në përputhje me paragrafin 8.4.6.5 ose nëse refuzon lejimin e operimit të modulit të gjenerimit pasi **NOK** nuk është i vlefshëm sikurse në paragrafin 8.4.6.6, **pronari i centralit të gjenerimit** mund ta adresojë çështjen për vendim tek autoriteti rregullativ brenda gjashtë muajve pas njoftimit për vendimin e **OST**-së.

8.5 Monitorimi i Pajtueshmërisë dhe Testimi i moduleve të gjenerimit të kyçura në rrjetin e transmetimit

8.5.1 Përgjegjësia e pronarit të centralit të gjenerimit

8.5.1.1 **Pronari i centralit të gjenerimit** siguron se secili **modul i gjenerimit** përputhet me kërkesat e zbatueshme sipas këtij Kodi përgjatë jetëgjatësisë së centralit.

8.5.1.2 **Pronari i centralit të gjenerimit** i komunikon **OST**-së çdo modifikim të planifikuar të aftësive teknike të një moduli të gjenerimit që mund të ndikojë në pajtueshmërinë e tij me kërkesat e zbatueshme sipas këtij Kodi, para nisjes së atij modifikimi.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 44 nga 82</i>

8.5.1.3 **Pronari i centralit të gjenerimit** njofton **operatorin e sistemit** për çdo dështim ose incident gjatë operimit të një **moduli të gjenerimit** që ndikon në pajtueshmërinë e tij me kërkesat e këtij Kodi, pa vonesa të pa-arsyeshme, pas ndodhjes së këtyre incidenteve.

8.5.1.4 **Pronari i centralit të gjenerimit** njofton **OST**-në për oraret e planifikuara të testimit dhe procedurat që duhet ndjekur për verifikimin e pajtueshmërisë së një **moduli të gjenerimit** me kërkesat e këtij Kodi, në kohën e duhur dhe para lansimit të tyre. **OST** do të miratojë paraprakisht oraret e planifikuara të testimit dhe procedurat. Miratimi i tillë nga **OST** do të sigurohet në kohën e duhur dhe nuk do të tërhiqet në mënyrë të pa-arsyeshme.

8.5.1.5 **OST** mund të marrë pjesë në testime të tilla dhe të regjistrojë performancën e modulit të gjenerimit.

8.5.2 Detyra e OST-së

8.5.2.1 **OST** do të vlerësojë pajtueshmërinë e **modulit të gjenerimit** me kërkesat e zbatueshme sipas këtij Kodi, përgjatë gjithë jetëgjatësisë së centralit të gjenerimit. **Pronari i centralit të gjenerimit** duhet të informohet me kohë për rezultatet e këtij vlerësimi.

8.5.2.2 **OST** ka të drejtë të kërkojë që **pronari i centralit të gjenerimit** të kryejë teste dhe simulime të pajtueshmërisë sipas një plani të përsëritur ose skeme të përgjithshme ose pas çdo dështimi, modifikimi ose zëvendësimi të ndonjë pajisje që mund të ketë ndikim në pajtueshmërinë e moduleve të gjenerimit sipas kërkesave të këtij Kodi.

8.5.2.3 **Pronari i centralit të gjenerimit** duhet të informohet për rezultatin e atyre testeve të pajtueshmërisë dhe simulimeve.

8.5.2.4 **OST** do të vë në dispozicion të publikut listen e informacionit dhe dokumenteve që do të ofrohen, si dhe kërkesat që duhet të plotësohen nga **pronari i centralit të gjenerimit** në kuadër të procesit të pajtueshmërisë. Lista duhet të mbulojë së paku informacionet, dokumentet dhe kërkesat e mëposhtme:

- a) gjithë dokumentacionin dhe certifikatat që do të sigurohen nga **pronari i centralit të gjenerimit**;
- b) detajet e të dhënave teknike në **modulin e gjenerimit** me rëndësi për kyçjen në rrjet;
- c) kërkesat për modelet për studimet e sistemit për gjendjen e qëndrueshme dhe dinamike;
- d) afati kohor për sigurimin e të dhënave të sistemit që kërkohen për kryerjen e studimeve;
- e) studimet nga **pronari i centralit të gjenerimit** për të dëshmuar performancën e pritshme të gjendjes të qëndrueshme dhe dinamike në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 8.5.7 dhe 8.5.8;
- f) kushtet dhe procedurat, përfshirë edhe qëllimin për regjistrimin e certifikatave të pajisjeve; dhe
- g) kushtet dhe procedurat për përdorimin e certifikatave përkatëse të pajisjeve të lëshuara nga një certifikues i autorizuar nga **pronari i centralit të gjenerimit**.

8.5.2.5 **OST** e bën publike ndarjen e përgjegjësive ndërmjet **pronarit të centralit të gjenerimit** dhe **OST** për testimin, simulimin dhe monitorimin e pajtueshmërisë.

8.5.2.6 **OST** mund t'i delegojë tërësisht ose pjesërisht performancën e monitorimit të pajtueshmërisë së tij palëve të treta. Në raste të tilla, **OST** do të vazhdojë të sigurojë pajtueshmërinë me detyrimet e konfidencialitetit, duke përfshirë zotimet e konfidencialitetit me palën e tretë.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 45 nga 82</i>

8.5.2.7 Nëse simulimet ose testet e pajtueshmërisë nuk mund të kryhen sipas marrëveshjes midis **OST** dhe pronarit të centralit të gjenerimit për shkak të arsyeve që i atribuohen **OST**, atëherë **OST** nuk duhet të tërheq në mënyrë të pa-arsyeshme njoftimin për operim të përmendur në paragrafin 8.4.

8.5.2.8 **OST**-ja duhet t'ia japë pronarit të centralit të gjenerimit të paktën një njoftim në muaj për monitorimin e pajtueshmërisë. Ky njoftim do të japë kohën e fillimit të monitorimit, kohëzgjatjen e pritshme dhe emrin e personit përgjegjës që do të kryejë monitorimin. Gjithashtu do të përfshijë arsyet për monitorimin dhe natyrën e çdo mos-pajtueshmërie të dyshuar. **Pronari i centralit të gjenerimit**, në përgjigje, duhet t'u japë atyre qasje të plotë dhe mbështetjen e nevojshme për të kryer monitorimin e pajtueshmërisë.

8.5.2.9 Zyrtari i **OST**-së duhet të përmbushë kushtet e monitorimit të pajtueshmërisë, kushtet e vendndodhjes dhe nuk duhet t'i shkaktojë dëme centralit. Ata mund të ndërhyjnë në operimin e centralit vetëm deri në masën që është e nevojshme dhe e miratuar nga **pronari i centralit të gjenerimit** për të kryer monitorimin e dakorduar të pajtueshmërisë.

8.5.2.10 Shpenzimet e një monitorimi të pajtueshmërisë të kryer sipas paragrafit 8.5 do të paguhet nga **OST**. Megjithatë, nëse testimi dëshmon një devijim të konsiderueshëm të centralit të gjenerimit nga të dhënat e ofruara dhe/ose mos-përputhje me specifikimet teknike të kërkuara siç janë përshkruar në këtë kod të kyçjes, shpenzimet e monitorimit të pajtueshmërisë do të mbulohen nga **pronari i centralit të gjenerimit**.

8.5.3 Dispozita të zakonshme për testimin e pajtueshmërisë

8.5.3.1 Testimi i performancës së moduleve individuale të gjenerimit brenda një centralit të gjenerimit synojnë dëshminë se kërkesat e këtij Kodi janë përmbushur.

8.5.3.2 Pavarësisht nga kërkesat minimale për testimet e pajtueshmërisë të përcaktuara në këtë Kod, **OST**-ja ka të drejtë:

- a) të lejojë **pronarin e centralit të gjenerimit** të kryejnë një grup alternativ testesh, me kusht që këto teste të jenë efikase dhe të mjaftueshme për të dëshmuar se moduli i gjenerimit është në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;
- b) të kërkojë nga **pronari i centralit të gjenerimit** të kryejë një grup shtesë ose alternativ testimesh në ato raste kur informacioni që i ofrohet **OST**-së në lidhje me testimin e pajtueshmërisë sipas dispozitave të paragrafit 8.5.5 dhe 8.5.6, nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar pajtueshmërinë me kërkesat e këtij Kodi; dhe
- c) të kërkojë nga **pronari i centralit të gjenerimit** të kryejë testet e duhura për të dëshmuar performancën e modulit të gjenerimit gjatë operimit me lëndë djegëse alternative ose me mikse të lëndëve djegëse. **OST**-ja dhe **pronari i centralit të gjenerimit** duhet të dakordohen se cilat lloje të lëndëve djegëse do të testohen.

8.5.3.3 **Pronari i centralit të gjenerimit** është përgjegjës për kryerjen e testeve në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 8.5.5 dhe 8.5.6. **OST** do të bashkëpunojë dhe nuk do të vonojë pa nevojë kryerjen e testeve.

8.5.3.4 **OST** mund të marrë pjesë në testimin e pajtueshmërisë qoftë në vendngjarje apo në distancë nga qendra e kontrollit të operatorit të sistemit. Për këtë qëllim, **pronari i centralit të gjenerimit** do të sigurojë pajisjet e monitorimit të nevojshme për regjistrimin e të gjitha sinjaleve të testeve dhe matjeve relevante si dhe të sigurojë që përfaqësuesit e nevojshëm të pronarit të centralit të gjenerimit janë

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 46 nga 82</i>

prezent përgjatë tërë periudhës së testimit. Sinjalet e specifikuar nga **OST** do të sigurohen nëse për testet e përzgjedhura, operatori i sistemit dëshiron të përdorë pajisjet e veta për të regjistruar performancën. **OST** ka të drejtën që të vendos për pjesëmarrjen e tij.

8.5.3.5 **OST** mund ti vendosë pajisjet për testim dhe monitorim në impiantin e pronarit të centralit të gjenerimit ose të kërkojë që pronari i centralit të gjenerimit ti vendosë pajisjet e tilla të testimit. Gjatë monitorimit, **OST** nuk duhet në asnjë mënyrë të kufizoj performancën e impiantit të monitoruar.

8.5.3.6 Secili **pronar i centralit të gjenerimit** duhet të bashkëpunojë me **OST** në testimet gjatë funksionimit të pajisjeve që janë pjesë e sistemit mbrojtës në e pikën e kyçjes në të cilën ky central i gjenerimit është i kyçur në sistemin e transmetimit dhe **OST** duhet të kryejë këto teste si në vijim:

- a) Para lëshimit në punë të centralit në pikën e kyçjes përkatëse;
- b) Në intervalet e specifikuar në marrëveshjen e kyçjes;
- c) Nëse **OST** supozon se sistemi i mbrojtjes nuk është në përputhje me kërkesat e Kodit të Rrjetit ose MK.

8.5.4 Dispozita të përgjithshme për simulimin e pajtueshmërisë

8.5.4.1 Simulimi i performancës së moduleve individuale të gjenerimit brenda një centrali të gjenerimit do të synojë të dëshmojë se kërkesat e këtij Kodi janë përmbushur.

8.5.4.2 Pavarësisht nga kërkesat minimale të përcaktuara në këtë Kod për simulimin e pajtueshmërisë, **OST** mundet:

- a) të lejojë **pronarin e centralit të gjenerimit** të kryejë një grup alternativ simulimesh, me kusht që këto simulime të jenë efikase dhe të mjaftueshme për të dëshmuar se moduli i gjenerimit përputhet me kërkesat e këtij Kodi ose me legjislacionin kombëtar; dhe
- b) të kërkojë nga **pronari i centralit të gjenerimit** që të kryejë simulime shtesë ose alternative në ato raste ku informacioni i ofruar tek **OST** në lidhje me simulimin e pajtueshmërisë sipas dispozitave të paragrafit 8.5.7 dhe 8.5.8 nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar pajtueshmërinë me kërkesat e këtij Kodi.

8.5.4.3 Për të dëshmuar pajtueshmërinë me kërkesat e këtij Kodi, **pronari i centralit të gjenerimit** duhet të ofrojë një raport me rezultatet e simulimit për secilin modul individual të gjenerimit që ndodhen brenda centralit të gjenerimit. **Pronari i centralit të gjenerimit** do të zhvillojë dhe ofrojë një model të validuar simulimi për një modul të caktuar të gjenerimit.

8.5.4.4 **OST** do të ketë të drejtë të kontrollojë se një modul i gjenerimit përputhet me kërkesat e këtij Kodi duke kryer simulimet e veta të pajtueshmërisë bazuar në raportet e pranuar të simulimit, modelet e simulimit dhe testet e matjeve të pajtueshmërisë.

8.5.4.5 **OST**-ja do t'i sigurojë **pronarit të centralit të gjenerimit** të dhënat teknike dhe një model simulimi të rrjetit, të nevojshme për kryerjen e simulimeve të kërkuara në përputhje me paragrafin 8.1.5.

8.5.5 Testimi i pajtueshmërisë për modulet sinkrone të gjenerimit

8.5.5.1 **Pronarët e centralit të gjenerimit** do të ndërmarrin testet e pajtueshmërisë të përcaktuara në paragrafët 8.5.5.2, 8.5.5.3, 8.5.5.4 dhe 8.5.5.6 në lidhje me modulet sinkrone të gjenerimit. Kur moduli i gjenerimit ofron aftësinë e stratimit nga errësira, **pronarët e centraleve të gjenerimit** gjithashtu do të ndërmarrin testet e përmendura në 8.5.5.5. Në vend të testit relevant, **pronari i centralit të gjenerimit**

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 47 nga 82</i>

mund të përdorë certifikatat e pajisjeve të lëshuara nga një certifikues i autorizuar për të dëshmuar pajtueshmërinë me kërkesat përkatëse. Në këtë rast, certifikatat e pajisjeve do t'i ofrohen **OST**-së.

8.5.5.2 Do të vlejné kërkesat e mëposhtme në lidhje me testin e reagimit **MSFK-N**:

- a) do të dëshmojë që moduli i gjenerimit është teknikisht i aftë të modifikojë në vazhdimësi fuqinë aktive në pikat e punës nën kapacitetin maksimal për të kontribuar në rregullimin e frekuencës në rast të një rënie të madhe të frekuencës në sistem;
- b) testi do të kryhet duke simuluar pikat e duhura të ngarkesës të fuqisë aktive, me shkallë të vogla të frekuencës dhe me pjerrtësi të madhe për të inicuar ndryshimin e fuqisë aktive në të paktën 10% të kapacitetit maksimal, duke marrë parasysh të dhënat e karakteristikës rënëse (ulëse) dhe zonën e vdekur. Nëse kërkohet, sinjalet e simuluar të devijimit të frekuencës duhet të injektohen njëkohësisht në rregulluesin e shpejtësisë dhe në rregullatorin e fuqisë referente;
- c) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - rezultatet e testit, si për parametrat dinamik ashtu edhe për ata statik, përputhen me paragrafin 8.1.3.8; dhe
 - oscilimet e pa-amortizuara nuk shfaqen pas reagimit në ndryshim shkalle.

8.5.5.3 Kërkesat e mëposhtme në lidhje me testin e reagimit të **MSF** që do të zbatohen:

- a) moduli i gjenerimit duhet të dëshmojë që është teknikisht i aftë të modifikojë vazhdimisht fuqinë aktive në tërë brezin e punës midis kapacitetit maksimal dhe atij minimal për të kontribuar në rregullimin e frekuencës. Parametrat e rregullimit të gjendjes së qëndrueshme, të tilla si karakteristikat rënëse dhe zona e vdekur dhe parametrat dinamik, përfshirë qëndrueshmërinë përmes reagimit të ndryshimit shkallë dhe më të mëdha të frekuencës, devijimet e shpejta të frekuencës duhet të verifikohen;
- b) testi do të kryhet duke simuluar ndryshimet shkallë dhe pjerrtësitë mjaftueshëm të mëdha për të inicuar tërë brezin e reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës, duke marrë në konsideratë karakteristikat rënëse dhe zonën e vdekur si dhe aftësinë për të rritur ose ulur fuqinë aktive dalëse nga pika përkatëse e punës. Nëse kërkohet, sinjali i simuluar të devijimit të frekuencës duhet të injektohen njëkohësisht në referencat e rregullatorit të shpejtësisë dhe rregullatorit të ngarkesës të njësisë ose sistemit të kontrollit të centralit;
- c) Testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - koha e aktivizimit të tërë fuqisë aktive në kuadër të brezit të reagimit të frekuencës, si rezultat i ndryshimit shkallë të frekuencës nuk është më gjatë se sa që kërkohet në paragrafin 8.1.4.7;
 - oscilimet e pa-amortizuara nuk shfaqen pas reagimit ndaj ndryshimit shkallë;
 - koha fillestare e vonesës përputhet me paragrafin 8.1.4.7;
 - karakteristikat rënëse janë në dispozicion brenda brezit të specifikuar në paragrafin 8.1.4.7 dhe zona e vdekur (pragu) nuk është më e lartë se vlera e specifikuar në atë paragraf; dhe
 - mos ndjeshmëria e reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës në çdo pikë relevante të punës nuk i tejkalon kërkesat e përcaktuara në paragrafin 8.1.4.7.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 48 nga 82</i>

8.5.5.4 Sa i përket testit të kontrollit të restaurimit të frekuencës, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) do të aplikohen aftësitë teknike të moduleve të gjenerimit që të marrin pjesë në kontrollin e restaurimit të frekuencës dhe do të kontrollohet ndërlidhshmëria e **MSF** dhe kontrollit të restaurimit të frekuencës;
- b) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse rezultatet për parametrat dinamikë dhe statikë përputhen me kërkesat e paragrafit 8.1.4.8 pika (k).

8.5.5.5 Sa i përket testimit të aftësisë së startimit nga errësira, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) për modulën e gjenerimit me aftësi të startimit nga errësira, duhet të dëshmohet kjo aftësi teknike për të filluar nga gjendja e fikur pa ndonjë furnizim të jashtëm të energjisë elektrike;
- b) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse koha e startimit është brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën b) të paragrafit 8.1.9.2.

8.5.5.6 Sa i përket testit të kalimit në ngarkesën vetanake, do të zbatohen kërkesat në vijim:

- a) do të dëshmohet aftësia teknike e moduleve të gjenerimit që të kalojë dhe operojë në mënyrë stabile në ngarkesën vetanake;
- b) testi do të kryhet në kapacitet maksimal dhe fuqi nominale reaktive të modulit të gjenerimit para reduktimit të ngarkesës;
- c) **OST** do të ketë të drejtë të caktojë kushte shtesë, duke marrë parasysh paragrafin 8.1.9.4;
- d) testi do të konsiderohet si i suksesshëm nëse kalimi në ngarkesë vetanake është i suksesshëm, nëse është dëshmuar operim stabil në ngarkesë vetanake në periudhën kohore të përcaktuar në paragrafin 8.1.9.4; dhe nëse ri-sinkronizimi me rrjetin është kryer me sukses.

8.5.5.7 Sa i përket testit të aftësisë për fuqi reaktive, do të zbatohen kërkesat në vijim:

- a) do të dëshmohet aftësia teknike e modulit të gjenerimit për të ofruar fuqi reaktive kapacitive dhe induktive në përputhje me paragrafët 8.2.1.2 dhe 8.2.1.4;
- b) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - moduli i gjenerimit operon në fuqi maksimale reaktive për të paktën një orë, si në fuqi kapacitive ashtu edhe induktive, në nivelin minimal të operimit të qëndrueshëm, në kapacitet maksimal dhe një pike të operimit të fuqisë ndërmjet niveleve maksimale dhe minimale;
 - do të dëshmohet aftësia e moduleve të gjenerimit për të ndryshuar në ndonjë vlerë të synuar të fuqisë reaktive brenda brezit të dakorduar ose të vendosur të fuqisë reaktive.

8.5.5.8 Në vend të testit përkatës, **pronari i centralit të gjenerimit** mund të përdorë certifikatat e pajisjeve të lëshuara nga një certifikues i autorizuar për të dëshmuar pajtueshmërinë me kërkesat përkatëse. Në një rast të tillë, **OST**-së duhet t'i ofrohen certifikatat e pajisjes.

8.5.6 Testimi i pajtueshmërisë për modulet e parkut gjenerues të kyçura në rrjetin e transmetimit

8.5.6.1 **Pronarët e centralit të gjenerimit** kryejnë teste të pajtueshmërisë së reagimit **MSFK-M** në lidhje me modulet e parkut. Në vend të testit përkatës, **pronari i centralit të gjenerimit** mund të përdorë

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 49 nga 82</i>

certifikatat e lëshuara nga një certifikues i autorizuar për të dëshmuar pajtueshmërinë me kërkesat përkatëse. Në atë rast, **OST**-së do t'i ofrohen certifikatat e pajisjeve.

8.5.6.2 Testet e reagimit **MSFK-M** do të reflektojnë zgjedhjen e skemës së rregullimit të përzgjedhur nga **OST**.

8.5.6.3 Në lidhje me testet e reagimit **MSFK-M**, do të zbatohen kërkesat në vijim:

- a) do të dëshmohet aftësia teknike e modulit të parkut për të rregulluar vazhdimisht fuqinë aktive për të kontribuar në rregullimin e frekuencës në rast të rritjes së frekuencës në sistem. Do të verifikohen parametrat e rregullimit të gjendjes së qëndrueshme, siç janë karakteristika rënëse, zona e vdekur dhe parametrat dinamik;
- b) testi do të kryhet duke simuluar brezin dhe ndryshimet shkallë të frekuencës dhe pjerrtësi të mjaftueshme për të inicuar të paktën 10% ndryshim të kapacitetit maksimal të fuqisë aktive, duke marrë parasysh parametrat e karakteristikës rënëse dhe zonën e vdekur. Për të kryer këtë test, sinjale të simuluar të devijimit të frekuencës duhet të injektohen njëkohësisht në referencat e sistemit të kontrollit;
- c) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse rezultatet gjatë testimit, për parametrat dinamikë dhe statikë, përputhen me kërkesat e parashtruara në paragrafin 8.1.3.1.

8.5.6.4 Sa i përket kontrollueshmërisë së fuqisë aktive dhe testimit të brezit të rregullimit, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) do të dëshmohet aftësia teknike e modulit të parkut gjenerues për të operuar në një nivel të ngarkesës nën pikën e punës të përcaktuar nga **OST**;
- b) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - niveli i ngarkesës së modulit të parkut gjenerues mbahet nën pikën e përcaktuar të punës;
 - pika e përcaktuar e punës zbatohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën a) të paragrafit 8.1.2.2; dhe
 - saktësia e rregullimit është në përputhje me vlerën që do të specifikohet sipas paragrafit 8.1.2.2 pika b).

8.5.6.5 Sa i përket testit të reagimit **MSFK-N**, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) do të dëshmohet aftësia teknike e **modulit të parkut gjenerues** për të modifikuar vazhdimisht fuqinë aktive që të kontribuoj në rregullimin e frekuencës në rast të rënies së madhe të frekuencës në sistem;
- b) testi do të kryhet duke simuluar ndryshimin shkallë të frekuencës dhe pjerrtësi që janë mjaftueshëm për të inicuar të paktën 10% ndryshim të fuqisë aktive ndaj kapacitetit maksimal me një pikë fillestare prej jo më shumë se 80% të kapacitetit maksimal, duke marrë parasysh parametrat e karakteristikës rënëse dhe zonën e vdekur;
- c) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
- d) rezultatet e testimit, për parametrat dinamikë dhe statikë, përputhen me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 8.1.2.2, pika c); dhe
- e) oscilimet e pa amortizuara nuk ndodhin pas reagimit në ndryshim shkallë.

8.5.6.6 Sa i përket testit të reagimit të **MSF**, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 50 nga 82</i>

- a) do të dëshmohet aftësia teknike e **modulit të parkut gjenerues** për të modifikuar vazhdimisht fuqinë aktive përgjatë brezit operues ndërmjet kapacitetit maksimal dhe nivelit minimal të rregullimit për të kontribuar në rregullimin e frekuencës. Do të verifikohen parametrat në gjendje të qëndrueshme të rregullimit, siç janë mos ndjeshmëria, karakteristika rënëse, zona e vdekur dhe brezi i rregullimit, si dhe parametrat dinamikë, duke përfshirë reagimin e ndryshimit shkallë të frekuencës;
- b) testi do të kryhet duke simuluar ndryshimin shkallë të frekuencës dhe pjerrtësi që janë mjaftueshëm për të inicuar të gjithë brezin e reagimit të fuqisë aktive në frekuencë, duke marrë parasysh parametrat e karakteristikës rënëse dhe zonën e vdekur. Duhet të injektohen sinjalet e simuluar të devijimit të frekuencës për të kryer testin;
- c) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
- koha e aktivizimit të tërë brezit të reagimit të fuqisë aktive në frekuencë si rezultat i ndryshimit shkallë të frekuencës nuk është më e gjatë se ajo që kërkohet nga paragrafi 8.1.4.7;
 - oscilimet e pa amortizuara nuk ndodhin pas reagimit të ndryshimit shkallë;
 - vonesa fillestare është në përputhje me paragrafin 8.1.4.7;
 - parametrat e karakteristikës rënëse janë në dispozicion brenda brezit të specifikuar në paragrafin 8.1.4.7 dhe zona e vdekur (pragu) nuk është më e lartë se vlera e përzgjedhur nga **OST**; dhe
 - mos ndjeshmëria e reagimit të fuqisë aktive në frekuencë nuk kalon kërkesat e përcaktuara në paragrafin 8.1.4.7.
- d) Sa i përket testit të kontrollit të restaurimit të frekuencës, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:
- do të dëshmohet aftësia teknike e modulit të parkut gjenerues që të marrë pjesë në kontrollin e restaurimit të frekuencës. Do të verifikohet ndërveprimi i **MSF** dhe kontrollit të restaurimit të frekuencës;
 - testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse rezultatet për parametrat dinamikë dhe statikë përputhen me kërkesat e pikës k) të paragrafit 8.1.4.8.

8.5.6.7 Sa i përket testit të aftësisë për fuqi reaktive, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) do të dëshmohet aftësia teknike e **modulit të parkut gjenerues** për të ofruar fuqi reaktive induktive dhe kapacitive në përputhje me pikat b) dhe d) të paragrafit 8.3.1.5;
- b) testi do të kryhet për fuqi maksimale reaktive, si për fuqinë induktive edhe për atë kapacitive, dhe duhet të verifikojë parametrat e mëposhtme:
- operim që tejkalon 60% të kapacitetit maksimal për 30 min;
 - operim brenda brezit prej 30-50% të kapacitetit maksimal për 30 min; dhe
 - operim brenda brezit prej 10-20% të kapacitetit maksimal për 60 min;
- c) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:
- moduli i parkut gjenerues operon për një kohëzgjatje jo më të shkurtër se kohëzgjatja e kërkuar për fuqinë maksimale reaktive, si për fuqinë induktive edhe për atë kapacitive, në çdo parametër të specifikuar në paragrafin 8.5.6.7, pika b);

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 51 nga 82</i>

- dëshmohet aftësia e modulit të parkut gjenerues për të ndryshuar në çfarëdo vlerë të synuar të fuqisë reaktive brenda brezit të dakorduar ose të vendosur të fuqisë reaktive; dhe
- asnjë veprim i mbrojtjes nuk ndodh brenda kufijve të operimit të specifikuar në diagramin e kapacitetit të fuqisë reaktive.

8.5.6.8 Sa i përket testit të modusit të rregullimit të tensionit, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) do të dëshmohet aftësia e modulit të parkut gjenerues për të operuar në modusin e rregullimit të tensionit të referuar në kushtet e përcaktuara në pikën d) të paragrafit 8.3.1.5;
- b) Testimi i modusit të rregullimit të tensionit do të verifikojë parametrat e mëposhtëm:
 - pjerrtësinë dhe zonën e vdekur të zbatuar sipas pikës e) të paragrafit 8.3.1.5;
 - saktësinë e rregullimit;
 - mos ndjeshmërinë e rregullimit; dhe
 - kohën e aktivizimit të fuqisë reaktive;
- c) Testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - Brezi i rregullimit, zona e vdekur dhe karakteristika rënëse e modifikueshme përputhet me parametrat karakteristik të dakorduara ose të përcaktuara në pikën e) të paragrafit 8.3.1.5;
 - Mos ndjeshmëria e kontrollit të tensionit nuk është më e lartë se 0,01 pu, në përputhje me pikën e) të paragrafit 8.3.1.5; dhe
 - pas një ndryshimi shkallë të tensionit, 90% e ndryshimit në prodhimin e fuqisë reaktive është arritur brenda kohës dhe tolerancës të specifikuar në pikën e) të paragrafit 8.3.1.5.

8.5.6.9 Sa i përket testit të modusit të rregullimit të fuqisë reaktive, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) do të dëshmohet aftësia e modulit të parkut gjenerues për të operuar në modusin e rregullimit të fuqisë reaktive, në përputhje me pikën e) të paragrafit 8.3.1.5;
- b) testi i modusit të rregullimit të fuqisë reaktive do të jetë në pajtueshmëri me testin e aftësisë për fuqi reaktive;
- c) testi i modusit të rregullimit të fuqisë reaktive do të verifikojë parametrat e mëposhtëm:
 - brezi i pikës së punës dhe inkrementi i fuqisë reaktive;
 - saktësia e rregullimit; dhe
 - koha e aktivizimit të fuqisë reaktive.
- d) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - brezi i pikës së punës dhe inkrementi i fuqisë reaktive sigurohen në përputhje me pikën e) të paragrafit 8.3.1.5; dhe
 - saktësia e rregullimit përputhet me kushtet e përcaktuara në pikën (e) të paragrafit 8.3.1.5.

8.5.6.10 Sa i përket testit të modusit të rregullimit të faktorit të fuqisë, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) do të dëshmohet aftësia e modulit të parkut gjenerues për të operuar në modusin e rregullimit të faktorit të fuqisë në përputhje me pikën e) të paragrafit 8.3.1.5;

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 52 nga 82</i>

- b) gjatë testit të modusit të rregullimit të faktorit të fuqisë do të verifikohen parametrat e mëposhtëm:
- brezi i pikës së punës të faktorit të fuqisë;
 - saktësia e rregullimit; dhe
 - reagimi i fuqisë reaktive për shkak të ndryshimit shkallë të fuqisë aktive;
- c) testi do të konsiderohet i suksesshëm nëse përmbushen kushtet e mëposhtme në mënyrë kumulative:
- brezi i pikës së punës dhe inkrementi i faktorit të fuqisë sigurohen në përputhje me pikën e) të paragrafit 8.3.1.5;
 - koha e aktivizimit të fuqisë reaktive si rezultat i ndryshimit shkallë të fuqisë aktive nuk i kalon kërkesat e përcaktuara në pikën e) të paragrafit 8.3.1.5; dhe
 - saktësia e rregullimit përputhet me vlerën e specifikuar në pikën e) të paragrafit 8.3.1.5.

8.5.6.11 Sa i përket testeve të referuara në paragrafët 8.5.6.8, 8.5.6.9 dhe 8.5.6.10, **OST** mund të zgjedhë vetëm një nga tri opsionet e kontrollit për testim.

8.5.7 Simulimi i pajtueshmërisë për modulet gjeneruese sinkrone

8.5.7.1 Modulet gjeneruese sinkrone i nënshtrohen simulimeve të pajtueshmërisë të detajuara në paragrafët 8.5.7.2 deri 8.5.7.5. Në vend të të gjitha ose të një pjese të këtyre simulimeve, **pronari i centralit gjenerues** mund të përdorë certifikata të pajisjeve të lëshuara nga një certifikues i autorizuar, të cilat duhet ti ofrohen **OST**-së.

8.5.7.2 Sa i përket simulimit të reagimit **MSFK-N**, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) dëshkohet aftësia e moduleve gjeneruese për të rregulluar fuqinë aktive në frekuenca të ulëta në përputhje me paragrafin 8.1.4.7;
- b) simulimi kryhet me ndryshime të vogla shkallë të frekuencës dhe pjerrtësitë mjaftueshëm të mëdha për të inicuar tërë brezin e reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës, duke marrë në konsideratë karakteristikat rënëse dhe zonën e vdekur;
- c) simulimi konsiderohet i suksesshëm në rast se:
- modeli i simulimit të modulit gjenerues validohet kundrejt testit të pajtueshmërisë për reagimin e **MSFK-N** të përshkruar në paragrafin 8.5.5.2; dhe
 - dëshkohet pajtueshmëria me kërkesat e paragrafit 8.1.3.8.

8.5.7.3 Sa i përket simulimit të reagimit të **MSF**-së, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) dëshkohet aftësia e moduleve gjeneruese për të rregulluar fuqinë aktive në tërë brezin e frekuencës në përputhje me paragrafin 8.1.4.7;
- b) simulimi kryhet duke simuluar ndryshimin shkallë të frekuencës dhe pjerrtësitë mjaftueshëm të mëdha për të inicuar tërë brezin e reagimit të fuqisë aktive ndaj frekuencës, duke marrë në konsideratë karakteristikat rënëse dhe zonën e vdekur;
- c) simulimi konsiderohet i suksesshëm në rast se:

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 53 nga 82</i>

- modeli i simulimit të modulit gjenerues validohet kundrejt testit të pajtueshmërisë për reagimin e **MSF**-së, të përshkruar në paragrafin 8.5.5.3; dhe
- dëshmohet përputhja me kërkesat e paragrafit 8.5.8.

8.5.7.4 Në lidhje me simulimin të operimit në ishull, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) dëshmohet performanca e moduleve gjeneruese gjatë operimit në ishull të referuara sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 8.1.4.7;
- b) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse moduli i gjenerimit zvogëlon ose rrit fuqinë aktive dalëse nga pika e mëparshme e punës në çdo pikë të re të punës brenda diagramit të aftësisë P-Q, brenda kufijve të specifikuar në paragrafin 8.1.9.3 pa shkyçjen e modulit të gjenerimit nga ishulli për shkak të mbi ose nën frekuencës.

8.5.7.5 Në lidhje me simulimin e aftësisë për fuqi reaktive do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) dëshmohet aftësia e moduleve gjeneruese për të siguruar aftësinë për fuqi reaktive kapacitive dhe induktive, në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafët 8.2.1.2 dhe 8.2.1.4;
- b) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - modeli i simulimit të modulit gjenerues është validuar kundrejt testeve të pajtueshmërisë së aftësisë për fuqi reaktive të përshkruar në paragrafin 8.5.5.7; dhe
 - dëshmohet përputhja me kërkesat e paragrafëve 8.2.1.2 dhe 8.2.1.4.

8.5.7.6 Në lidhje me simulimin e kontrollit të amortizimit të oscilimeve të fuqisë, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) Duhet të dëshmohet se performanca e moduleve gjeneruese në lidhje me sistemin e tij të kontrollit ('funksioni PSS') është i aftë të amortizojë oscilimet e fuqisë aktive në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 8.2.2;
- b) tarimi duhet të rezultojë në përmirësimin e amortizimit të reagimit përkatës të fuqisë aktive të RAT në kombinim me funksionin PSS, krahasuar me reagimin e fuqisë aktive të RAT si e vetme;
- c) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse kushtet e mëposhtme plotësohen tërësisht:
 - funksioni i PSS amortizon oscilimet ekzistuese të fuqisë aktive të modulit gjenerues brenda brezeve të frekuencës të përcaktuar nga **OST**-ja. Ky brez i frekuencës përfshin modusin e frekuencës lokale të modulit gjenerues dhe oscilimet e pritura në rrjet; dhe
 - zvoglimi i pa pritur i ngarkesës së modulit gjenerues nga 1 pu në 0,6 pu ndaj kapacitetit maksimal nuk çon në oscilime të pa amortizuara të fuqisë aktive ose reaktive të modulit gjenerues.

8.5.7.7 Në lidhje me simulimin e aftësisë së kalimit nëpër prishje të moduleve gjeneruese sinkrone, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 54 nga 82</i>

- a) dëshmoheft aftësia e **moduleve gjeneruese** për të siguruar kalimin nëpër prishje në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 8.1.6.4;
- b) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse dëshmoheft pajtueshmëria me kërkesat e parashtruara në paragrafin 8.1.6.4.

8.5.8 Simulimi i pajtueshmërisë për modulet e parkut gjenerues të kyçura në rrjetin e transmetimit

8.5.8.1 **Modulet e parkut gjenerues** i nënshtrohen simulimeve të pajtueshmërisë në paragrafët 8.5.8.2 deri 8.5.8.5. Në vend të të gjitha ose një pjese të këtyre simulimeve, **pronari i centralit gjenerues** mund të përdorë certifikata të pajisjeve të lëshuara nga një certifikues i autorizuar, të cilat duhet t'i ofrohen **OST-së**.

8.5.8.2 Për sa i përket simulimit të reagimit **MSFK-M**, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) dëshmoheft aftësia e modulit të parkut gjenerues për të rregulluar fuqinë aktive për frekuencë të lartë në përputhje me paragrafin 8.1.3.1;
- b) simulimi kryhet me ndryshim shkallë të frekuencës së lartë dhe pjerrtësisë që arrin nivelin minimal të rregullimit, duke marrë parasysh karakteristikën rënëse dhe zonën e vdekur;
- c) simulimi konsiderohet i suksesshëm në rast se:
 - modeli i simulimit të modulit të parkut gjenerues validohet kundrejt testit të pajtueshmërisë për reagimin e **MSFK-M** të paraqitur në paragrafin 8.5.6.3; dhe
 - dëshmoheft përputhja me kërkesat e parashtruara në paragrafin 8.1.3.1.

8.5.8.3 Sa i përket simulimit të injektimit të rrymës së shpejtë të prishjes, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) dëshmoheft aftësia e **modulit të parkut gjenerues** për të siguruar injektimin e rrymës së shpejtë të prishjes në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 8.3.1.1;
- b) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse dëshmoheft përputhja me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 8.3.1.1.

8.5.8.4 Në lidhje me simulimin e aftësisë të kalimit nëpër prishje të **moduleve të parqeve gjeneruese**, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) aftësia e **modulit të parkut gjenerues** për kalimin nëpër prishje në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 8.1.6.4 dëshmoheft me anë të simulimit;
- b) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse dëshmoheft përputhja me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 8.1.6.4.

8.5.8.5 Zbatohen kërkesat e mëposhtme në lidhje me simulimin e fuqisë aktive pas eliminimit të prishjes:

- a) dëshmoheft aftësia e modulit të parkut gjenerues për të siguruar fuqi aktive të rimëkëmbjes pas eliminimit të prishjes, në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 8.3.1.3;
- b) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse dëshmoheft përputhja me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 8.3.1.3.

8.5.8.6 Në lidhje me simulimin e reagimit të **MSFK-N**, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) dëshmoheft aftësia e modulit të parkut gjenerues për të rregulluar fuqinë aktive për frekuencë të ulët në përputhje me paragrafin 8.1.3.8

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 55 nga 82</i>

- b) simulimi kryhet duke simuluar ndryshimin shkallë të frekuencave të ulëta dhe pjerrtësitë duke arritur kapacitetin maksimal, duke marrë parasysh parametrat e karakteristikës rënëse dhe zonën e vdekur;
- c) simulimi konsiderohet i suksesshëm në rast se:
 - modeli i simulimit të modulit të parkut gjenerues validohet kundrejt testit të pajtueshmërisë për reagimin e **MSFK-N** të përcaktuar në paragrafin 8.5.6.5; dhe
 - dëshmohet përputhja me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 8.1.3.8.

8.5.8.7 Në lidhje me simulimin e reagimit të **MSF**-së, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) dëshmohet aftësia e modulit të parkut gjenerues për të rregulluar fuqinë aktive përgjatë tërë brezit të frekuencës siç përmendet në paragrafin 8.1.4.7;
- b) simulimi kryhet duke simuluar ndryshimin shkallë të frekuencës dhe pjerrtësiwe mjaftueshëm të mëdha për të inicuar reagimin e gjithë brezit të fuqisë aktive ndaj frekuencës, duke marrë parasysh parametrat e karakteristikës rënëse dhe zonën e vdekur;
- c) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse:
 - modeli i simulimit të modulit të parkut gjenerues validohet kundrejt testit të pajtueshmërisë për reagimin e **MSF**-së të përcaktuar në paragrafin 8.5.6.6; dhe
 - dëshmohet përputhja me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 8.1.4.7.

8.5.8.8 Sa i përket simulimit të operimit në ishull, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) dëshmohet performanca e **modulit të parkut gjenerues** gjatë operimit në ishull në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara në paragrafin 8.1.9.3;
- b) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse **moduli i parkut gjenerues** zvogëlon ose rrit fuqinë aktive dalëse nga pika e mëparshme e punës në çdo pikë të re të punës brenda diagramit të aftësisë P-Q, brenda kufijve të specifikuar në paragrafin 8.1.9.3 pa shqyçjen e modulit të gjenerimit nga ishulli për shkak të mbi ose nën frekuencës.

8.5.8.9 Në lidhje me simulimin e aftësisë për të siguruar inercionin artificial, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) dëshmohet modeli i aftësisë së **modulit të parkut gjenerues** në sigurimin e inercionit artificial në një ngjarje me frekuencë të ulët, siç përcaktohet në paragrafin 8.3.1.4;
- b) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse modeli dëshmon se është në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara në paragrafin 8.3.1.4.

8.5.8.10 Në lidhje me simulimin e aftësisë për fuqi reaktive, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) **moduli i parkut gjenerues** dëshmon se mund të sigurojë aftësinë e moduleve gjeneruese që të sigurojë aftësinë për fuqi reaktive capacitive dhe induktive, siç përcaktohet në pikat b) dhe d) të paragrafit 8.3.1.5;
- b) simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse kushtet e mëposhtme plotësohen në tërësi:

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 56 nga 82</i>

- modeli i simulimit të modulit të parkut gjenerues është validuar kundrejt testeve të pajtueshmërisë të aftësisë për fuqi reaktive të përshkruar në paragrafin 8.5.6.7; dhe
- dëshmohet pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në pikat e paragrafit 8.3.1.4.

8.5.8.11 Në lidhje me simulimin e rregullimit të amortizimit të oscilimeve të fuqisë, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) modeli i **modulit të parkut gjenerues** dëshmon se mund të sigurojë aftësi për amortizimin e oscilimeve të fuqisë aktive në përputhje me pikën g) të paragrafit 8.3.1.5;
- b) simulimi konsiderohet i suksesshëm në rast se modeli dëshmon pajtueshmëri me kushtet e përshkruara në pikën g) të paragrafit 8.3.1.5.

8.5.8.12 Përveç simulimeve të pajtueshmërisë për **modulet e parkut gjenerues** me kapacitet $\geq 5\text{MW}$ të kyçur në rrjetin e shpërndarjes të përcaktuar në paragrafin 8.5.8, modulet e parkut gjenerues të kyçura në rrjetin e transmetimit i nënshtrohen simulimit të pajtueshmërisë të aftësisë së kalimit nëpër prishje.

8.5.8.13 Në vend të të gjitha ose një pjese të këtyre simulimeve të përmendura në paragrafin 8.5.8.12, **pronari i centralit gjenerues** mund të përdorë certifikata të pajisjeve të lëshuara nga një certifikues i autorizuar, i cili duhet t'i sigurohet **OST**-së.

8.5.8.14 Modeli i **modulit të parkut gjenerues** i kyçur në **rrjetin e transmetimit** dëshmon se është i përshatshëm për të simuluar aftësinë e kalimit nëpër prishje në përputhje me paragrafin 8.1.6.4.

8.5.8.15 Simulimi konsiderohet i suksesshëm nëse modeli dëshmon pajtueshmërinë me kushtet e përcaktuara në paragrafin 8.1.6.4.

8.6 Shkyçja dhe ri-kyçja e moduleve gjeneruese

8.6.1 Shkyçja vullnetare

8.6.1.1 **Pronarët e centraleve gjeneruese** kanë të drejtë të kërkojnë shkyçjen vullnetare të përhershme të moduleve të tyre gjeneruese nga **sistemi i transmetimit**.

8.6.1.2 **Pronari i centralit gjenerues** duhet t'i mbajë të gjitha shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt shkyçjes dhe dekomisionimit vullnetar.


8.6.1.3 **OST**-ja do të realizoj procedurat e dekomisionimit dhe do të njoftojë **shfrytëzuesit** e tjerë nëse beson se kushtet e MK-së përkatëse mund të ndikohen nga procedurat për shkyçje;

8.6.2 Shkyçja e pavullnetshme

8.6.2.1 **OST**-ja mund të vendosë të shkyçë **modulet gjeneruese** nga **sistemi i transmetimit** për shkak të ndonjëres prej rrethanave të mëposhtme:

- a) Në bazë të urdhërave të lëshuar nga autoritetet relevante;
- b) Gjatë një emergjence;
- c) Në përputhje me ligjet e Kosovës;
- d) Në përputhje me dispozitat përkatëse të MK-së;
- e) Në rast të një incidenti të sistemit që shkakton fikjen e modulit gjenerues

8.6.2.2 Në të gjitha rastet e shkyçjes, **OST**-ja duhet të bëjë shqyrtimin dhe pastaj t'i ofroj një raport **pronarit të centralit të gjenerimit** duke e këshilluar rreth rrethanave që kërkojnë një veprim të tillë.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 57 nga 82</i>

8.6.2.3 Në përgjithësi nuk do të ketë kompensim të **pronarit të centralit të gjenerimit** për të hyrat e humbura për shkak të ndërprerjes së pavullnetshme pa njoftim paraprak në shumicën e rrethanave. Shembuj të rrethanave të tilla janë si më poshtë:

- a) Parandalimi i rrezikut të menjëhershëm për shëndetin dhe sigurinë e njerëzve apo objekteve;
- b) Aksident në centralin e gjenerimit ose stabilimentet e kyçjes;
- c) Mos përmbushja nga stafi operativ i centralit të gjenerimit i një urdhri të dhënë nga **OST**-ja;
- d) Rrethanat e tjera jashtë kontrollit të **OST**-së që nuk rezultojnë nga ndonjë veprim i qëllimshëm ose shkelje e kontratës nga ana e tyre dhe nuk i nënshtrohen planifikimit:

8.6.2.4 **OST**-ja do të hartojë një raport që do t'i dorëzohet autoritetit rregullativ i cili do të vendosë nëse kërkohet veprim i mëtejshëm.

8.6.3 Rikycja e moduleve gjeneruese

8.6.3.1 **OST**-ja duhet të sigurojë që centralele të gjenerimit të rikyçen në **sistemin e transmetimit** me një kosto të arsyeshme për pronarin e centraleve gjeneruese sa më shpejt të jetë e mundur nëse:

- a) **OST**-ja është e bindur me arsye se emergjenca që ka shkaktuar shkyçjen e **modulit gjenerues** nuk ekziston më;
- b) **OST**-ja është e bindur me arsye se nuk ekziston më arsyeja për shkyçje sipas **Kodit të rrjetit** ose Ligjeve të Kosovës ose **MK**-së përkatëse;
- c) Një shkelje e **MK**-së, që ka shkaktuar shkyçjen, është korrigjuar dhe **pronari i centralit të gjenerimit** ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të parandaluar përsëritjen e shkeljes dhe ka bërë marrëveshje të detyrueshme me **OST**-në se shkelja nuk do të ri-përsëritet:

9 Kërkesat për shfrytëzuesit e kërkesës (ngarkesës)

9.1 Kërkesat për frekuencë

9.1.1 **Stabilimentet e kërkesës të kyçura në sistemin e transmetimit dhe sistemin e shpërndarjes** duhet të jenë të afta të mbeten të kyçura në rrjet dhe të operojnë në brezin e frekuencave siç është përcaktuar në tabelën 1, paragrafi 8.1.1

9.1.2 Pronari i stabilimenteve të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose **OSSH**-ja mund të dakordohet me **OST** për brez më të gjërë të frekuencave ose afate më të gjata minimale për operim. Nëse brezi më i gjerë i frekuencave ose afatet më të gjata minimale për operim janë teknikisht të mundshme, dakordimi me pronarin e stabilimentit të kërkesës të kyçur në sistemin e transmetimit ose **OSSH**-në, nuk do të ndërpritet pa arsye.

9.2 Kërkesat për tension

9.2.1 Stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit dhe sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit duhet të jenë të aftë të qëndrojnë të kyçura në rrjet dhe të operojnë në brezin e tensioneve dhe periudhat kohore të përcaktuara në tabelën 6 dhe tabelën 7.

9.2.2 Nëse kërkohet nga **OST**-ja, stabilimenti i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit ose sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit është në gjendje të shkyçet automatikisht në tensione të

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 58 nga 82</i>

specifikuara. Termat dhe parametrat për shkyçjen automatike dakordohen midis **OST**-së dhe pronarit të stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose me **OSSH**.

9.2.3 Në lidhje me sistemet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit me nivel të tensionit më të ulët se 110 kV (35 kV, 20 kV, 10 kV dhe 6.3 kV) në pikën e kyçjes, do t'i nënshtrohen Kodit të Shpërndarjes. **OSSH**-ja dizajnon aftësinë e pajisjeve të tyre, të kyçura në tension të njëjtë me tensionin e pikës së kyçjes në sistemin e transmetimit, në përputhje me këtë brez të tensioneve të përcaktuar në Kodin e Shpërndarjes.

Tabela 6. Periudhat minimale kohore gjatë të cilave stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit dhe sistemet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit duhet të operojë për tensione që devijojnë nga vlera nominale në pikën e kyçjes pa u shkëputur nga rrjeti për nivelin e tensionit 220 kV dhe 110 kV

Brezi i tensionit	Periudha kohore për operim
0.90 pu – 1.118 pu	pakufizuar
1.118 pu – 1.15 pu	60 minuta

Tabela 7. Periudhat minimale kohore gjatë të cilave stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit dhe sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit duhet të operojë për tensione që devijojnë nga vlera nominale në pikën e kyçjes pa u shkëputur nga rrjeti për nivelin e tensionit 400 kV

Brezi i tensionit	Periudha kohore për operim
0.90 pu – 1.118 pu	pakufizuar
1.05pu – 1.10 pu	60 minuta

9.3 Kërkesat për lidhje të shkurtë

9.3.1 Bazuar në aftësinë e qëndrueshmërisë gjatë lidhjeve të shkurta, të elementeve të rrjetit të tij të transmetimit, **OST**-ja specifikon rrymën maksimale të lidhjes së shkurtër në pikën e kyçjes që stabilimenti i kërkesës së kyçur me rrjetin e transmetimit ose sistemi shpërndarjes i kyçur me rrjetin e transmetimit duhet të jetë në gjendje të përballojë.

9.3.2 **OST**-ja i dorëzon pronarit të stabilimentit të kërkesës të kyçur me rrjetin e transmetimit ose operatorit të sistemit të shpërndarjes të kyçur me rrjetin e transmetimit një vlerësim të rrymave

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 59 nga 82</i>

minimale dhe maksimale të lidhjeve të shkurta që janë të pritshme në pikën e kyçjes duke ekuivalentuar rrjetin në pikën e kyçjes.

9.3.3 Pas një ngjarjeje të paplanifikuar, **OST**-ja do të informojë pronarin e stabilimentit të ndikuar të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatorin e sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se një javë pas ngjarjes së paplanifikuar, për ndryshimet e pragut maksimal të rrymës së lidhjes së shkurtër që stabilimenti i ndikuar i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit ose sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit do të jetë në gjendje të përballoj nga ndikimi i rrjetit të **OST**-së në përputhje me paragrafin 9.3.1.

9.3.4 Pragu i përcaktuar në paragrafin 9.3.3 specifikohet nga pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit për stabilimentin e tij ose nga operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit për rrjetin e tij.

9.3.5 Para një ngjarjeje të planifikuar, **OST** e informon pronarin e stabilimentit të prekur të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatorin e sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se një javë përpara ngjarjes së planifikuar, për ndryshimet mbi prahun e rrymës maksimale të lidhjes së shkurtër që stabilimenti i kërkesës i kyçur me rrjetin e transmetimit ose sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit janë në gjendje të përballojnë ndikimet nga rrjeti i **OST**-së, në përputhje me paragrafin 9.3.1.

9.3.6 Pragu i përcaktuar në paragrafin 9.3.5 përcaktohet nga pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit për stabilimentin e tij ose nga operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit për rrjetin e tij.

9.3.7 **OST** kërkon informata nga pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose nga operatori i sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit, lidhur me kontributin e rrymave të lidhjes së shkurtër nga ai stabiliment ose rrjet. Më së paku, të dhënat ekuivalente të rrjetit duhet të dorëzohen dhe dëshmohen për sekuencat zero, pozitive dhe negative.

9.3.8 Pas një ngjarjeje të paplanifikuar, pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit e informon **OST**-në, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se një javë pas ngjarjes së paplanifikuar, për ndryshimet në kontributin e rrymave të lidhjes së shkurtër, mbi prahun e përcaktuar nga **OST**.

9.3.9 Para një ngjarjeje të planifikuar, pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit duhet të informojë **OST**-në, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se një javë para ngjarjes së planifikuar, për ndryshimet në kontributin e rrymave të lidhjes së shkurtër, mbi prahun e përcaktuar nga **OST**-ja.

9.4 Kërkesat për fuqi reaktive

9.4.1 **Stabilimentet e kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit dhe sistemi shpërndarës të kyçur në rrjetin e transmetimit** janë të aftë të mirëmbajnë operimin e tyre në gjendjen e qëndrueshme në pikën e tyre të kyçjes, brenda brezit të fuqisë reaktive të përcaktuar nga **OST**-ja, sipas kushteve të mëposhtme:

- a) Për **stabilimentet e kërkesës së kyçur në rrjetin e transmetimit**, brezi aktual i fuqisë reaktive të përcaktuar nga **OST**-ja për import dhe eksport të fuqisë reaktive nuk është më i gjerë se 48% të kapacitetit maksimal të importit ose kapacitetit maksimal të eksportit (0,9 faktorët e fuqisë,, import ose eksport të fuqisë aktive), përveç në situatat ku janë dëshmuar përfitimet teknike ose financiare të sistemit, për **stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit**,

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 60 nga 82</i>

nga pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit dhe i pranuar nga **OST**-ja;

- b) Për sistemet shpërndarëse të kyçur në rrjetin e transmetimit, brezi aktual i fuqisë reaktive i specifikuar nga **OST**-ja për importin dhe eksportin e fuqisë reaktive nuk duhet të jetë më i gjërë se:
- 48% (p.sh. faktori i fuqisë 0,9) ndaj vlerës maksimale të aftësisë për import dhe eksport gjatë importit të fuqisë reaktive (konsumit); dhe
 - 48% (p.sh. faktori i fuqisë 0,9) ndaj vlerës maksimale të aftësisë për import dhe eksport gjatë eksportit të fuqisë reaktive (prodhimit); Përveç në situata ku përfitimet teknike ose financiare të sistemit janë vërtetuar nga **OST**-ja dhe operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit përmes analizës së përbashkët;
- c) **OST**-ja dhe operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit dakordohen mbi fushëveprimin e analizës, e cila trajton zgjidhjet e mundshme dhe përcakton zgjidhjen optimale për shkëmbimin e fuqisë reaktive midis sistemeve të tyre, duke marrë në konsideratë në mënyrë adekuate karakteristikat specifike të sistemit, strukturën e ndryshueshme të shkëmbimit të energjisë, flukset dy drejtimëshe dhe aftësisë për fuqi reaktive në sistemin e shpërndarjes;
- d) **OST**-ja mund të vendosë për përdorimin e njësive të emëruara përveç faktorit të fuqisë, për të përcaktuar brezin e aftësisë për fuqinë reaktive ekuivalente;
- e) Kërkesat për vlerat e brezit për fuqi reaktive duhet të plotësohen në pikën e kyçjes;
- f) Përjashtimisht kërkesave nga pika (e), kur një pikë e kyçjes ndahet midis modulit gjenerues dhe stabilimentit të kërkesës, kërkesat e njejta do të përmbushen në pikën e përcaktuar në marrëveshjen e kyçjes ose në ligjin kombëtar.

9.4.2 Pa paragjykuar pikën (b) të paragrafit 9.4.1, **OST**-ja mund të kërkojë që sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit të rregullojë në mënyrë aktive shkëmbimin e fuqisë reaktive në pikën e kyçjes për të mirën e gjithë sistemit. **OST**-ja dhe operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit bien dakord mbi metodën për të kryer këtë rregullim, për të siguruar nivelin e justifikuar të sigurisë së furnizimit për të dyja palët. Arsyetimi përfshin një udhërrëfyes, në të cilin përcaktohen hapat dhe afatet kohore për përmbushjen e kërkesës.

9.4.3 Në pajtim me paragrafin 9.4.2 operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit mund të kërkojë që **OST**-ja të marrë në konsideratë sistemin e shpërndarjes për menaxhimin e fuqisë reaktive.

9.5 Shkyçja e dhe rikyçja e kërkesës

9.5.1 Të gjitha **stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit dhe sistemet e shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit** duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme lidhur me aftësitë funksionale për shkyçje të kërkesës në nën-frekuencë:

- a) operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit dhe kur përcaktohet nga **OST**-ja, pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, duhet të jetë i aftë që të sigurojë shkyçjen automatike në nën-frekuencë të një pjese të specifikuar të ngarkesës së tyre;

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 61 nga 82</i>

- b) funksionet e shkyçjes së ngarkesës në nën-frekuencë duhet të lejojnë shkyçjen e ngarkesës në shkallë për brezin e frekuencave operacionale;
- c) funksionet e shkyçjes së ngarkesës me nën-frekuencë duhet të lejojnë operim nga rryma alternative hyrëse nominale (AC) dhe plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
- brezi i frekuencës nga 49.0 në 48.0 Hz;
 - Sasia e ngarkesës që korrespondon me 8% të ngarkesës totale shkyçet në 49.0 Hz;
 - Në total, sasia e ngarkesës që korrespondon me 48% të ngarkesës totale shkyçet mes 49.0 dhe 48.0 Hz;
 - Numri i shkallëve të shkyçjes është 6 (duke përfshirë shkallën e inicuar në 49.0 Hz);
 - Për çdo shkallë, sasia e ngarkesës që korrespondon me 8% të ngarkesës totale shkyçet;
 - Funkzioni shtesë df/dt në reletë nën-frekuente lejohet në intervalin 49.8 – 49.0 Hz;
 - Asnjë vonesë e qëllimshme nuk duhet të caktohet në reletë nën-frekuente;
 - Vonesa kohore maksimale e shkyçjes është 150 ms duke përfshirë kohën e operimit të ndërprerësve.
- d) shkyçja nga nën tensioni: aktivizimi i këtij funksioni është i mundur kur tensioni është brenda brezit prej 30 deri 90% të vlerës 1 pu ndaj tensionit referent;
- e) siguron drejtim të rrjedhës së fuqisë aktive në pikën e shkyçjes.

9.5.2 Në lidhje me mundësinë funksionale të shkyçjes së kërkesës nga nën-tensioni, duhet të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) **OST** në koordinim me **operatorin e sistemit të shpërndarjes** të kyçur në rrjetin e transmetimit, mund të specifikojë mundësinë funksionale të shkyçjes së kërkesës nga nën-tensioni për stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit;
- b) **OST**-ja mund të specifikojë, në koordinim me pronarët e stabilimenteve të ngarkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, aftësitë funksionale të shkyçjes së ngarkesës nga nën-tensioni për pajisjet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit;
- c) bazuar në vlerësimin e **OST**-së në lidhje me sigurinë e sistemit, mund të zbatohet bllokimi i rregullatorëve të tensionit nën ngarkesë dhe i shkyçjes së ngarkesës nga nën-tensioni. Në rastet kur transformatorët janë në pronësi të pronarit të stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, me kërkesë të **OST**-së zbatimi i bllokimit të rregullatorit të tensionit është obligativ nga pronari i stabilimentit të kërkesës;
- d) nëse **OST** vendos të zbatojë aftësinë funksionale të shkyçjes së ngarkesës nga nën-tensioni, pajisjet për bllokimin e rregullatorëve të tensionit në ngarkesë dhe për shkyçjen e ngarkesës nga nën-tensioni duhet të instalohen në koordinim ndërmjet **OST**-së dhe **OSSH**-së;
- e) metoda e shkyçjes së ngarkesës për nën-tension, zbatohet me anë të rele së ose inicimit nga qendra dispeçerike;
- f) aftësitë funksionale të releve për shkyçjen e ngarkesës nga nën-tensioni kanë karakteristikat e mëposhtme:
- monitoron tensionin duke matur të tri fazat;
 - bllokimi i operimit të releve bazohet në kahun e rrjedhës së fuqisë aktive ose reaktive.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 62 nga 82</i>

9.5.3 Lidhur me bllokimin e rregullatorëve të tensionit nën ngarkesë, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- a) transformatorët në pikën e kyçjes në mes të **OST** dhe **OSSH**, **OST** dhe pronarëve të stabilimenteve të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, duhet të jenë në gjendje të bllokojnë në mënyrë automatike ose manuale rregullatorin e tensionit nën ngarkesë;
- b) **OST**-ja e përcakton aftësinë funksionale automatike të bllokimit të rregullatorëve të tensionit nën ngarkesë.
- c) Të gjitha stabilimentet e kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit dhe sistemet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit plotësojnë kërkesat e mëposhtme lidhur me shkyçjen ose rikyçjen e stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose një sistem shpërndarjeje të kyçur në rrjetin e transmetimit:
 - në lidhje me aftësinë e rikyçjes pas shkyçjes, **OST**-ja specifikon kushtet në të cilat **stabilimenti i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit** ose **sistemi shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit**, ka të drejtë të ri-kyçet në sistemin e transmetimit. Instalimi i sistemeve të ri-kyçjes automatike i nënshtrohet autorizimit paraprak nga **OST**;
 - në lidhje me rikyçjen e **stabilimenteve të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit** ose **sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit**, stabilimenti i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit ose sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit duhet të jenë të aftë për sinkronizim për frekuenca brenda brezit të paraqitur në tabelën 1, paragrafi 8.1.1 i këtij Kodi. **OST** dhe pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit dakordohen mbi parametrat e pajisjeve të sinkronizimit para kyçjes së stabilimenteve të kërkesës së kyçur në rrjetin e transmetimit ose sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit, përfshirë tensionin, frekuencën, brezin e çfazimit të fazës dhe devijimin e tensionit dhe frekuencës;
 - **stabilimenti i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit** ose **stabilimenti i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit** duhet të jenë të aftë të shkyçen nga sistemi i transmetimit nga distanca kur kjo kërkohet nga **OST**. Nëse kërkohet, **OST** përcakton rikonfigurimin e sistemit të pajisjes automatike të shkyçjes në fazën e përgatitjes për ri-kyçjen e ngarkesës në blloqe. **OST** e specifikon kohën e nevojshme për shkyçje nga distanca.

9.6 Modelet e simulimit të stabilimenteve të ngarkesës

9.6.1 **Stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit dhe sistemet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit** plotësojnë kërkesat e përcaktuara në paragrafët 9.6.3 dhe 9.6.4 në relacion me modelet e simulimit ose informacionet ekuivalente.

9.6.2 **OST** për gjendjen e qëndrueshme dhe dinamike, mund të kërkojë modele simulimi ose informacione ekuivalente që tregojnë sjelljen e stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose sistemin e shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit.

9.6.3 **OST** specifikon përmbajtjen dhe formatin e atyre modeleve të simulimit ose informacioneve ekuivalente. Përmbajtja dhe formati përfshijnë:

- a) Gjendjen e qëndrueshme dhe dinamike, duke përfshirë komponentën 50 Hz;
- b) simulimet kalimtare elektromagnetike në pikën e kyçjes;
- c) diagramet e strukturës dhe bllok diagramet.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 63 nga 82</i>

9.6.4 Për qëllim të simulimeve dinamike, modeli i simulimit ose informacioni ekuivalent i përmendur në paragrafin 9.6.3 pika a) përmban nën-modelet ose informacionet ekuivalente të mëposhtme:

- a) kontrollin e fuqisë;
- b) kontrollin e tensionit;
- c) **stabilimentet e kërkesës së kyçur në rrjetin e transmetimit** dhe modelet e mbrojtjes së **sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit**;
- d) llojet e ndryshme të ngarkesës, përkatësisht karakteristikat elektroteknike të ngarkesës; dhe
- e) modelet e konvertorit.

9.6.5 **OST**-ja specifikon kërkesat për regjistrimin e performancës së stabilimenteve të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit ose të stabilimenteve të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit, ose për të dyja, për të krahasuar reagimin e modelit me këto regjistrime.

9.7 Procedura e njoftimit për operim për kyçjen e shfrytëzuesve të kërkesës

9.7.1 Dispozitat e përgjithshme

9.7.1.1 Procedura e njoftimit për operim për kyçjen e çdo stabilimenti të ri të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit dhe çdo stabiliment i ri i sistemit të shpërndarjes i kyçur me rrjetin e transmetimit, përfshin:

- a) **njoftimi për operim gjatë energjizimit ('NOE');**
- b) **njoftimi për operim të përkohshëm ('NOP');** dhe
- c) **njoftimi për operim final ('NOF').**

9.7.1.2 Çdo pronar i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit, në të cilin aplikohet një ose më shumë nga kërkesat e kapitullit 9, i demonstrojnë **OST**-së se është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kapitullin 9 të këtij Kodi, duke plotësuar me sukses procedurën e njoftimit për operim për kyçjen e çdo stabilimenti të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit dhe çdo sistem i shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit e përshkruar në paragrafët 9.7.2 deri 9.7.5.

9.7.1.3 **OST** specifikon dhe publikon detaje të mëtejshme në lidhje me procedurën e njoftimit për operim.

9.7.2 Njoftimi për operim gjatë energjizimit për shfrytëzuesit e kërkesës

9.7.2.1 Një **NOE** i jep të drejtë pronarit të stabilimenteve të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit që të energjizojë rrjetin e tij të brendshëm dhe shpenzimet vetanake duke përdorur kyçjen e rrjetit që është specifikuar për pikën e kyçjes.

9.7.2.2 Një **NOE** do të lëshohet nga **OST**, në varësi të përfundimit të përgatitjeve, duke përfshirë marrëveshjen për tarimin e mbrojtjeve dhe kontrollit që kanë të bëjnë me pikën e kyçjes ndërmjet **OST** dhe pronarit të stabilimenteve të kërkesës së kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatorit të sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit.

9.7.3 Njoftimi për operim të përkohshëm për shfrytëzuesit e kërkesës

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 64 nga 82</i>

9.7.3.1 Një **NOP** i jep të drejtë pronarit të stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatorit të sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit të operojë me sistemin e shpërndarjes së kyçur në rrjetin e transmetimit, ose me sistemin e shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit duke përdorur kyçjen e rrjetit për një periudhë të kufizuar kohore.

9.7.3.2 Një **NOP** lëshohet nga **OST**, pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të të dhënave dhe studimit siç kërkohet nga paragrafi 9.7.3.3.

9.7.3.3 Sa i përket shqyrtimit të të dhënave dhe studimit, **OST**-ja do të ketë të drejtë të kërkojë që pronari i stabilimentit të kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit të sigurojë:

- a) deklaratën e detajuar të pajtueshmërisë;
- b) të dhëna të hollësishme teknike të stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit ose sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit që është me rëndësi për kyçjen në rrjet siç specifikohet nga **OST**;
- c) certifikatat e pajisjeve të lëshuara nga një certifikues i autorizuar për stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit, pajisjet shpërndarëse të kyçura në rrjetin e transmetimit dhe sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit, ku ato mbështeten si pjesë e dëshmive të pajtueshmërisë;
- d) modelet e simulimit, siç përcaktohen në paragrafin 9.6 dhe siç kërkohen nga **OST**;
- e) studimet që dëshmojnë performancën e pritshme të gjendjes së qëndrueshme dhe dinamike siç kërkohet në paragrafët 9.11.2, 9.12.1 dhe 9.12.2;
- f) detajet e testeve të synuara të pajtueshmërisë në përputhje me paragrafin 9.10.

9.7.3.4 Periudha maksimale gjatë së cilës pronari i stabilimentit të kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit mund të mbajë statusin e **NOP** do të jetë 24 muaj. **OST** ka të drejtë të specifikojë një periudhë më të shkurtër të vlefshmërisë **NOP**. Zgjatja e vlefshmërisë **NOP** jepet vetëm nëse pronari i stabilimentit të kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit ka shënuar progres thelbësor drejt përbushjes së plotë. Çështjet e pazgjidhura duhet të identifikohen qartë në kohën e kërkesës për zgjatje të periudhës.

9.7.3.5 Një zgjatje e periudhës gjatë së cilës pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit mund të mbajë statusin **NOP**, përtej periudhës së përcaktuar në paragrafin 9.7.3.4, mund të jepet vetëm nëse bëhet një kërkesë për derogim tek **OST** para skadimit të asaj periudhe, në përputhje me procedurën e derogimit të përcaktuar në kapitullin 10 të këtij Kodi.

9.7.4 Njoftimi për operim final për shfrytëzuesit e kërkesës

9.7.4.1 Një **NOF** i jep të drejtë pronarit të stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatorit të sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit që të operojë me **stabilimentin e kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit**, ose sistemin e shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit duke përdorur kyçjen në rrjet.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 65 nga 82</i>

9.7.4.2 Një **NOF** lëshohet nga **OST**, pasi eliminimit paraprak të të gjitha mos-pajtueshmërive të identifikuar gjatë statusit **NOF** dhe në varësi të përfundimit të procesit të shqyrtimit të të dhënave dhe studimit, siç kërkohet në paragrafin 9.7.4.

9.7.4.3 Për qëllim të shqyrtimit të të dhënave dhe studimit, pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit duhet të dorëzojë në **OST**:

- a) një deklaratë të detajuar të pajtueshmërisë; dhe
- b) një përditësim të të dhënave teknike të zbatueshme, modeleve të simulimit dhe studimeve të përmendura në pikat b), d) dhe e) të paragrafit 9.7.3.3, duke përfshirë përdorimin e vlerave aktuale të matura gjatë testimit

9.7.4.4 Nëse identifikohet mos-pajtueshmëria në lidhje me lëshimin e **NOF**, atëherë mund të jepet një derogim me kërkesë të bërë në **OST**, në përputhje me procedurën e derogimit të përshkruar në kapitullin 10 të këtij Kodi. **OST**-ja do të lëshoj një **NOF** nëse **stabilimenti i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit**, ose **sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit**, i përmbush dispozitat e derogimit.

9.7.4.5 Kur refuzohet kërkesa për derogim, **OST** ka të drejtë të refuzoj lejin e operimit të stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose sistemin e shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit derisa pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit dhe **OST**-ja të zgjidhin mos-pajtueshmërinë dhe **OST** të konsiderojë se stabilimenti i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit, ose sistemi i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit të jenë në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.

9.7.4.6 Nëse **OST** dhe pronari i stabilimenteve të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit nuk e zgjidhin mos-pajtueshmërinë brenda një periudhe të arsyeshme kohore, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas njoftimit të refuzimit të kërkesës për derogim, secila palë mund t'ia adresojë çështjen për vendim autoritetit rregullativ.

9.7.5 Njoftim për operim të kufizuar për shfrytëzuesit e rinjë të kërkesës

9.7.5.1 Pronarët e stabilimenteve të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatorët e sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit të cilëve u është dhënë një **NOF**, duhet të informojë **OST**-në, jo më vonë se 24 orë pas ndodhjes së incidentit, mbi rrethanat vijuese:

- a) Stabilimenti është përkohësisht subjekt i modifikimeve të konsiderueshme ose humbjes së aftësisë që ndikon në performancën e tij; ose
- b) dështimi i pajisjeve që çon në mos-pajtueshmëri me disa kërkesa relevante.
- c) Një periudhë më e gjatë kohore për të informuar **OST**-në mund të dakordohet me pronarin e stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose me operatorin e sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit varësisht nga natyra e ndryshimeve.

9.7.5.2 Pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit do të aplikojë për një **NOK**, nëse pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit presin që rrethanat e përshkruara në paragrafin 1 të vazhdojnë për më shumë se tre muaj.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 66 nga 82</i>

9.7.5.3 Një **NOK** lëshohet nga **OST** dhe do të përmbajë informacionet e mëposhtme të cilat duhet të jenë qartë të identifikueshme:

- a) çështjet e pazgjidhura që justifikojnë dhënien e **NOK**;
- b) përgjegjësitë dhe afatet kohore për zgjidhjen e pritshme; dhe
- c) një periudhë maksimale të vlefshmërisë e cila nuk do të kalojë 12 muaj. Periudha fillestare e dhënë mund të jetë më e shkurtër me mundësi të zgjatjes nëse paraqiten dëshmi për pajtueshmërinë e **OST** që tregojnë se është bërë progres thelbësor drejt arritjes së pajtueshmërisë së plotë.

9.7.5.4 **NOF** duhet të pezullohet gjatë periudhës së vlefshmërisë së **NOK** në lidhje me çështjet për të cilat është lëshuar **NOK**.

9.7.5.5 Një zgjatje e mëtejshme e periudhës së vlefshmërisë **NOK** mund të jepet me një kërkesë për derogim të bërë në **OST** para skadimit të asaj periudhe, në përputhje me procedurën e derogimit të përshkruar në kapitullin 10.

9.7.5.6 **OST** ka të drejtë të refuzojë lejimin e operimit të stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatorit të sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit, pasi **NOK** nuk është i vlefshëm. Në raste të tilla, **NOF** automatikisht bëhet i pa vlefshëm.

9.7.5.7 Nëse **OST** nuk lejon zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së **NOK** në përputhje me paragrafin 9.7.5.5 ose nëse refuzon lejimin e operimit të stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatorit të sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit pasi **NOK** nuk është i vlefshëm sikurse në paragrafin 9.7.5.6, pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit mund ta adresojë çështjen për vendim tek autoriteti rregullativ brenda gjashtë muajve pas njoftimit për vendimin e **OST**.

9.8 Kyçja e njësive të kërkesës të shfrytëzuara nga stabilimenti i kërkesës për të siguruar shërbime të reagimit të kërkesës për OST


9.8.1 Dispozitat e përgjithshme

9.8.1.1 Shërbimet e reagimit të kërkesës të ofruara për **operatorin e sistemit** duhet të dallohen në bazë të kategorive të mëposhtme:

- a) të kontrolluara nga distanca:
 - rregullimi i fuqisë aktive përmes reagimit të kërkesës;
 - rregullimi i fuqisë reaktive përmes reagimit të kërkesës;
 - menaxhimi i kufizimeve në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës.
- b) të kontrolluara në mënyrë autonome:
 - rregullimi i frekuencës së sistemit përmes reagimit të kërkesës;
 - rregullimi i shpejtë i fuqisë aktive përmes reagimit të kërkesës.

9.8.1.2 Stabilimentet e kërkesës mund të ofrojnë shërbime të reagimit të kërkesës për **OST**. Shërbimet përmes reagimit të kërkesës mund të përfshijnë, bashkërisht ose ndaras, modifikimin e zvogëlimit apo ngritjes së kërkesës.

9.8.1.3 Kategoritë e përmendura në paragrafin 9.8.1.1 nuk janë ekskluzive dhe ky Kod nuk pengon zhvillimin e kategorive të tjera. Ky Kod nuk zbatohet për shërbimet e reagimit të kërkesës për subjektet tjera përveç **OST**.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 67 nga 82</i>

9.8.2 Dispozita të veçanta për njësitë e kërkesës për rregullimin e fuqisë aktive, fuqisë reaktive dhe menaxhimin e kufizimit në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës

9.8.2.1 Stabilimentet e kërkesës mund t'i ofrojnë **OST**-së rregullimin e fuqisë aktive, fuqisë reaktive dhe menaxhimin e kufizimit në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës.

9.8.2.2 Njësitë e kërkesës për rregullimin e fuqisë aktive, fuqisë reaktive dhe menaxhimin e kufizimit në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme, ose individualisht ose kur ajo nuk është pjesë e stabilimenteve të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, kolektivisht, si pjesë e bashkimit të ngarkesave nëpërmjet një pale të tretë:

- a) të jenë në gjendje të operojnë në të gjithë brezin e frekuencave të specifikuara në paragrafin 9.1.1 dhe në brezin e zgjeruar të specifikuar në paragrafin 9.1.2;
- b) të jenë në gjendje të operojnë për brezin e tensionit të specifikuar në paragrafin 9.2.3 nëse janë të kyçur në nivelin e tensionit 110 kV ose më lartë;
- c) të jetë në gjendje të operojë në tërë brezin e tensionit normal operativ të sistemit në pikën e kyçjes, të përcaktuar nga **OST**, nëse janë të kyçur në nivelin e tensionit nën 110 kV. Ky brez do të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e Kodit të Shpërndarjes;
- d) Të jetë në gjendje të kontrollojë konsumin e fuqisë nga rrjeti në volumin të njejtë me atë të kontraktuar, direkt ose indirekt nëpërmjet një pale të tretë, nga **OST**;
- e) të pajisen për të pranuar instruksione, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet një pale të tretë, nga **OST** për të modifikuar kërkesën e tyre dhe për të transferuar informacionet e nevojshme. **OST** duhet të beje publike specifikimet teknike të miratuara për të mundësuar këtë transferim të informatave. Për njësitë kërkesës të kyçura në nivel të tensionit me te vogel se 110 kV, këto specifikime duhet që para aprovimit nga autoriteti rregullativ, të jenë subjekt i konsultimeve me palët e interesuara përkatëse;
- f) të jetë në gjendje të modifikojë konsumin e fuqisë së tij brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga **OST**. Për njësitë kërkesës të kyçura në një nivel të tensionit me te vogel se 110 kV, këto specifikime duhet që para aprovimit nga autoriteti rregullativ, të jenë subjekt i konsultimeve me palët e interesuara përkatëse;
- g) të jetë në gjendje për ekzekutim të plotë të instruksioneve të lëshuar nga **OST** për të modifikuar konsumin e fuqisë së tij pa kaluar limitet e mbrojtjes dhe sigurisë elektrike, përveç nëse ekziston një metodë e pranuar me kontratë me **OST** për zëvendësimin e kontributeve të tyre (duke përfshirë kontributin e stabilimenteve të ngarkesave të grumbulluara përmes një pale të tretë);
- h) kur ndodh një modifikim në konsumin e fuqisë dhe për kohëzgjatjen e modifikimit të kërkuar, modifikohet vetëm kërkesa e cila shfrytëzohet për të ofruar shërbimin nëse kërkohet nga **OST** në kufijtë e masave të sigurisë dhe mbrojtjes, përveç nëse ekziston një metodë e dakorduar me kontratë me **OST** për zëvendësimin e kontributit të tyre (duke përfshirë kontributin e stabilimenteve të ngarkesave të grumbulluara përmes një pale të tretë). Udhëzimet për të modifikuar konsumin e fuqisë mund të kenë efekte të menjëhershme ose me vonesë;
- i) të njoftojë **OST** për modifikimin e kapacitetit të reagimit të kërkesës. **OST** specifikon mënyrat e njoftimit;
- j) kur **OST**, direkt ose indirekt përmes një pale të tretë, komandon modifikimin e konsumit të fuqisë, mundëson modifikimin e një pjese të kërkesës së saj si reagim ndaj instruksioneve nga

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 68 nga 82</i>

OST, brenda kufijve të rënë dakord me pronarin e stabilimentit të kërkesës dhe sipas parametrave të njësisë së kërkesës;

- k) të jetë e aftë dhe e qëndrueshme për të mos u shkyçur nga sistemi për shkak të ndryshimit shkallë të frekuencës deri në vlerën e specifikuar nga **OST**. Lidhur me këtë aftësi të qëndrueshmërisë, vlera e shkallës së ndryshimit të frekuencës duhet të llogaritet në brezin kohor prej 500 ms. Për njësitë e kërkesës të kyçura nën nivelin e tensionit 110 kV, këto specifikime para miratimit nga Autoriteti Rregullativ, duhet të jenë subjekt i konsultimeve me palët e interesit.
- l) kur modifikimi i konsumit të fuqisë përcaktohet përmes kontrollit të frekuencës ose tensionit, ose të djave, dhe përmes sinjalit të paralajmërimit të dërguar nga **OST**, duhet të pajisen për të pranuar, direkt ose indirekt përmes një pale të tretë, instruksionet nga **OST**, për të matur frekuencën ose vlerën e tensionit, ose të dyjat, për të komanduar shkyçjen e kërkesës dhe për të shkëmbyer informatat. **OST** specifikon dhe publikon specifikimet teknike të miratuara për të mundësuar këtë shkëmbim të informatave. Për njësitë e kërkesës të kyçura nën nivelin e tensionit 110 kV, këto specifikime, para miratimit nga Autoriteti Rregullativ, duhet të jenë subjekt i konsultimeve me palët e interesit.

9.8.2.3 Për kontrollin e tensionit me shkyçje ose ri-kyçje të stabilimenteve statike të kompensimit, çdo stabiliment i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit duhet të jetë në gjendje të kyçë ose shkyçë stabilimentet e kompensimit statik, direkt ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë të përbashkët si pjesë e ngarkesave të grumbulluara nëpërmjet një pale të tretë, në reagim nga instruksionet e dërguara nga **OST**, ose në kushtet e përcaktuara më herët me kontratën në mes **OST** dhe pronarit të stabilimenteve të kërkesës.

9.8.3 Dispozita të veçanta për njësitë e kërkesës për rregullimin e frekuencës së sistemit përmes reagimit të kërkesës

9.8.3.1 Stabilimentet e kërkesës mund të ofrojnë për **OST** rregullim të frekuencës së sistemit përmes reagimit të kërkesës.

9.8.3.2 **Njësitë e kërkesës** për rregullim të frekuencës së sistemit përmes reagimit të kërkesës do të përmbushin kërkesat e mëposhtme, ose individualisht, ose kur nuk janë pjesë e **stabilimenteve të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit**, kolektivisht si pjesë e ngarkesave të grumbulluara përmes një pale të tretë:

- a) të jetë në gjendje të operojë në tërë brezin e frekuencave të specifikuar në paragrafin 9.1.1 dhe në brezin e zgjeruar të specifikuar në paragrafin 9.1.2;
- b) të jenë në gjendje të operojnë në tërë brezin e tensionit të specifikuar në paragrafin 9.2.3 nëse janë të kyçur në nivelin e tensionit 110 kV ose më lartë;
- c) të jetë në gjendje të operojnë përgjatë tërë brezit të tensioneve normale të operimit të sistemit në pikën e kyçjes, të specifikuar nga **OST**, nëse kyçet nën nivelin e tensionit 110 kV. Ky brez duhet të jetë sipas standardeve ekzistuese dhe para miratimit nga Autoriteti Rregullativ, duhet të jetë subjekt i konsultimeve me palët e interesit;
- d) të pajiset me një sistem rregullimi i cili është i pandjeshëm në zonën e vdekur afër vlerës nominale 50,00 Hz të frekuencës së sistemit, me brez që specifikohet nga **OST** në konsultim me **OST**-të në zonën sinkrone. Për njësitë e kërkesës të kyçura nën nivelin e tensionit 110 kV, këto specifikime, para miratimit nga Autoriteti Rregullativ, duhet të jenë subjekt i konsultimeve me palët e interesit;

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 69 nga 82</i>

- e) të jetë i aftë që pas kthimit të frekuencës brenda brezit të vdekur të specifikuar të përcaktuar në pikën (d) të paragrafit 9.8.3.2, të inicioj një vonesë të rastësishme deri në 5 minuta para se të rifillojë operimi normal. Reagimi në devijimin maksimal të frekuencës nga vlera nominale prej 50,00 Hz do të përcaktohet nga **OST** në koordinim me **OST**-të në zonën sinkrone. Për njësitë e kërkesës të kyçura nën nivelin e tensionit 110 kV, këto specifikime, para aprovimit nga Autoriteti Rregullativ, do të jenë subjekt i konsultimeve me palët relevante të interesit. Kërkesa do të rritet ose zvogëlohet për frekuencat e sistemit mbi ose nën zonën e vdekur, respektivisht për frekuencën nominale (50,00 Hz);
- f) të jetë e pajisur me një rregullator që mat frekuencën aktuale të sistemit. Matjet duhet të përditësohen të paktën çdo 0,2 sekonda;
- g) të jetë në gjendje të detektojë ndryshimet prej 0,01 Hz të frekuencës së sistemit, në mënyrë që të jepë një reagim linear proporcional të sistemit, në lidhje me sensitivitetin dhe saktësinë e matjes së frekuencës për rregullimin e frekuencës përmes reagimit të kërkesës. Njësia e kërkesës duhet të jetë e aftë për detektim dhe reagim të shpejtë ndaj ndryshimeve të frekuencës së sistemit, që duhet të përcaktohet nga **OST** në koordinim me **OST**-të në zonën sinkrone. Kompensimi (ri-vendosje) i frekuencës gjatë matjes në gjendjen stacionare duhet të jetë i pranueshëm deri në 0,05 Hz.

9.8.4 Dispozita të veçanta për njësitë e kërkesës për reagim shumë të shpejtë në rregullimin e fuqisë aktive përmes reagimit të kërkesës

9.8.4.1 **OST** mund të pajtohet me pronarin e stabilimentit të kërkesës (duke përfshirë, por jo i kufizuar përmes një pale të tretë) për kontratë për ofrim të rregullimit të shpejtë të fuqisë aktive përmes reagimit të kërkesës.

9.8.4.2 Në qoftë se bëhet marrëveshja e përmendur në paragrafin 9.8.4.1, kontrata e përmendur në paragrafin 9.8.4.1 duhet të specifikojë:

- a) ndryshimi i fuqisë aktive në relacion me matjen siç është shkalla e ndryshimit të frekuencës për atë pjesë të kërkesës së tij;
- b) parimet e operimit të këtij sistemi të rregullimit dhe parametrat e performancës së sistemit;
- c) kohën e reagimit për rregullimin shumë të shpejtë të fuqisë aktive, nuk duhet të jetë më e gjatë se 2 sekonda.

9.8.5 Procedura e njoftimit për operim për njësitë e kërkesës me reagim të kërkesës

9.8.5.1 Procedura e njoftimit për operim për njësitë e kërkesës të përdorura nga stabilimentet e kërkesës për ti siguruar **OST**-së reagimin e kërkesës do të dallohen për:

- a) njësitë e kërkesës brenda një stabilimenti të kërkesës të kyçura në nivelin e tensionit 1 kV ose më të ulët;
- b) njësitë e kërkesës brenda një stabilimenti të kërkesës të kyçura mbi nivelin e tensionit 1 kV;

9.8.5.2 Çdo pronar i stabilimentit të kërkesës, që ofron **OST**-së reagimin e kërkesës, do t'i konfirmojë **OST**-së, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet një pale të tretë, aftësinë e tij për të përmbushur dizajnin teknik dhe kërkesat e operimit siç referohet në paragrafin 9.8 të këtij Kodi.

9.8.5.3 Pronari i stabilimentit të kërkesës duhet të njoftojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet një pale të tretë, **OST**-në, para çdo vendimi për të ndërprerë ofrimin e shërbimeve për reagimin e kërkesës dhe / ose për largimin e përhershëm të njësisë së kërkesës me aftësi në reagim të kërkesës. Ky informacion mund të sistemohet ashtu siç përcaktohet nga **OST**.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 70 nga 82</i>

9.8.5.4 **OST** do të specifikojë dhe do të vë në dispozicion publik detaje të mëtejshme në lidhje me procedurën e njoftimit për operim.

9.8.5.5 Procedura e njoftimit për operim për njësinë e kërkesës për stabilimentet e kërkesës të kyçur në nivelin e tensionit 1 kV ose më ulët duhet të përfshijë dokumentin e instalimit.

9.8.5.6 Shablloni i dokumentit të instalimit duhet të sigurohet nga **OST**, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet një pale të tretë.

9.8.5.7 Bazuar në dokumentin e instalimit, pronari i stabilimentit të kërkesës duhet të dërgojë informacionin, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet një pale të tretë tek **OST**. Data e paraqitjes duhet të jetë para ofrimit në treg të kapacitetit të reagimit të kërkesës nga njësia e kërkesës. Kushtet e përcaktuara në dokumentin e instalimit duhet të bëjnë dallimin në mes llojeve të ndryshme të kyçjeve dhe në mes kategorive të ndryshme të shërbimeve të reagimit të kërkesës.

9.8.5.8 Për njësitë pasuese të kërkesës me reagim të kërkesës duhet të sigurohen dokumentet e ndara të instalimit.)

9.8.5.9 Përmbajtja e dokumentacionit të instalimit të njësive individuale të kërkesës mund të sistemohet nga ana e **OST**.

9.8.5.10 Dokumentacioni i instalimit përmban pikat e më poshtme:

- a) Lokacionin në të cilën njësia e kërkesës me reagim të kërkesës është e kyçur në rrjet;
- b) kapacitetin maksimal të instalimit të reagimit të kërkesës në kW;
- c) llojin e shërbimit të reagimit të kërkesës;
- d) certifikatën e njësisë së kërkesës dhe certifikatën e pajisjes sipas nevojës për shërbimin e reagimit të kërkesës, apo nëse nuk është në dispozicion, informacionet përkatëse;
- e) detajet e kontaktit të pronarit të stabilimentit të kërkesës, ose të palës së tretë duke bashkuar njësitë e kërkesës nga stabilimenti i kërkesës.

9.8.5.11 Procedura e njoftimit për operim për njësinë e kërkesës brenda stabilimentit të kërkesës të kyçur në nivelin e tensionit mbi 1 kV duhet të përfshijë **dokumentacionin e njësisë së reagimit të kërkesës (DNRK)**. **OST** specifikon përmbajtjen e kërkuar për **DNRK**. Përmbajtja e **DNRK** kërkon deklaratën e pajtueshmërisë e cila përmban informacionet në paragrafët prej 9.10 deri 9.12 për stabilimentin e kërkesës, por kërkesat e pajtueshmërisë në paragrafët prej 9.10 deri 9.12 për stabilimentet e kërkesës mund të thjeshtohen në një fazë të njoftimit për operim, si dhe mund të reduktohet. Pronari i stabilimentit të kërkesës duhet të sigurojë informacionet e kërkuara dhe t'ia dorëzojë **OST**-së. Njësitë pasuese të kërkesës me aftësi në reagim të kërkesës ofrojnë **DNRK**-e të veçanta.

9.8.5.12 Bazuar në **DNRK**, **OST** lëshon një **NOF** pronarit të stabilimentit të kërkesës.

9.9 Pajtueshmëria e stabilimenteve të kërkesës

9.9.1 Përgjegjësia e pronarit të stabilimentit të kërkesës dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes

9.9.1.1 Pronarët e stabilimenteve të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit dhe **OSSH** sigurohen që **stabilimentet e tyre të kërkesave të kyçura në rrjetin e transmetimit**, sistemet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit të jenë në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë Kod.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 71 nga 82</i>

9.9.1.2 Kur kushtet e këtij Kodi janë të zbatueshme për njësitë e kërkesës të përdorura nga stabilimenti i kërkesës për të ofruar për **OST** shërbime të reagimit të kërkesës, pronari i stabilimentit të kërkesës mund t'i delegojë detyra, tërësisht ose pjesërisht, palëve të treta siç janë komunikimi me **OST**-në dhe mbledhja e dokumentacionit nga pronari i stabilimentit të kërkesës, nga **OSSH** që dëshmon pajtueshmërinë.

9.9.1.3 Palët e treta duhet të trajtohen si përdorues të vetëm me të drejtë të përpilojnë dokumentacionin përkatës dhe të dëshmojnë pajtueshmërinë e stabilimenteve të tyre të kërkesës të grumbulluara, me dispozitat e këtij Kodi. Stabilimentet e kërkesës që ofrojnë për **OST**-në shërbimet e reagimit të kërkesës mund të veprojnë kolektivisht përmes palëve të treta.

9.9.1.4 Kur detyrimet janë përmbushur nëpërmjet palëve të treta, palëve të treta vetëm do t'iu kërkohet të njoftojnë **OST**-në për ndryshimet e shërbimeve totale të ofruara, duke marrë parasysh shërbimet specifike të lokacionit.

9.9.1.5 Kur kushtet janë specifike nga **OST**, ose kur janë për qëllime të operimit të sistemit të **OST**, testet alternative ose kushtet për pranimin e rezultatit të testit për këto kushte mund të dakordohen me **OST**.

9.9.1.6 Çdo qëllim për të modifikuar kapacitetet teknike të **stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit**, të **sistemit të shpërndarjes** ose të **njesisë së kërkesës**, që ka ndikim në përmbushjen e kushteve të parashikuara në paragrafët nga 9.10 deri 9.12, duhet të njoftojë **OST**-në, direkt ose indirekt përmes një pale të tretë, para se të vazhdojë me modifikimin e tillë, brenda kornizës kohore të përcaktuar nga **OST**.

9.9.1.7 Çdo incident gjatë operimit ose dështim i **stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit**, të **sistemit të shpërndarjes** ose të **njesisë së kërkesës**, të cilat ndikojnë në përmbushjen e kushteve të parashikuara në paragrafët nga 9.10 deri 9.12, duhet të njoftojë **OST**-në, direkt apo indirekt përmes një pale të tretë, sa më shpejt që të jetë e mundur pas ndodhjes së një incidenti të tillë.

9.9.1.8 Çdo orar i planifikuar i testimit dhe procedurat për të verifikuar pajtueshmërinë e **stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit**, të **sistemit të shpërndarjes** ose të **njesisë së kërkesës**, me kushtet e këtij Kodi duhet të njoftojë **OST**-në brenda afatit kohor të përcaktuar nga **OST**.

9.9.1.9 **OST** mund të marrë pjesë në këto testime dhe mund të regjistrojë performancën e stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, e sistemit të shpërndarjes dhe njesisë e kërkesës.

9.9.2 Detyrat e OST

9.9.2.1 **OST** vlerëson pajtueshmërinë e stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, të stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit, të sistemit të shpërndarjes ose të njesisë së kërkesës, me kushtet e këtij Kodi gjatë gjithë jetëgjatësisë së stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, ose të njesisë së kërkesës. Pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** informohet për rezultatit e këtij vlerësimi.

9.9.2.2 Pajtueshmëria e njesisë së kërkesës të përdorur nga stabilimenti i kërkesës për të siguruar për **OST** shërbimet e reagimit të kërkesës, do të vlerësohet bashkërisht nga **OST** dhe nëse është e zbatueshme, në koordinim me palën e tretë të përfshirë në grumbullimin e kërkesës.

9.9.2.3 **OST** ka të drejtë të kërkojë që pronari i stabilimentit të kërkesës, ose **OSSH** të kryejë teste të pajtueshmërisë dhe simulime sipas një plani të përsëritur ose një skeme të përgjithshme ose pas çdo prishje, modifikimi ose zëvendësimi i ndonjë pajisje që mund të ketë ndikim në pajtueshmërinë e stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, ose të njesisë së

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 72 nga 82</i>

kërkesës, sipas kushteve të këtij Kodi. Pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** informohet për rezultatin e atyre testeve dhe simulimeve të pajtueshmërisë.

9.9.2.4 **OST** duhet të bëjë publike Listën e informatave dhe dokumentet të cilat ofrohen si dhe kushtet që duhet të plotësohen nga pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** në kuadër të procesit të pajtueshmërisë. Lista duhet të mbulojë së paku informacionet, dokumentet dhe kushtet e mëposhtme:

- a) gjithë dokumentacioni dhe certifikatat që duhet të sigurohen nga pronari i stabilimentit të kërkesës, ose **OSSH**;
- b) detajet e të dhënave teknike të kërkuara nga **stabilimenti i kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, sistemi i shpërndarjes** ose nga **njësia e kërkesës**, me rëndësi për kyçjen në rrjet ose operimin;
- c) kërkesat për modelet për studimet e sistemit në gjendje të qëndrueshme dhe dinamike;
- d) afatin kohor për sigurimin e të dhënave të sistemit të kërkuara për kryerjen e studimeve;
- e) studimet e bëra nga pronari i stabilimentit të kërkesës, ose **OSSH**, për të dëshmuar performancën e pritshme të gjendjes së qëndrueshme dhe dinamike duke iu referuar kushteve të parashtruara në paragrafët 9.11.1, 9.11.2 dhe 9.11.3;
- f) kushtet dhe procedurat, duke përfshirë fushën për regjistrimin e certifikatave të pajisjeve;
- g) kushtet dhe procedurat për përdorimin e certifikatave përkatëse të pajisjeve, të lëshuara nga një certifikues i autorizuar nga pronari i stabilimentit të kërkesës ose nga **OSSH**.

9.9.2.5 **OST** bënë publike alokimin e përgjegjësive tek pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** për testimin, simulimin dhe monitorimin e pajtueshmërisë.

9.9.2.6 **OST** mund t'ia delegojë palëve të treta, tërësisht ose pjesërisht, kryerjen e monitorimit të pajtueshmërisë së tij. Në raste të tilla, **OST** duhet të vazhdojë të sigurojë pajtueshmërinë duke përfshirë zotimet e konfidencialitetit me palën e tretë.

9.9.2.7 Nëse testet e pajtueshmërisë ose simulimet nuk mund të kryhen siç është dakorduar ndërmjet **OST** dhe pronarit të stabilimentit të kërkesës ose **OSSH**-së, për shkaqe që i atribuohen **OST**-së, atëherë **OST** nuk do të refuzojë në menyre të paarsyeshme njoftimin për operim të referuar në paragrafët 9.1 deri 9.8.

9.10 Testimi i pajtueshmërisë së stabilimenteve të kërkesës

9.10.1 Dispozitat e zakonshme për testet e pajtueshmërisë

9.10.1.1 Testimi i performancës së **stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit**, ose **njësisë së kërkesës** për rregullimin e fuqisë aktive, fuqisë reaktive dhe menaxhimin e kufizimit në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës, do të synojë dëshmimin se kërkesat e këtij Kodi janë përmbushur.

9.10.1.2 Pavarësisht kërkesave minimale për testimin e pajtueshmërisë të përcaktuara në këtë Kod, **OST** ka të drejtë:

- a) të lejojë pronarin e stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** të kryejë një seri testesh alternative, me kusht që këto teste të jenë efikase dhe të mjaftueshme për të dëshmuar se një stabiliment i kërkesës ose një sistem i shpërndarjes është në përputhje me kushtet e këtij Kodi; dhe
- b) të kërkojë nga pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** të kryejë seri testesh plotësuese ose alternative në ato raste kur informacioni i dhënë për **OST** në relacion me testimin e

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 73 nga 82</i>

pajtueshmërisë sipas dispozitave të paragrafëve 9.10.2 deri 9.10.6, nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar pajtueshmërinë me kushtet e këtij Kodi.

9.10.1.3 Pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** është përgjegjës për kryerjen e testeve në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 9.10. **OST** bashkëpunon dhe nuk do të vonojë pa nevojë kryerjen e testeve.

9.10.1.4 **OST** mund të marrë pjesë në testimin e pajtueshmërisë qoftë në vendngjarje ose nga distanca nga qendra dispeçerike e operatorit të sistemit. Për këtë qëllim, pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** duhet të sigurojë pajisjet e monitorimit, të nevojshme për regjistrimin e të gjitha sinjaleve të testeve dhe matjeve relevante si dhe të sigurojë që përfaqësuesit e nevojshëm të pronarit të të stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** të jenë të disponueshëm në vendngjarje gjatë tërë periudhës së testimit. Sinjalet e specifikuar nga **OST** do të sigurohen nëse, për testet e përzgjedhura, operatori i sistemit dëshiron të përdorë pajisjet e veta për të regjistruar performancën. **OST** ka të drejtën që të vendos për pjesëmarrjen e tij.

9.10.2 Testimi i pajtueshmërisë për shkyçjen dhe ri-kyçjen e stabilimenteve të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit

9.10.2.1 **Stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit** duhet të jenë në përputhje me kushtet për shkyçje dhe ri-kyçje të referuara në paragrafin 9.5, dhe duhet t'i nënshtrohen testeve të mëposhtme të pajtueshmërisë.

9.10.2.2 Në lidhje me testimin e aftësisë për ri-kyçje pas një shkyçje të rastësishme, për shkak të prishjeve në rrjet, ri-kyçja arrihet përmes një procedure të ri-kyçjes, mundësisht në mënyrë automatike, me autorizim nga **OST**.

9.10.2.3 Sa i përket testit të sinkronizimit, duhet të dëshmohet aftësia teknike e sinkronizimit të **stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit**. Ky test verifikon tarimet e pajisjeve të sinkronizimit. Ky test mbulon madhësitë në vijim: tensionin, frekuencën, këndin e çfazimit, devijimin e tensionit dhe frekuencës.

9.10.2.4 Sa i përket testit të shkyçjes nga distanca, duhet të dëshmohet aftësia teknike e **stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit** për shkyçje nga distanca në pikën e kyçjes apo nga pikat e sistemit të transmetimit, nëse kërkohet nga **OST**, dhe brenda kohës së specifikuar nga **OST**.

9.10.2.5 Sa i përket testit të shkyçjes së kërkesës nga nën-frekuenca, do të dëshmohet aftësia teknike e **stabilimenteve të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit** për shkyçje nga nën-frekuenca të përqindjes së kërkesës siç është specifikuar në paragrafin 9.5.

9.10.2.6 Sa i përket testit të releve nën-frekuente për shkyçje të kërkesës, do të dëshmohet aftësia teknike e **stabilimenteve të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit** të operojë nga furnizimi me rrymë alternative hyrëse nominale (AC) dhe plotësojnë kërkesat e mëposhtme në përputhje me paragrafin 9.5.1 dhe 9.5.2. Ky furnizim hyrës AC duhet të përcaktohet nga **OST**.

9.10.2.7 Sa i përket testit të shkyçjes së kërkesës nga nën-tensioni, duhet të dëshmohet aftësia teknike e **stabilimenteve të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit** për të operuar me një veprim të vetëm me bllokim të rregullatorëve të tensionit nën ngarkesë në paragrafin 9.5.3 në përputhje me paragrafin 9.5.2.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 74 nga 82</i>

9.10.2.8 Në vend të një numri të testeve të parqitura në paragrafin 9.10.2.1 mund të përdoret një certifikatë e pajisjeve, me kusht që ajo t'i sigurohet **OST**-së.

9.10.3 Testimi i pajtueshmërisë për shkëmbimin e informacioneve të stabilimenteve të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit

9.10.3.1 Sa i përket shkëmbimit të informacioneve ndërmjet **OST**-së dhe pronarit të stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit në kohë reale ose në mënyrë periodike, do të dëshmohet aftësia teknike e **stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit** që të jetë në përputhje me standardet për shkëmbimin e informacioneve të vendosura sipas paragrafit 7.3.14.

9.10.3.2 Në vend të një numri të testeve të paraqitura në paragrafin 9.10.3.1, mund të përdoret një certifikatë e pajisjeve, me kusht që ajo t'i sigurohet **OST**-së.

9.10.4 Testimi i pajtueshmërisë për shkyçjen dhe ri-kyçjen e stabilimenteve të kërkesave të kyçura në rrjetin e transmetimit

9.10.4.1 **Stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit** duhet të jenë në pajtueshmëri me kushtet për shkyçje dhe ri-kyçje të referuara në paragrafin 9.5 dhe duhet t'u nënshtrohen testeve të mëposhtme të pajtueshmërisë.

9.10.4.2 Në lidhje me testimin e aftësisë së ri-kyçjes pas një shkyçje të rastësishme, për shkak të një prishje në rrjet, ri-kyçja arrihet përmes një procedure të ri-kyçjes, mundësisht në mënyrë automatike, me autorizim nga **OST**.

9.10.4.3 Sa i përket testit të sinkronizimit, do të dëshmohet aftësia teknike e sinkronizimit të **stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit**. Ky test verifikon tarimet e pajisjeve të sinkronizimit. Ky test mbulon madhësitë në vijim: tensionin, frekuencën, këndin e ç'fazimit, devijimin e tensionit dhe frekuencës.

9.10.4.4 Sa i përket testit të shkyçjes nga distanca, duhet të dëshmohet aftësia teknike e **stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit** për shkyçje nga distanca në pikën e kyçjes apo nga pikat e sistemit të transmetimit, nëse kërkohet nga **OST**, dhe brenda kohës së specifikuar nga **OST**.

9.10.4.5 Sa i përket testit të releve nën-frekuente për shkyçje të kërkesës, do të dëshmohet aftësia teknike e **stabilimenteve të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit** të operojë nga furnizimi me rrymë alternative hyrëse nominale (AC) dhe plotësojnë kërkesat e mëposhtme në përputhje me paragrafin 9.5.1 dhe 9.5.2. Ky furnizim hyrës AC duhet të përcaktohet nga **OST**.

9.10.4.6 Sa i përket testit të shkyçjes së kërkesës nga nën-tensioni, duhet të dëshmohet aftësia teknike e stabilimenteve të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit për të operuar me një veprim të vetëm me bllokim të rregullatorëve të tensionit nën ngarkesë në paragrafin 9.5.3 në përputhje me paragrafin 9.5.2.

9.10.4.7 Në vend të një numri të testeve të parqitura në paragrafin 9.10.2.1 mund të përdoret një certifikatë e pajisjeve, me kusht që ajo t'i sigurohet **OST**-së.

9.10.5 Testimi i pajtueshmërisë për shkëmbimin e informatave të stabilimenteve të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 75 nga 82</i>

9.10.5.1 Sa i përket shkëmbimit të informacioneve ndërmjet **OST**-së dhe pronarit të stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit në kohë reale ose në mënyrë periodike, do të dëshmohet aftësia teknike e stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit që të jetë në përputhje me standardet për shkëmbimin e informacioneve të vendosura sipas paragrafit 7.3.14.

9.10.5.2 Në vend të një numri të testeve të paraqitura në paragrafin 9.10.5.1, mund të përdoret një certifikatë e pajisjeve, me kusht që ajo t'i sigurohet **OST**-së.

9.10.6 Testimi i pajtueshmërisë për njësitë e kërkesës për rregullimin e fuqisë aktive, fuqisë reaktive dhe menaxhimin e kufizimit në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës

9.10.6.1 Sa i përket testit për modifikimin e kërkesës:

- a) Do të dëshmohet aftësia teknike e njërive të kërkesës e përdorur nga një stabilimenti i kërkesës për rregullimin e fuqisë aktive, fuqisë reaktive dhe menaxhimin e kufizimit në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës, për të modifikuar konsumin e tij, pasi që t'i pranoj instruksionet nga **OSSH** ose **OST**, në kuadër të brezit, kohëzgjatjes dhe afatit kohor paraprakisht të dakorduar dhe të përcaktuar në përputhje me paragrafin 9.8.2, individualisht ose kolektivisht, si pjesë e grumbullimit të kërkesave përmes një pale të tretë;
- b) testi realizohet përmes instruksioneve ose përndryshe përmes simulimeve të instruksioneve nga **OSSH** ose **OST** dhe duke modifikuar ngarkesën të stabilimentit të kërkesës;
- c) testi konsiderohet i kaluar nëse kushtet e përcaktuara nga **OSSH** ose **OST** në përputhje me paragrafin 9.8.2.2 pika d), f), g), h), k) dhe l) plotësohen;
- d) certifikata e pajisjeve mund të përdoret në vend të një numri të testeve të paraqitura në paragrafin 9.10.6.1 pika b), me kusht që kjo certifikatë i ofrohet **OSSH**-së ose **OST**-së sipas nevojës.

9.10.6.2 Sa i përket testimit për shkyçje ose rikyçje të stabilimenteve statike të kompensimit:

- a) do të dëshmohet aftësia teknike e njësisë së kërkesës, e përdorur nga pronari i një stabilimenti të kërkesës për të siguruar rregullimin e fuqisë aktive, fuqisë reaktive dhe menaxhimin e kufizimit në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës për të çkyçur ose rikyçur, ose të dyja, stabilimentet statike të kompensimit kur pranon instruksione nga **OSSH** ose **OST**, në afatin kohor të paraparë në përputhje me paragrafin 9.8.2, ose individualisht ose kolektivisht si pjesë e grumbullimit të kërkesës nëpërmjet një pale të tretë;
- b) testi realizohet duke simuluar pranimin e instruksioneve nga **OSSH** ose **OST** dhe më pas duke shkyçur stabilimentin statik të kompensimit, dhe duke simuluar instruksionet e pranuar nga **OSSH** ose **OST** dhe më pas duke rikyçur stabilimentin;
- c) testi konsiderohet i kaluar nëse kushtet e përcaktuara nga **OSSH** ose **OST**, sipas rastit, në përputhje me paragrafin 9.8.2.2 pika d), f), g), h), k) dhe l) plotësohen.

9.11 Simulimi i pajtueshmërisë i stabilimenteve kërkesës

9.11.1 Dispozitat e zakonshme për simulimet e pajtueshmërisë

9.11.1.1 Simulimi i performancës së stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit, ose njësisë së kërkesës për reagim shumë të shpejtë në rregullimin e fuqisë aktive përmes reagimit të kërkesës në kuadër të një stabilimenti të kërkesës do të dëshmon nëse kushtet e këtij Kodi janë përmbushur ose jo.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 76 nga 82</i>

9.11.1.2 Simulimet zhvillohen në rrethanat si në vijim:

- a) kur kërkohet një kyçje e re me sistemin e transmetimit;
- b) kur një njësi e re kërkesës e përdorur nga një stabiliment i kërkesës për t'i ofruar **OST**-së kontroll shumë të shpejtë të fuqisë aktive gjatë reagimit të kërkesës është kontraktuar në përputhje me paragrafin 9.8.4;
- c) kur ndodh një zhvillim, zëvendësim ose modernizim i pajisjeve;
- d) kur supozohet se **OST** nuk është në përputhshmëri me kushtet e këtij Kodi.

9.11.1.3 Pavarësisht kërkesave minimale për simulimin e pajtueshmërisë të përcaktuara në këtë Kod, **OST** ka të drejtë të:

- a) lejojë pronarin e stabilimentit të kërkesës ose **OSSH**-në të kryejë një grup alternativ të simulimeve, me kusht që këto simulime janë efikase dhe të mjaftueshme për të dëshmuar se një stabiliment i kërkesës ose një sistem i shpërndarjes përputhet me kushtet e këtij Kodi ose me legjislacionin kombëtar; dhe
- b) të kërkojë nga pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** të kryejë grupe plotësuese ose alternative të simulimeve në rastet kur informatat që u janë ofruar **OST**-së në relacion me simulimin e pajtueshmërisë sipas dispozitave të paragrafëve 9.11.2, 9.11.3 dhe 9.11.4 nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar pajtueshmëri me kushtet e këtij Kodi.

9.11.1.4 Pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit do të siguron një raport me rezultatet e simulimit për secilin **stabiliment të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit** ose **stabiliment të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit**. Pronari i stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit zhvillon dhe siguron një model simulimi të vlefshëm për një stabiliment të caktuar të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose stabiliment të caktuar shpërndarës të kyçur në rrjetin e transmetimit. Fushëveprimi i modeleve të simulimit përcaktohet në paragrafët 9.6.1 dhe 9.6.2.

9.11.1.5 **OST** ka të drejtë të kontrollojë nëse një stabiliment i kërkesës ose një sistem i shpërndarjes është në përputhje me kushtet e këtij Kodi duke kryer simulimet e veta të pajtueshmërisë bazuar në raportet e simulimit, modelet e simulimit dhe testet e matjeve të pajtueshmërisë.

9.11.1.6 **OST** i ofron pronarit të stabilimentit të kërkesës ose **OSSH**-së të dhëna teknike dhe modelin e simulimit të rrjetit, të nevojshme për të kryer simulimet e kërkuara në përputhje me paragrafët 9.11.2, 9.11.3 dhe 9.11.4.

9.11.2 Simulimet e pajtueshmërisë për stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit

9.11.2.1 Sa i përket simulimit të aftësisë për fuqi reaktive të një stabilimenti të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit:

- a) modeli i simulimit për rrjedhat e fuqisë për gjendjen e qëndrueshme të rrjetit të **sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit** duhet të përdoret për të llogaritur shkëmbimin e fuqisë reaktive nën kushte të ndryshme të ngarkesës dhe gjenerimit;

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 77 nga 82</i>

- b) kombinimi për kushtet minimale dhe maksimale të ngarkesës dhe gjenerimit në gjendje të qëndrueshme, që rezultojnë në shkëmbimin më të ulët dhe më të lartë të fuqisë reaktive do të jenë pjesë të simulimeve;
- c) llogaritja e eksportit të fuqisë reaktive për rrjedha të fuqisë aktive më pak se 25% të aftësisë maksimale të importit në pikën e kyçjes është pjesë e simulimeve në përputhje me paragrafin 9.4.

9.11.2.2 **OST** mund të specifikojë metodën për simulimin e pajtueshmërisë së rregullimin aktiv të fuqisë reaktive të përcaktuar në paragrafin 9.4.2.

9.11.2.3 Simulimi konsiderohet i kaluar nëse rezultatet tregojnë përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 9.4.

9.11.3 Simulimet e pajtueshmërisë për stabilimentet kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit

9.11.3.1 Sa i përket simulimit të aftësisë për fuqi reaktive të një stabilimenti i kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit pa gjenerimin brenda:

- a) Stabilimenti i kërkesës i kyçur në transmetim pa gjenerim brenda do të dëshmojë aftësinë për fuqi reaktive në pikën e kyçjes;
- b) modeli i simulimit për rrjedhat të fuqisë të **stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit** përdoret për të llogaritur shkëmbimin e fuqisë reaktive nën kushte të ndryshme të ngarkesës. Kushtet minimale dhe maksimale të ngarkesës që rezultojnë në shkëmbimin më të ulët dhe më të lartë të fuqisë reaktive në pikën e kyçjes duhet të jenë pjesë të simulimeve;
- c) simulimi konsiderohet i kaluar nëse rezultatet tregojnë përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 9.4.1 dhe 9.4.2.

9.11.3.2 Sa i përket simulimit të aftësisë për fuqi reaktive të një **stabilimenti të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit** me gjenerim brenda:

- a) modeli i simulimit për rrjedhat të fuqisë të **stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit** përdoret për të llogaritur shkëmbimin e fuqisë reaktive nën kushte të ndryshme të gjenerimit dhe ngarkesës;
- b) kombinimi për kushtet minimale dhe maksimale të ngarkesës dhe gjenerimit, që rezultojnë në shkëmbimin më të ulët dhe më të lartë të fuqisë reaktive do të jenë pjesë të simulimeve;
- c) simulimi konsiderohet i kaluar nëse rezultatet tregojnë përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 9.4.1 dhe 9.4.2

9.11.4 Simulimi i pajtueshmërisë për njësitë e kërkesës me rregullim të shpejtë të fuqisë aktive për reagim ndaj kërkesës

9.11.4.1 Modeli i njësisë së kërkesës i përdorur nga pronari i një stabilimenti të kërkesës për të ofruar rregullim shumë të shpejtë të fuqisë aktive për reagim ndaj kërkesës duhet të dëshmon aftësinë teknike të njësisë së kërkesës për të ofruar rregullim shumë të shpejtë të fuqisë aktive në një ndodhi me frekuencë të ulët në kushtet e përcaktuara në paragrafin 9.8.4.

9.11.4.2 Simulimi konsiderohet i kaluar nëse modeli dëshmon pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara në paragrafin 9.8.4.

9.12 Monitorimi i pajtueshmërisë

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 78 nga 82</i>

9.12.1 Monitorimi i pajtueshmërisë për stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit

Sa i përket monitorimit të pajtueshmërisë së kërkesave për fuqi reaktive të zbatueshme në stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit:

- a) **stabilimenti i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit** duhet të pajiset me pajisjet e nevojshme për të matur fuqinë aktive dhe reaktive, në përputhje me paragrafin 9.4; dhe
- b) **OST** specifikon afatin kohor për monitorimin e pajtueshmërisë.

9.12.2 Monitorimi i pajtueshmërisë për stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit

Sa i përket monitorimit të pajtueshmërisë së kërkesave për fuqi reaktive të zbatueshme për stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit:

- a) **stabilimenti i kërkesës i kyçur në rrjetin e transmetimit** duhet të pajiset me pajisjet e nevojshme për të matur fuqinë aktive dhe reaktive, në përputhje me paragrafin 9.4; dhe
- b) **OST** specifikon afatin kohor për monitorimin e pajtueshmërisë.

10 Derogimet

Me kërkesë të pronarit të centralit të gjenerimit, pronarit të stabilimentit të kërkesës, **OSSH**-së ose **OST**-së, autoriteti rregullativ mund t'i japë: **pronarit të centralit të gjenerimit**, pronarit të stabilimentit të kërkesës, **OSSH**-së ose **OST**-së, derogime kundrejt një ose më shumë dispozitave të këtij Kodi për: stabilimentet e reja dhe ekzistuese të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit, **stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit**, **sistemit të shpërndarjes** dhe **njësitë të kërkesës** në përputhje me paragrafët nga 10.1 deri në 10.3.

10.1 Dispozita të përgjithshme

10.1.1 Pas konsultimit me **OST**-në, pronarët e centralit të gjenerimit, pronarët e stabilimentit të kërkesës, **OSSH**-në dhe akterët tjerë që konsiderohen që janë prekur nga ky Kod, autoriteti rregullativ specifikon kriteret për dhënien e derogimeve sipas paragrafëve 10.2 dhe 10.3. Autoriteti rregullativ do të publikojë këto kriteret në faqen e tij elektronike dhe ia komunikon Komunitetit të Energjisë brenda nëntë muajve nga skadimi i afatit të transpozimit të këtij Kodi. Komuniteti i Energjisë mund t'i kërkojë autoritetit rregullativ t'i ndryshojë kriteret nëse konsideron se ato nuk janë në përputhje me këtë Kod. Kjo mundësi për t'i rishikuar dhe ndryshuar kriteret për dhënien e derogimeve nuk ndikon në derogimet e dhëna më parë, të cilat vazhdojnë të zbatohen deri në datën e skadimit të afatit siç është detajuar në vendimin për dhënien e derogimit.

10.1.2 Nëse autoriteti rregullativ e konsideron si të nevojshme, për shkak të një ndryshimi në rrethanat që lidhen me evoluimin e kërkesave të sistemit, ai mund të shqyrtojë dhe ndryshojë më së shumti një herë në vit kriteret për dhënien e derogimeve në përputhje me paragrafin 10.1.1. Ndryshimi i kriterëve nuk zbatohet për derogimet për të cilat tashmë është paraqitur kërkesa.

10.1.3 Autoriteti rregullativ mund të vendosë që: **modulet gjeneruese**, stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit, **sistemi i shpërndarjes** dhe njësitë e kërkesës, për të cilat është paraqitur kërkesa për derogim në pajtim me paragrafët 10.2 ose 10.3, nuk kanë nevojë të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e këtij Kodi për të cilat është kërkuar derogimi nga dita e paraqitjes së kërkesës deri në lëshimin e vendimit të autoritetit rregullativ.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 79 nga 82</i>

10.2 Kërkesa për derogim nga pronari i centralit të gjenerimit, pronari i stabilimentit të kërkesës ose operatori i sistemit të shpërndarjes

10.2.1 **Pronarët e centraleve të gjenerimit**, pronarët e stabilimenteve të kërkesës dhe **OSSH** mund të kërkojnë derogim për një ose disa kushteve të këtij Kodi për modulet gjeneruese brenda stabilimenteve të tyre, **stabilimenteve të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit, stabilimenteve të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit, sistemit të shpërndarjes ose njësive të kërkesës** të përdorura nga një stabiliment i kërkesës për t'i ofruar shërbime si reagim ndaj kërkesës **OSSH-së** dhe **OST-së**.

10.2.2 Kërkesa për derogim duhet të plotësohet me **OST** ose **OSSH**, sipas rastit, dhe përfshin:

- a) identifikimin e pronarit të centralit të gjenerimit, pronarit të stabilimentit të kërkesës, **OSSH** dhe personin kontaktues për komunikim;
- b) përshkrimin e modulit ose moduleve të gjenerimit, **stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit**, stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit, sistemit të shpërndarjes ose njësisë së kërkesës për të cilën është kërkuar derogim;
- c) referencën ndaj dispozitave të këtij Kodi nga i cili kërkohet derogim dhe një përshkrim të hollësishëm të derogimit të kërkuar;
- d) dëshmimin se derogimi i kërkuar nuk do të ketë efekt negativ në shkëmbimet tregtare ndërkufitare.

10.2.3 Brenda dy javëve nga marrja e një kërkesë për derogim, **OST** ose **OSSH** (sipas rastit) duhet t'ia konfirmojnë **pronarit të centralit të gjenerimit**, pronarit të stabilimentit të kërkesës ose **OSSH-së**, nëse kërkesa është e plotë. Nëse **OST** dhe **OSSH** (sipas rastit) konsideron se kërkesa nuk është e plotë, **pronari i centralit të gjenerimit**, pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** duhet të dorëzojë informatat shtesë të kërkuara brenda një muaji nga marrja e kërkesës për informata shtesë. Nëse **pronari i centralit të gjenerimit**, pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** nuk ofron informatat e kërkuara brenda afatit kohor, kërkesa për derogim konsiderohet e tërhequr.

10.2.4 Nëse një kërkesë për derogim ka të bëjë me **modulin gjenerues** të kyçur në **sistemin e shpërndarjes**, vlerësimi i **OSSH-së** duhet të shoqërohet me një vlerësim të kërkesës për derogim nga **OST**. **OST**-ja ofron vlerësimin e saj brenda dy muajve pasi që të kërkohet nga **OSSH**-ja.

10.2.5 **OSSH**, në koordinim me **OST**-në, vlerëson kërkesën për derogim, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara nga autoriteti rregullativ sipas paragrafit 10.1.

10.2.6 Brenda gjashtë muajve nga marrja e kërkesës për derogim, **OST** ose **OSSH** (sipas rastit) ia përcjell kërkesën autoritetit rregullativ dhe dorëzon vlerësimin/et e përgatitura në përputhje me paragrafët 10.2.4 dhe 10.2.5. Kjo periudhë mund të zgjatet për një muaj kur **OST** ose **OSSH** (sipas rastit) kërkon informata shtesë nga **pronari i centralit të gjenerimit**, pronari i stabilimentit të kërkesës ose nga **OSSH**, si dhe për dy muaj kur **OSSH** i kërkon **OST-së** të dorëzojë një vlerësim të kërkesës për derogim.

10.2.7 Autoriteti rregullativ do të miraton një vendim në lidhje me çdo kërkesë për derogim brenda gjashtë muajve nga dita e pranimit të kërkesës. Ky afat kohor mund të zgjatet për tre muaj para skadimit të tij, kur autoriteti rregullativ kërkon informata shtesë nga **pronari i centralit të gjenerimit**, pronari i stabilimentit të kërkesës ose nga **OSSH** ose ndonjë palë tjetër e interesuar. Periudha shtesë fillon kur pranohen informatat e plota.

10.2.8 **OST** ose **OSSH** (sipas rastit) për **pronarin e centralit të gjenerimit**, paraqesin çdo informatë shtesë të kërkuar nga autoriteti rregullativ brenda dy muajve nga kërkesa e tillë. Nëse **OST** ose **OSSH**

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 80 nga 82</i>

(sipas rastit) nuk i dorëzon informatat e kërkuara brenda këtij afati, kërkesa për derogim konsiderohet e tërhequr, përveç para skadimit të saj. Pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** dorëzon çdo informatë shtesë të kërkuar nga autoriteti rregullativ brenda dy muajve nga kërkesa e tillë. Nëse **pronari i centralit të gjenerimit**, pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH**-ja nuk dorëzon informatat e kërkuara brenda këtij afati kohor, kërkesa për derogim konsiderohet e tërhequr, përveç nëse para skadimit të afatit kohor:

- a) autoriteti rregullativ mund të vendos për zgjatje të afatit; ose
- b) **pronari i centralit të gjenerimit**, pronari i stabilimentit të kërkesës ose **OSSH** njofton autoritetin rregullativ me anë të një parashtrese të arsyetuar se kërkesa për derogim është e plotë.

10.2.9 Autoriteti rregullativ lëshon një vendim të arsyetuar sa i përket kërkesës për derogim. Kur autoriteti rregullativ jep derogimin, ai specifikon kohëzgjatjen e tij.

10.2.10 Autoriteti rregullativ njofton vendimin e tij tek **pronari i centralit të gjenerimit**, pronari përkatës i stabilimentit të kërkesës dhe **OST** ose **OSSH** (sipas rastit),

10.2.11 Autoriteti rregullativ mund të revokojë një vendim që jep derogim nëse rrethanat dhe arsytet themelore nuk zbatohen më, ose në bazë të një rekomandimi të arsyetuar nga Sekretariati dhe Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë në pajtim me paragrafin 10.4.2.

10.2.12 Për njësitë e kërkesës brenda një stabilimenti të kërkesës në nivel prej 1 kV ose më pak, kërkesa për derogim sipas paragrafit 10.2 mund të bëhet nga një palë e tretë në emër të pronarit të stabilimentit të kërkesës ose pronarit të mundshëm ose operatorit të mundshëm. Kërkesa e tillë mund të bëhet për një njësi të vetme kërkesës ose për njësi të shumëfishta të kërkesës brenda stabilimentit të njëjtë të kërkesës. Në rastin e kësaj të fundit, dhe me kusht që kapaciteti maksimal kumulativ të jetë specifikuar, pala e tretë mund të zëvendësojë të dhënat e kërkuara në pikën a) të paragrafit 10.2.2 me të dhënat e saj.

10.3 Kërkesa për derogim nga OST ose OSSH

10.3.1 **OST** ose **OSSH** mund të kërkojë derogime për **modulet gjeneruese, stabilimentet e kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit, stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit, sistemin e shpërndarjes ose njësitë e kërkesës** brenda një stabilimenti të kërkesës të kyçur ose që do të kyçen në rrjetin e tyre

10.3.2 **OST** ose **OSSH** paraqet kërkesën e tij për derogim tek autoriteti rregullativ. Çdo kërkesë për derogim përfshinë:

- a) identifikimin e **OST**-së ose **OSSH**-së (sipas rastit) dhe personin kontaktues për komunikim;
- b) përshkrimin e **moduleve gjeneruese, stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit, stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit, sistemit të shpërndarjes ose njësisë së kërkesës** për të cilën është kërkuar derogimi dhe kapacitetin e përgjithshëm të instaluar dhe numrin e **moduleve gjeneruese, stabilimenteve të kërkesës të kyçura në rrjetin e transmetimit, stabilimenteve të shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit, sistemit të shpërndarjes ose njësisive të kërkesës**;
- c) kërkesën ose kërkesat e këtij Kodi për të cilat kërkohet derogim, me një përshkrim të hollësishëm të derogimit të kërkuar;
- d) arsyetimin e hollësishëm me të gjitha dokumentet relevante mbështetëse;

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 81 nga 82</i>

e) dëshminë se derogimi i kërkuar nuk do të ketë efekt negativ në shkëmbimet tregtare ndërkufitare;

10.3.3 Kur kërkesa për derogim paraqitet nga **OSSH**, autoriteti rregullativ, brenda dy javëve nga dita e pranimit të kësaj kërkesë, i kërkon **OST**-së të vlerësojë kërkesën për derogim në vazhden e kritereve të përcaktuara nga autoriteti rregullativ sipas paragrafit 10.1.

10.3.4 Brenda dy javëve nga dita e pranimit të kërkesës së tillë për vlerësim, **OST** do t'i konfirmojë **OSSH**-së nëse kërkesa për derogim është e plotë. Nëse **OST** konsideron se nuk është e plotë, **OSSH**-ja paraqet informatat e kërkuara shtesë brenda një muaji nga pranimi i kërkesës për informata shtesë.

10.3.5 Brenda gjashtë muajve nga pranimi i kërkesës për derogim, **OST** do t'i dorëzojë autoritetit rregullativ vlerësimin e tij, duke përfshirë çdo dokumentacion përkatës. Afati gjashtëmujor mund të zgjatet për një muaj kur **OST** kërkon informata shtesë nga **OSSH**.

10.3.6 Autoriteti rregullativ miraton një vendim në lidhje me kërkesën për derogim brenda gjashtë muajve nga dita e pranimit të kërkesës. Kur kërkesa për derogim dorëzohet nga **OSSH**, afati gjashtëmujor fillon nga dita e pranimit të vlerësimit të **OST**-së në pajtim me paragrafin 10.3.5.

10.3.7 Afati gjashtëmujor i përmendur në paragrafin 10.3.6 mund të zgjatet, përpara skadimit të saj, edhe për tre muaj të tjerë, kur autoriteti rregullativ kërkon më shumë informata nga **OST** ose nga ndonjë palë tjetër e interesuar. Kjo periudhë shtesë do të fillojë nga dita pas marrjes së informatave të plota.

OST ofron çdo informatë shtesë të kërkuar nga autoriteti rregullativ brenda dy muajve nga data e kërkesës. Nëse **OST** nuk ofron informatat e kërkuara shtesë brenda këtij afati kohor, kërkesa për derogim konsiderohet e tërhequr, përveç nëse para skadimit të afatit kohor:

- a) autoriteti rregullativ vendos të ofrojë zgjatje; ose
- b) **OST** informon autoritetin rregullativ me anë të një parashtrëse të arsyetuar se kërkesa për derogim është e plotë.

10.3.8 Autoriteti rregullativ lëshon vendim të arsyetuar në lidhje me kërkesën për derogim. Kur autoriteti rregullativ jep derogimin, ai specifikon kohëzgjatjen e tij.

10.3.9 Autoriteti rregullativ njofton vendimin e tij tek **OST**, si dhe tek Sekretariati dhe Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë.

10.3.10 Autoriteti rregullativ mund të përcaktojë kërkesa shtesë lidhur me përgatitjen e kërkesave për derogim nga **OST**. Duke vepruar kështu, autoriteti rregullativ merr parasysh planin midis sistemit të transmetimit dhe sistemit të shpërndarjes në nivel kombëtar dhe konsultohet me **OSSH**-në, pronarët e stabilimenteve të kërkesës dhe palët e interesit, përfshirë dhe prodhuesit.

10.3.11 Autoriteti rregullativ mund të revokojë një vendim që jep derogim nëse rrethanat dhe kushtet themelore nuk zbatohen më, ose në bazë të rekomandimit të arsyetuar nga Sekretariati dhe Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë në pajtim me paragrafin 10.4.2.

10.4 Monitorimi i derogimeve

10.4.1 Sekretariati dhe Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë monitorojnë procedurën e dhënies së derogimeve në bashkëpunim me autoritetin rregullativ. Autoriteti rregullativ i ofron Sekretariatit dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë të gjitha informatat e nevojshme për këtë qëllim.

10.4.2 Sekretariati dhe Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë mund të lëshojnë një rekomandim të arsyetuar ndaj autoritetit rregullativ për të revokuar një derogim për shkak të mungesës së arsytimit.

	KODI I RRJETIT KODI I KYÇJES	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 82 nga 82</i>

(Fundi i dokumentit)